# GAZETA SHQIPTARE





Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7469 E enjte 15 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)





Opinioni i Ditës

Nga MONIKA STAFA

### Perëndimi, pas gjyqësorit në Shqipëri, vëmendje e shtuar ndaj sektorit mediatik



Nëse deri pak vite më parë në sallonet perëndimore nuk pat filluar të ndjehet alarmi i stuhisë, tani ka ardhur pikërisht koha për ta dhënë atë me forcë...

Vijon në faqen 20



Opinioni i Ditës

Nga JORGJI KOTE

### "Ostpolitika" e re koreane

Samiti i pritshëm i Presidentit amerikan, Donald Trump me atë koreano-verior, Kim Jong Un dhe përgatitjet për këtë ngjarje historike për sigurinë ...

Vijon në faqen 21

KESHILLI I MINISTRAVE VENDOS NDRYSHIMET. TABELAT ME VLEREN E PASURIVE

# TAKSA E PRONES, VLERESIM I RI PER ÇMIMIN REFERENCE

Zbardhet tabela për të gjithë vendin dhe afatet për pagesën e taksës. Punonjësit derë më derë për matjet. Ja kush i nënshtrohet detyrimit fiskal



(Në foto) Pallate në Tiranë

Në faqt 6-7



"PS-ja mori 140 mln lekë për vitin 2017"

## "Lobimi rus", KQZ po shqyrton raportin financiar të PD-së, ja bilancet e partive

Raporti i Komisionit Zgjedhor: Ja lista e sponsorëve të LSI e sa harxhon PSD

Nga DARINA TANUSHI

Partia Socialiste dhe Lëvizja Socialiste për Integrim kanë dorëzuar raportet e tyre financiare pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, njëra në janar dhe tjetra në shkurt. Ndërsa Partia Demokratike e ka dorëzuar së fundmi ...

Në faqen 5

"BISEDA ME HOXHEN"

### Helmoi vjehrrën me fostoksinë, flet xhaxhai i nuses: Gjithë historia është sajesë

Në faqen 10

PJESA E PARE

### ATP: Dosjet e vitit 1996, pronarët që kompensohen dhe lista me 4900 vetë

Në faqet 16-18

LAJMI I MIRE

### Përdorimi i gjuhës shqipe në Maqedoni kalohet nga Kuvendi, incidenti me Gruevskin

Në faqen 13

ÇFARE TE KONSUMONI

### Ylli Merja: Si të kuroni dhimbjet e kokës me mjekësinë popullore, këshillat

Në faqen 12

LEGALIZIMET



### ALUZINI: 412 personat që kanë gati tapitë e shtëpive, lista me pronarët në Elbasan

Në faqen 8

Operacioni në Itali, mediat e huaja: Trafikantët nën hetim prej 2 vitesh

## Trafikuan 2.3 tonë drogë me skafe, në pranga 43 vetë

*Shkatërrohen 2 grupe kriminale, mes të arrestuarve 21 shqiptarë*

Nga INA ALLKANJARI

Dy grupe kriminale të trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike, janë shkatërruar mëngjesin e djeshëm, në një operacion të përbashkët mes policisë italiane dhe asaj shqiptare. Në kuadër të këtij operacioni antidrogë të koduar "Shefi" kanë rënë në pranga 43 persona, mes të cilëve 21 shtetas shqiptarë. Shqipëri për llogari të policisë italiane, ndërkohë dy shqiptarë të tjerë janë shpallur në kërkim. Ndërsa të prangosurit e tjerë ...



Në faqen 9

# PEZULLIMI
## DEBATI

Tabaku: Një grup uzurpatorësh qeveritarë zhdukën pronën private, ua rrëmbyen pronarëve

# Pezullimi i 7501, PD: Shkelet Kushtetuta dhe pika kyçe për në BE

## "Qeveria, sulm ndaj të drejtës legjitime të pronarit"



Valentina Madani

PD-ja përmes deputetes Jorida Tabaku e konsideron shkelje të Kushtetutës, vendimin e qeverisë për pezullimin e ligjit 7501 për pronat. Për Tabakun, zgjidhja e vetme sipas saj për këtë katrahurë është bërja nul e nenit që u merr pronën pronarëve në ligjin e Investimeve Strategjike dhe njëkohësisht rishikimi i plotë i Ligjit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Tabaku vuri në dukje se "për sa kohë prona private nuk do të trajtohet me respekt, ne kurrë nuk do të kemi lirinë, pasi prona private dhe liria janë të pandashme". Znj. Tabaku shkruan në "Facebook" se ky vendim u jep të drejta investitorëve, duke shkelur me këmbë sipas saj Kushtetutën, por edhe një nga pikat e rëndësishme të vendosura nga BE për çeljen e negociatave. "Në mbrojtje të pronës private! Në pesë vjet qeverisje, kryeministri Rama është përkujdesur që të sulmojë sistematikisht pronarët e tokave, duke kërkuar që t'u rrëmbejë atyre pronën që u takon. E nisi me Ligjin e Investimeve Strategjike, pastaj me ligjin e ri, që nuk kthen e nuk kompenson pronën dhe tanimë me vendimin që pronarëve të mos u kthehet toka nëse ka një investitor strategjik që e kërkon atë. Pesë vjet me radhë pronarët kanë qenë një nga shtresat më të diskriminuara për pronën që u takon si trashëgimi dhe sipas çdo të drejte. Sipas vendimi të qeverisë të miratuar këtë javë, qeveria paturpësisht i jep përparësi investitorit për pronën që i takon dikujt tjetër, duke shkelur me këmbë jo vetëm Kushtetutën e vendit, por edhe një nga pikat e rëndësishme të vendosura nga BE për çeljen e negociatave", shprehet zj.Tabaku. Sipas saj, kjo qeveri mund të perifrazohet si një grup uzurpatorësh, që kanë zhbërë të gjithë institucionet qeveritare dhe kanë zhdukur të gjithë pronën private, duke ua rrëmbyer pronarëve në interes të pakicës. "Duke vepruar kështu kanë prodhuar një pabarazi të tillë, ku oligarkët e pushtetit janë të vetmit që përfitojnë ligje ekskluzive për të rrëmbyer pronat të pashqetësuar nga kurrgjë. Të njëjtën skemë zbatoi edhe komunizmi për 5 dekada, ku ligjëroi tjetërsimin dhe zhbërjen e pronës private, duke prodhuar varfëri dhe duke mbjellë vdekjen e një kombi. Aty ku ka tokë shtetërore i jepet privatit për pallat. Aty ku ka teatër ndërtohet qendër tregtare. Aty ku ka stadium ndërtohet kullë. Aty ku ka tokë të privatit, përsëri i jepet oligarkut e jo pronarit të ligjshëm të tokës që të përfitojë veç oligarku", deklaroi deputetja e PD-së. Tabaku përmendi se çdo ligj që kanë sjellë në parlament, çdo vendim qeverie ka qenë sulm ndaj të drejtës legjitime të pronarit dhe nuk ka mbrojtur këtë të fundit.



Deputetja e PD, Jorida Tabaku



### Pezullimi

**VENDIMI**

Kryeministri Rama pezulloi përkohësisht njohjen e të drejtës mbi pronën për ata që përfituan tokë nga ligji i famshëm 7501. Sipas vendimit, pezullohen procedurat e kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, në zonën me rëndësi për fondin e mbështetjes së investimeve strategjike.

**PD: Ndërtohen kulla dhe pronarët s'marrin pronat**

# Ligji 7501: Shalsi pranon problemet. Shehi: Bllokoi ekonominë



Deputeti i PD, Dashamir Shehi

Opozita përmes deputetit demokrat Dashamir Shehi shprehet se ligji 7501, i cili ndau tokën bujqësore pas rënies së regjimit komunist, ka paralizuar ekonominë shqiptare. "Ky ka bllokuar ndërtimet e ligjshme, por mbi të gjitha ka bllokuar reformimin e bujqësisë. Sot, 27 vjet më pas, ne kemi akoma fermë mesatare me 1.2 hektarë, që është qesharake për një bujqësi moderne. Pse? Sepse ai që e ka tokën nuk e shet dot, sepse ai që do e blejë nuk është i sigurt", deklaroi z.Shehi për "TCH". I votuar në vitin 1991, ligji 7501 ishte akti i parë dhe ndër të vetmit që bashkoi ishpartinë e Punës të sapokthyer në Socialiste me Partinë Demokratike.

**LIGJI**

I votuar në 1991, ligji 7501 ishte akti i parë dhe ndër të vetmit që bashkoi PD-në me ish-partinë e Punës të shndërruar në PS. Përmes tij u ndanë 580 mijë hektarë tokë bujqësore për 420 mijë familje fermerë.

Përmes tij, u ndanë 580 mijë hektarë tokë bujqësore për 420 mijë familje fermerë. "Në kushtet e sotme mund të thuhet që mund të ishte përdorur një skemë, apo skenar tjetër nga ai që u paraqit. Por asokohe ishim në kushtet e një e trysnie dhe emergjence sociale dhe vendimi ishte emergjent, pse jo edhe populist", shprehet Eduard Shalsi. Shqipëria ka paguar mbi 80 milionë euro si dënime nga Gjykata e Strasburgut për pronat. Sipas Bankës Botërore, pasiguria e pronës bashkë me korrupsionin janë dy pengesat më të mëdha për investimet e huaja. "Ne kemi pranuar këtu që të bëjnë kulla 40-katëshe dhe nuk kemi pranuar që t'i njohim të drejtën dikujt që ka pasur dikur 10 hektarë të tijat. I ka bërë një dëm të madh moral shoqërisë shqiptare. Na bëri lëmsh vëlla me vëlla", shprehet Dashamir Shehi. Por, socialisti Eduart Shalsi mendon se: "Kemi me mijëra jetë të humbura për shkak të konflikteve të pronësisë, kemi një mungesë aplikimi uniformë nga veriu në jug. Mund të thuhet që pasojat që prodhoi ishin negative". Tri dekada pas miratimit të ligjit, të gjithë e pranojnë se pasojat e tij negative kanë qenë të mëdha. Por a mund të riparohen një pjesë e tyre? "Nëse ka dëshirë politike, që unë nuk e shikoj. S'e shikoj në krahun e majtë, që ligjin e kompensimit e ka reduktuar në një paçavure. Nuk shikoj as ndonjë agresivitet nga pala jonë, që pati 8 vite mundësi që të bënte ndonjë rikuperim", mendon Dashamir Shehi. "Nuk mund të gjykoj sesa mund të rikuperohet, por di të them me bindje se ka ardhur fundi i këtij ligji", deklaron Shalsi. Përveç pasigurive, ligji 7501 u përdor edhe për të tjetërsuar padrejtësisht mijëra hektarë toka në bregdet, të cilat u falsifikuan si toka bujqësore. Rasti më i fundit ishte grabitja e tokës, duke e kthyer nga rërë dhe pyll në tokë bujqësore dhe duke e përvetësuar me falsifikim të dokumenteve.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI,
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116, ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.gsh.al, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

Rama në Elbasan: Më shumë punësim dhe siguri, zgjidhje pronave të kulteve fetare

# Propozimi i Bashës: Tri bizneset që shteti duhet t'ua heqë taksat

## *Meta, mesazh shprese: Të përtërijmë optimizmin*



**TAKIMI**
Ish-kryeministri Berisha priti dje politikanin austriak Grossruck. "Me mikun tim, Wolfgang Grossruck duke diskutuar për instalimin e narkoshtetit në Shqipëri nga regjimi i Edvinit!", shkruan ai. Berisha evidentoi problemin e drogës dhe lidhjet e qeverisë me trafikun e saj.



## Megaskandali, Berisha: Rama dhe rusët e "Gunvor" vjedhin 75 milionë euro

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje në rrjetet sociale mesazhin e qytetarit dixhital për lidhjet e Edi Ramës me kompaninë ruse "Gunvor". "Ja si vodhën Rama dhe Besua i tij me kompaninë ruse 'Gunvor' vetëm në taksa 75 milionë euro", shkruan Berisha në rrjetin social, duke publikuar të plotë mesazhin e qytetarit dixhital. "Përshëndetje Doktor! Ja si Rama me lidhjet ruse shkatërron sektorin strategjik në lidhje me kompaninë 'Gunvor'. Në vitin 2015 rusët dërguan si administrator në ARMO, Cristophe Francois Bernard Dobord, përmes kompanisë 'Heaney Assetes', e cila më vonë kaloi aktivitetin në kompaninë 'Deveron', e cila pastaj ia kalon aktivitetin kompanisë 'Zeveson IRTC'. Të gjitha këto kompani janë zinxhir-guaska, që në mënyrë të njëpasnjëshme kanë lënë borxhe në buxhet, banka e furnitorë rreth një miliard euro. Të gjitha rezultojnë të lidhura me Z. Debord dhe Besnik Sulën. Po të analizohet vetëm viti 2017, 'IRTC' ka lënë borxhe vetëm në buxhet 75 milionë euro. Dhe z. Debord ka regjistruar në Shqipëri kompaninë 'Tosc Energji', ku nga hiçi u rreshtua me kompanitë me xhiron më të madhe në vend. I gjithë financimi i ka ardhur tek 'Raiffeizen Bank' nga 'Gunvor' dhe kjo financonte kompaninë 'IRTC' me blerje tek 'Bankers' dhe merrte prodhim nga 'IRTC'. Tani e kanë mbyllur dhe 'IRTC', për të zhdukur borxhet e radhës dhe kanë krijuar kompaninë tjetër guaskë 'Allum Enteprises' në fund të 2017, e cila përsëri me të njëjtën skemë ka marrë me qira asetet e ARMO-s dhe presin momentin të vazhdojnë skemën. Pra, rusët me z. Dobord, me mbështetje të Besos dhe financim të 'Gunvor', veç vjedhjes, kërcënojnë të shkaktojnë një tronditje të rendë financiare me borxhet që krijojnë ndaj bankave, buxhetit dhe furnitorëve të tjerë si privatë, ashtu dhe në OSHE, ujësjellës, pushtet lokal. Pasi për çudi, asnjë ent shtetëror nuk guxon të kërkojë detyrimet apo të ndalë këtë skemë".

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha propozoi dje nga Elbasani disa masa lehtësuese për biznesin. Basha i kërkoi qeverisë heqjen e taksave për tri biznese, konkretisht për gratë që bëjnë punime dore, për përpunimin e mjaltit si dhe sektorin e paneleve fotovoltaike për prodhimin e energjisë. Z.Basha vizitoi qytetin e Elbasanit me rastin e Ditës së Verës. Teksa pa nga afër panairin e biznesit, Basha ka gjykuar se tre sektorë që po spikasin kanë nevojë direkte për mbështetje nga shteti. "Me miq dhe dashamirës, me deputetë e qarkut të Elbasanit, - tha Basha para medias - kemi vizituar si çdo vit, panairin këtu në Elbasan. Dua t'i uroj nga zemra të gjithë ata sipërmarrës, tregtarë, artizanë të cilët çdo vit paraqesin prodhimet e tyre në këtë panair. Jam impresionuar veçanërisht nga disa biznese, kam parë bashkim vullnetar të zonjave shtëpiake që bëjnë punime dore. Kam parë një përparim shumë të mirëpritur në përpunimin dhe mbledhjen e mjaltit dhe në veçanti jam impresionuar që në Elbasan ndodhet një nga fabrikat më të mëdha të paneleve fotovoltaike për prodhimin e energjisë. Përmenda këto të tria, i përzgjodha, sepse meritojnë mbështetje të drejtpërdrejtë nga shteti. Meritojnë mbështetje me ulje dhe pse jo, me heqje të taksave në disa raste dhe me subvencione për të krijuar një atmosferë sa më pozitive për mirëqenien dhe punësimin e shqiptarëve", deklaroi z.Basha. "Por - shtoi ai - këtu nga Elbasan, kryeqyteti i Ditës së Verës, dua t'i jap një urim çdo banori dhe çdo banoreje të Elbasanit, por edhe të gjithë shqiptarëve, gëzuar Ditën e Verës! Ashtu siç çelin lulet në pranverë, ashtu çeltë shpresa dhe optimizmi në zemrën e çdo shqiptari. Për shumë vjet gëzuar!",- tha z. Basha.

**PREMTIMET**

Kryeministri Edi Rama uroi dje nga Elbasani Ditën e Verës, ndërsa mori pjesë në një sërë aktivitetesh të organizuara për këtë festë. Në panairin e Ditës së Verës, Rama theksoi se është e rëndësishme që të fuqizohet vazhdimisht mundësia e njerëzve për të pasur më shumë punësim për të nesërmen. "Ajo që është më e rëndësishmja është që të fuqizojmë vazhdimisht mundësitë e njerëzve për të pasur më shumë punësim, për të pasur më shumë ekonomi, për të pasur më shumë siguri për të nesërmen. Natyrisht, kjo është më e lehtë të thuhet se të bëhet. Por ndërkohë, hap pas hapi çdo ditë diçka po bëhet në funksion të një të nesërmeje, që jam i bindur do të shkëlqejë si kjo Ditë Vere". Nga Elbasani, teksa i dorëzoi certifikatën e pronësisë Kishës Katolike Shën Piu X, kryeministri dha një lajm të mirë për të gjitha institucionet e kultit në vend. "Ne, për fat të keq, trashëguam një situatë apokaliptike për pronën e komuniteteve fetare dhe prej disa vitesh jemi angazhuar në dhënien e titujve të pronësisë, duke legalizuar godina, kisha, apo xhami të ndërtuara, të rindërtuara nga hiri prej besimtarëve, prej komuniteteve, prej individëve bujarë dhe në të njëjtën kohë duke bërë regjistrimin vullnetar të pronësisë së tyre. Ka ende për të bërë, por besoj që tanimë jemi më afër fundit sesa fillimit shumë të ngatërruar të kësaj historie", theksoi z.Rama. Urim përcolli edhe kreu i shtetit shqiptar, Ilir Meta. "Uroj që ngjyrat dhe tingujt e mrekullueshëm pranverorë të përtërijnë optimizmin, shpresën dhe gëzimin në familjet dhe zemrën e secilit prej jush!", u shpreh z.Meta.



**PREMTIMI**

**ILIR META**
"Uroj që ngjyrat dhe tingujt pranverorë të përtërijnë optimizmin, shpresën dhe gëzimin në familjet dhe zemrën e secilit prej jush"!



**EDI RAMA**
"Jemi angazhuar në dhënien e titujve të pronësisë, duke legalizuar godina, kisha, apo xhami, duke bërë regjistrimin".



**LULZIM BASHA**
Kreu i PD kërkon qeverisë heqjen e taksave për tri biznese, për gratë që bëjnë punime dore, për përpunimin e mjaltit etj.



**ERION VELIAJ**
Kryebashkiaku i Tiranës theksoi se pavarësisht disa debateve, puna për ndërtimin e Tiranës do të vijojë. Ndërkohë, ai siguroi nisjen e një sërë projektesh të rëndësishme për qytetin, sikurse do të jenë transformimi i Piramidës, ndërtimi i teatrit të ri dhe ndërtimi i pjesës së mbetur të Bulevardit të Ri.



## Duka: Rama po rikthen institucionet e komunizmit

Kreu i PAA, Agron Duka, kritikoi qeverinë "Rama" lidhur me vendimin për shkrirjen e drejtorive të bujqësisë dhe ngritjen në vend të tyre të agjencive rajonale bujqësore. Ai i cilëson këto agjenci shembulli më i mirë i komunizmit. "Pasi i trajtoi si plaçkë elektorale në 2013-ën, disa prej tyre u drejtuan nga persona pa kualifikimin e duhur, sot i zhbën me një të rënë lapsi. E ka më të thjeshtë të shkatërrojë Ministrinë e Bujqësisë, sesa të vazhdojë të punësojë në to ish-aleatët. Ndonëse përpiqet t'i etiketojë drejtoritë si institucione komuniste; 4 agjenci shërbimi këshillimor dhe 4 agjenci rajonale të veterinarisë që propozohen, janë shembulli më i mirë i komunizmit, sepse centralizojnë pa ndjekur nevojat e fermerëve, të cilët vijojnë të pësojnë eksperimente pa kurrfarë studimi ose mendimi teknik", - tha Duka.

# SITUATA POLITIKE
## REAGIMET

### Suela Janina: Pritshmëritë tona nuk janë të pabaza

# Ambasadorja shqiptare në BE: Presim rekomandim të pakushtëzuar për negociatat

Shqipëria pret hapjen e negociatave të anëtarësimit me BE Brenda këtij viti. Ne shpresojmë të marrim një rekomandim të pakushtëzuar për hapjen e bisedimeve me raportin e prillit të Komisionit Evropian dhe do të shohim Këshillin në qershor për të adaptuar vendimin për hapjen e negociatave". Deklarata është bërë gjatë një interviste të gjatë të ambasadores së Shqipërisë në BE, Suela Janina dhënë për "European Western Balkans", ndërkohë që flet për atë që ka ndodhur në vend, që nga Samiti i Selanikut 15 vjet më parë ku nisi rruga evropiane e Ballkanit, e deri tani, kur në Sofje, pati një samit tjetër ballkanik me BE. "Pritshmëritë tona nuk janë të pabaza. Si një vend kandidat që nga 2014, Shqipëria vazhdon me një forcë vendimtare mbi reformat në sundimin e ligjit, të drejtat themelore dhe qeverisjen e mirë sikurse dhe reforma ambicioze ekonomike" tha ambasadorja. "Ne e kuptojmë që BE pret rezultate konkrete nga Shqipëria dhe procesi i vlerësimit të këtyre rezultateve do të jetë i vështirë, por i drejtë. Nga takimi i Këshillit Evropian në qershor, unë shpresoj se ne do të jemi në gjendje të kemi çështjen tonë, të bindim partnerët në BE që ajo që kërkojmë nuk është favor, apo ndonjë çmim, por një rrugë drejt një vendimi të merituar për të avancuar me negociatat formale, që do të shërbejnë si një katalizator i rëndësishëm për të vazhduar reformat në vend dhe që të kthejë perspektivën e anëtarësimit në një realitet që do të transmetohet më shumë sesa një ëndërr për qytetarët tanë",-tha ambasadorja në intervistë.


Suela Janina



### Kryetarja e LSI flet për raportet me kreun e PD: Ruajmë integritetin e partive tona. Nuk jemi vasalë të njëri-tjetrit

# Aleanca, Kryemadhi: Me Bashën kundër varfërisë

## *"Zgjedhjet vendore, do të përgatitemi për të gjitha variantet"*

Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi, tha dje se problemi i përbashkët që kanë me kreun e PD-së, Lulzim Basha është lufta kundër varfërisë. Ajo tregoi gjatë një interviste për "News 24" se vetëm një ditë më parë ka pasur një telefonatë me kreun e PD-së. "Problemin nuk e kemi tek takimet apo bisedat. Problemi më i madh është që duhet të gjejmë një zgjidhje të përbashkët për varfërinë, nga e cila përfiton krimi e droga më pas", - tha Kryemadhi.

Ndërsa takimet publike mes tyre janë bërë pak më të shpeshta, të shumtë ishin ata që shkruanin një ditë më parë se kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi "po i shkelte sërish syrin" kryeministrit Edi Rama teksa bënte ftesë për bashkëpunim. E ftuar dje në rubrikën "Opinion" në studion e lajmeve në "News 24", zonja Kryemadhi sqaroi se marrëdhëniet e LSI dhe PD, apo komunikimi mes saj dhe Bashës vijon të jetë si më parë. Ajo u shpreh se nuk e sheh kurrsesi komunikimin e tyre sikur njëri të ishte vartësi i tjetrit. "Unë nuk jam vartësja e zotit Basha. Secili prej nesh ruan integritetin e partisë së tij. Askush prej nesh nuk mund të sillet si vasal. Kjo nuk është marrëdhënia jonë", - tha Kryemadhi. E sa për mungesat e daljeve në publik, Kryemadhi tha se ishte së bashku me Bashën e Berishën në 10-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. "Ishim bashkë, ishim ulur afër edhe në parlament. Biseduam për shumë gjëra. Ju kujtoj që bashkëpunimi mes partive nuk janë kafet që pihen në zyrë, bashkëpunimi në terren, në bazë. Ajo që unë mendoj se është e rëndësishme është se çdo kenë shqiptarët për të ngrenë nesër", - tha Kryemadhi. Pas urimit të bërë për Ditën e Verës drejtpërdrejtë nga studio e lajmeve të "News 24", foli edhe për mundësitë e opozitës në lidhje me kandidaturat për zgjedhjet e ardhshme lokale. Ndërsa për kandidaturën e përbashkët në zgjedhje lokale, Kryemadhi tha se janë në fazën e diskutimeve me PD për këtë çështje, duke theksuar se nuk janë ftohur marrëdhëniet me kryedemokratin Lulzim Basha. "Ne jemi në diskutime, jemi në fazën e diskutimeve për kandidatët, gjë që është e rëndësishme për kandidatin që do marrë përsipër jo vetëm fushatën po dhe strategjinë e qytetit në të cilin do kandidojë. Do fillojmë dëgjesat, do hidhen kandidaturat në tryezë, por është herët akoma për të vendosur. Por di të them që LSI do të jetë e përgatitur për të gjitha llojet e varianteve", theksoi kryetarja e LSI-së. "Planet tona janë nga më të ndryshmet, se nga eksperiencat në zgjedhjet lokale të kaluara, në shumicën e rasteve kemi qenë gjithmonë jo të tradhtuar, por strukturat e partive përkatëse nuk e kanë përkrahur kandidatin e LSI, ndërkohë që ne e kemi mbështetur qoftë kandidatin e PS, qoftë të PD. Do plotësojmë Komitetin Drejtues, që do orientojë aksionin politik të LSI në 61 bashkitë e Shqipërisë. Sot Shqipëria nuk ka më luksin për të ndarë programe të majta e të djathta, por forcat politike të unifikohen në luftën kundër varfërisë", tha Kryemadhi.


Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

### Petrit Vasili: LSI do paraqesë paketën e zgjidhjes për varfërinë

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, tha dje se LSI do të paraqesë paketën antivarfëri, për familjet e varfra që qeveria ka nxjerrë nga skema ekonomike. "Aksioni po udhëhiqet nga vetë kryetarja Monika Kryemadhi. Për mua është një varfëri eksplozive, por edhe një eksplozion shoqëror, sepse rreth 800 mijë familjarë pa ndihmë janë një numër i madh për një vend me 2 milionë e 800 mijë banorë", u shpreh Vasili në "FAX News". "Kryeministri është një qeveritar i përciptë dhe për fat të keq shumë i paditur. As lexon dhe as përqendrohet", u shpreh Vasili. Ai tha se duke pasur parasysh të gjitha problemet e mëdha që ka krijuar për vendin, por edhe problemet e veta personale sipas Vasilit, kryeministri Rama është një moment tragjik i vendit. "Një njeri me kaq shumë probleme e halle të brendshme nuk e shëron as tepsia as kazani", - tha ai. Më tej Vasili u shpreh se bashkëpunimi i LSI me Partinë Demokratike si front opozitar vazhdon shumë mirë.





PS mori 140 mln lekë donacione për vitin 2017, ja emrat e sponsorëve të LSI

# "Lobimi rus", KQZ po shqyrton raportin financiar të PD-së

## *PSD harxhon 400 mijë lekë të vjetër për abone*

Darina Tanushi

Partia Socialiste dhe Lëvizja Socialiste për Integrim kanë dorëzuar raportet e tyre financiare pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, njëra në janar dhe tjetra në shkurt. Ndërsa Partia Demokratike e ka dorëzuar së fundmi, por KQZ saktëson se ende punonjësit e administratës janë duke verifikuar nëse përmbushen standardet ligjore dhe më pas raporti i PD do të publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Në fakt, janë pak parti që e kanë dorëzuar këtë raport. Veç PS-së dhe LSI-së, të publikuar në faqe janë raportet e PSD-së, Partia Kristian Demokrate dhe Partia e Personave me Aftësi të Kufizuara. Për raportin financiar të PD-së tashmë ka një interes më të madh, për të parë nëse në këtë dokument është shënuar shifra e paguar prej më shumë se gjysme milioni dollarë e paguar prej saj për lobim në SHBA duke përfshirë dhe kompani ruse. Lobimi i Partisë Demokratike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës shkaktoi debat edhe gjatë mbledhjes së KQZ-së pak ditë më parë. Nënkryetari i KQZ, Denar Biba nisi debatin duke kërkuar që ndaj PD të thellohen hetimet. Por kreu i KQZ, Klement Zguri iu kundërpërgjigj Bibës duke nënvizuar se më herët kishte propozuar vetëm gjobë ndaj PD. "Ju atëherë propozuat 30% gjobë, ka qenë propozimi juaj ky", u shpreh Zguri.

**DEKLARIMET**

Ndërkohë nga dy partitë që kanë dorëzuar raportet financiare, PS nuk ka dorëzuar emrat e donatorëve për vitin, por veç ato të zgjedhjeve të qershorit. Partia Socialiste deklaron se ka 110.120 anëtarë, prej të cilëve ka përfituar të ardhura nga kuotat rreth 40 milionë lekë. Përveç të ardhurave nga buxheti i shtetit dhe ndonjë qira, PS ka deklaruar 14 milionë lekë të rinj donacione. Të ardhurat totale të partisë qeverisëse për vitin 2017 janë 200 milionë lekë. Në tabelën e shpenzimeve, vërehet shuma totale prej 203 milionë lekësh, ku fushata zë vendin kryesor me 89 milionë lekë, ndërsa për kontrata konsulence, ku mund të përfshihet dhe lobimi, deklarohen 6.8 milionë lekë të rinj. Ndryshe nga PS, Lëvizja Socialiste për Integrim ka deklaruar 7.8 milionë donacione dhe ka publikuar 57 emrat që kanë dhuruar për këtë parti më shumë se 1 milion lekë. Një vlerë të tillë rezulton të ketë paguar edhe ishkryetari Ilir Meta, i cili gjatë gjysmës së parë të vitit 2017 ishte anëtar i kësaj partie. Shuma më e madhe e dhuruar për LSI-në u takon dy personave: deputetit Viktor Tushaj dhe një personi të quajtur Mustafa Hoxha.



Pasqyrat Financiare 2017

LËVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM



PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE
ASAMBLEJA KOMBETARE
KRYEFINANCIERI

Nr. 15 Prot. Tiranë, më 02/02/2018

Lënda: Raporti financiar vjetor 2017

KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE

TIRANË

Mbështetur në Vendimin tuaj me nr.3 datë 18.01.2011 po ju paraqesim sipas Lidhjes 2 të këtij vendimi Raportin Financiar Vjetor të 2017.

1.1 Informacion i përgjithshëm

I- Antarësia e PS deri 31 Dhjetor 2017 është 110.120 anëtar

II- STRUKTURA e PS

A) ORGANET VENDORE

- Organizata socialiste ....................4962
- Këshilla socialiste të Njësive Administrative ........400
- Asamble Socialiste të Bashkive ....................61
- Këshilla koordinues të Partisë Socialiste në Qark ......12

Faksimile të raporteve financiare të PS dhe LSI

**PARTIA DEMOKRATIKE**

Burimet nga KQZ bënë me dije se Partia Demokratike e ka dorëzuar raportin e saj financiar për vitin që shkoi, por gjithçka është duke u shqyrtuar nga administratat e këtij institucioni, nëse është në përputhje me ligjin. Ndaj edhe ende raporti i PD-së nuk është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së.

**PARTIA SOCIALDEMOKRATE**

Partia Socialdemokrate është njëra nga ato pak parti që kanë dorëzuar raportet financiare për vitin 2017. Ajo deklaron një shumë prej 6.590.683 lekë të shpenzuara gjatë vitit që shkoi. Bie në sy që në listën e shpenzimeve janë përdorur 40.800 lekë për abone, ndërsa shpenzimet për fushatën e qershorit janë 3.757.621 lekë.

**FINANCAT E PS PËR 2017**

| | |
|---|---|
| **Të ardhurat** | |
| Financimi i buxhetit për 2017 | 142.114.178 |
| Qira ambienti (dhurim) | 4.111.277 |
| Kuotat e rretheve | 20.338.208 |
| Kuotat e anëtarësisë | 19.135.000 |
| Të tjera | 139.576 |
| Qira AMC | 750.000 |
| Donacione | 14.000.000 |
| ***Shuma*** | ***200.588.239*** |
| **Shpenzimet** | |
| Shpenzimet e përditshme për stafin/personelin | 86.410.821 |
| Shpenzime për energji elektrike | 1.853.530 |
| Shpenzime për ujë | 219.993 |
| Shpenzime për telefon e cel.postare | 1.192.272 |
| Taksat | 300.153 |
| Hotele e dieta, udhëtime | 1.495.311 |
| Fushata | 89.771.575 |
| Qira ambienti | 7.841.837 |
| Shpenzime të ndryshme | 4.264.762 |
| Kredi makine | 1.000.000 |
| Kontratë konsulence | 6.880.000 |
| Kuota europiane | 2.246.708 |
| ***Shuma*** | ***203.476.962*** |

**DONATORËT E LSI**

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Mustafa Hoxha | 676.050 |
| 2. | Ardian Alushi | 100.000 |
| 3. | Nasip Naço | 100.000 |
| 4. | Viktor Tushaj | 121.235 |
| 5. | Edmond Stojku | 100.000 |
| 6. | Alfred Sadikaj | 100.000 |
| 7. | Elona Guri | 100.000 |
| 8. | Edlira Dilaveri | 200.000 |
| 9. | Erisi Zaimi | 100.000 |
| 10. | Gëzim Podgorica | 100.000 |
| 11. | Bahri Shaqiri | 100.000 |
| 12. | Endrit Braimllari | 100.000 |
| 13. | Vangjel Tavo | 100.000 |
| 14. | Ilir Meta | 100.000 |
| 15. | Majlind Lazimi | 100.000 |
| 16. | Luan Rama | 100.000 |
| 17. | Dorian Veli | 100.000 |
| 18. | Eduart Seitaj | 100.000 |
| 19. | Aurel Lamçe | 100.000 |
| 20. | Taulant Kalo | 100.000 |
| 21. | Juliana Hoxha | 100.000 |
| 22. | Entiol Laço | 100.000 |
| 23. | Xheladin Toro | 100.000 |
| 24. | Mirela Meko | 100.000 |
| 25. | Eriona Bixha | 100.000 |
| 26. | Valbona Ballgjini | 100.000 |
| 27. | Argent Alltari | 100.000 |
| 28. | Gjovalin Bushi | 100.000 |
| 29. | Rudina Hoxha | 100.000 |
| 30. | Argita Totozani | 100.000 |
| 31. | Aleksandër Lipivani | 100.000 |
| 32. | Athanas Kraja | 100.000 |
| 33. | Ilir Qata | 100.000 |
| 34. | Julian Beqiri | 100.000 |
| 35. | Adriana Sokoli | 100.000 |
| 36. | Adela Karapici | 100.000 |
| 37. | Joana Smakaj | 100.000 |
| 38. | Davida Curri | 100.000 |
| 39. | Alqi Bllako | 111.200 |
| 40. | Blenard Nonaj | 100.000 |
| 41. | Blendi Kotorri | 100.000 |
| 42. | Edmond Panariti | 150.000 |
| 43. | Arjan Korpa | 100.000 |
| 44. | Viktor Tushaj | 512.500 |
| 45. | Piro Kapurani | 200.000 |
| 46. | Floida Kërpaçi | 125.000 |
| 47. | Ilir Cenolli | 200.000 |
| 48. | Sention Zotaj | 100.000 |
| 49. | Daniela Cekani | 100.000 |
| 50. | Sokol Mici | 100.000 |
| 51. | Tedian Loci | 410.000 |
| 52. | Ardjan Gjoni | 100.000 |
| 53. | Gjergji Petro | 313.000 |
| 54. | Florian Lusha | 110.000 |
| 55. | Shyqyri Kapllani | 200.000 |
| 56. | Sara Lleshi | 145.000 |
| 57. | Sajmir Banda | 100.000 |
| ***Totali*** | | ***7.823.985 lekë*** |



### Kryeministri do të flasë për ndihmën ekonomike

## Sot 8 orë debat në Kuvend, PD kërkoi mocion me Ramën

Seanca e sotme parlamentare pritet të zgjasë me orë të tëra, pasi deputetët e opozitës do të diskutojnë për heqjen e mbi 20 mijë familjeve në nevojë nga skema e ndihmës ekonomike, por edhe për çështje të tjera. Kryeministri Edi Rama u përgjigjet sot kërkesave të deputetëve të PD-së, të cilët e kanë thirrur në një mocion me debat, pikërisht për këtë çështje. Lista e deputetëve të PD-së, ashtu edhe nga LSI e PS është e gjatë për seancën e sotme, e cila në rendin e ditës do të ketë edhe projektligjin "Për një ndryshim në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar"" (pdf) (neni 177 i Kushtetutës dhe nenet 77/a dhe 77/b të Rregullores, votim me shumicë prej 2/3 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit). Po kështu, deputetët do të diskutojnë edhe për projektligjin "Për miratimin e shtesës së kontratës së koncesionit të formës "BOT" (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës. Një pikë tjetër është edhe projektvendimi "Për zgjedhjen e Komisionerëve të Avokatit të Popullit".

# TAKSAT
## ÇMIMET

Taksa e re e pronës, ja si do të bëhet vlerësimi për çdo pasuri në të gjithë vendin

# Vendimi i qeverisë, çmimet e reja të referencës, për taksën e shtëpive

*Zbardhet tabela për të gjithë vendin*



Ornela Manjani

Qeveria miraton çmimet e reja të referencës për të gjithë vendin. Mbi bazën e çmimeve të reja të referencës do të aplikohet taksa mbi ndërtesat, e cila hyn në fuqi në 1 prill. Sipas metodës së miratuar në 7 mars, të gjithë personat që kanë në pronësi një shtëpi, garazh të mbyllur apo ambient tjetër do të paguajnë taksë mbi ndërtesën 0.05%, e cila do të llogaritet mbi vlerën hartën e vlerës.

**GRUPET QË TAKSOHEN**

Taksapagues është çdo individ, person fizik ose juridik, vendës ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave. Detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" e kanë, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse të lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

**VLERA E PASURISË**

Vlerë e pasurisë është vlera aktuale e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore e njohur me dokumente ligjore, ose vlera e përcaktuar me një nga metodat e përshkruara në këtë metodologji. Vlera e pasurisë është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore. Ndërsa "veprimtari ekonomike", konsiderohet çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dhe veprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet gjithashtu, shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.

**PËRCAKTIMI I ÇMIMIT VLERËSUES**

Përcaktimi i vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore bazohet mbi prioritetet e vlerësimit, duke ndjekur një radhë të caktuar. Baza e vlerësimit mbështetet te vetëdeklarimi, si një detyrim për çdo taksapagues, për të vijuar më tej edhe me metodat alternative, nëse vetëdeklarimi nuk bëhet, nuk është i saktë apo nuk disponohen të dhëna të plota për një vlerësim të drejtë të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore, që duhet të taksohet. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për efekt të përcaktimit të bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme (ndërtesë) ndjekin këtë radhë vlerësimi:

**VETËDEKLARIMI**

Çdo taksapagues duhet të vetëdeklarojë të dhënat për pasurinë e tij të paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore, që ka në pronësi apo në përdorim. Vetëdeklarimi bëhet pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore apo çdo institucioni të autorizuar nga qeveria apo njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të marrë dhe për të përpunuar informacionin e vetëdeklarimit të taksapaguesit, për qëllim të zbatimit të legjislacionit përkatës të taksës mbi pasurinë e paluajtshme. Në rast se vlera e vetëdeklaruar nga taksapaguesi rezulton e ndryshme nga vlera e llogaritur me çmim e vlerësuar, të përcaktuar me këtë metodologji, si vlerë e bazës së taksës do të merret vlera më e lartë.

**PAGESAT PËR SHTËPI E BIZNESE**

Për efekt të llogaritjes së taksës për ndërtesën/njësi pronësore, baza e taksës shumëzohet me shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj, sipas kategorive të ndërtesave:

a) 0,05%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim.

b) 0,2%, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike.

c) 30% e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

**SIPËRFAQJA E PREZUMUAR**

Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njësisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijon:

a) 100 (njëqind) metra katrorë sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim.

b) 70 (shtatëdhjetë) metra katrorë sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr.7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar.



**ÇMIMI DHE NDËRTESA**

"Çmim vlerësues", njësia matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut, ose çmimi i vlerësuar i përcaktuar me këtë metodologji.

**ÇMIMET MESATARE REFERUESE TË SHITBLERJES SË NDËRTESAVE**

| | Nr. | Zona | Lekë/m2 sipërfaqe Shfrytëzimi |
|---|---|---|---|
| Qyteti Tiranë | 1 | 1/1 | 97 700,00 Lekë |
| | 2 | 1/2 | 78 000,00 Lekë |
| | 3 | 2/1 | 187 000,00 Lekë |
| | 4 | 2/2 | 134 500,00 Lekë |
| | 5 | 2/3 | 95 000,00 Lekë |
| | 6 | 2/4 | 110 000,00 Lekë |
| | 7 | 2/5 | 80 000,00 Lekë |
| | 8 | 3/1 | 77 000,00 Lekë |
| | 9 | 3/2 | 60 000,00 Lekë |
| | 10 | 4/1 | 70 000,00 Lekë |
| | 11 | 4/2 | 60 000,00 Lekë |
| | 12 | 5/1 | 190 000,00 Lekë |
| | 13 | 5/2 | 132 000,00 Lekë |
| | 14 | 5/3 | 107 000,00 Lekë |
| | 15 | 5/4 | 82 000,00 Lekë |
| | 16 | 6 | 65 000,00 Lekë |
| | 17 | 7/1 | 120 000,00 Lekë |
| | 18 | 7/2 | 100 000,00 Lekë |
| | 19 | 7/3 | 85 000,00 Lekë |
| | 20 | 7/4 | 65 000,00 Lekë |
| | 21 | 8/1 | 110 000,00 Lekë |
| | 22 | 8/2 | 100 000,00 Lekë |
| | 23 | 8/3 | 72 000,00 Lekë |
| | 24 | 9/1 | 130 000,00 Lekë |
| | 25 | 9/2 | 100 000,00 Lekë |
| | 26 | 9/3 | 77 000,00 Lekë |
| | 27 | 10/1 | 145 000,00 Lekë |
| | 28 | 10/2 | 139 500,00 Lekë |
| | 29 | 10/3 | 102 000,00 Lekë |
| | 30 | 11/1 | 87 000,00 Lekë |
| | 31 | 11/2 | 75 000,00 Lekë |
| | 32 | 11/3 | 70 000,00 Lekë |
| Njësitë Administrative Bashkia Tiranë | 33 | Baldushk | 32 000,00 Lekë |
| | 34 | Bërzhitë | 34 000,00 Lekë |
| | 35 | Dajt | 53 500,00 Lekë |
| | 36 | Farkë | 66 500,00 Lekë |
| | 37 | Kashar | 53 500,00 Lekë |
| | 38 | Krrabë | 28 200,00 Lekë |
| | 39 | Ndroq | 34 000,00 Lekë |
| | 40 | Petrelë | 53 500,00 Lekë |
| | 41 | Pezë | 53 500,00 Lekë |
| | 42 | Shëngjergj | 23 000,00 Lekë |
| | 43 | Vaqarr | 34 000,00 Lekë |
| | 44 | Zall-Bastar | 25 000,00 Lekë |
| | 45 | Zall-Herr | 28 200,00 Lekë |



## Vlera e pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", pushteti vendor përgatit regjistrin e të dhënave

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me kompetencat e kuadrit ligjor në fuqi, kryejnë korrektime në regjistrin e bazës të të dhënave. Korrektimet kryhen bazuar në verifikimet periodike në terren për sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore. Sipas vendimit, verifikimi në terren shërben edhe për të regjistruar për herë të parë ndërtesa/njësi pronësore ose nënndarje të saj. Në këtë rast, njësitë e vetëqeverisjes vendore kërkojnë informacion nga burime zyrtare, nëse ka, për sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore apo nënndarjen dhe e krahasojnë me verifikimin e kryer. Nëse nuk sigurojnë informacione lidhur me sipërfaqen e ndërtesave të identifikuara, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë vetë vlerësimin e ndërtesës/njësisë pronësore mbi sipërfaqen e verifikuar në terren. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas procedurave të përcaktuara në këtë metodologji, në çdo rast, pasi bëjnë vlerësimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme, hedhin të dhënat në regjistrin e bazës së të dhënave, për efekt të përcaktimit të bazës së taksës dhe llogaritjes së shumës së taksës për t'u paguar nga taksapaguesi.



### Verifikimi i ndërtesave që i nënshtrohen detyrimit fiskal

# Përcaktohen afatet për pagesën e taksës

## *Punonjësit, matje derë më derë*

Afati kohor i hedhjes së të dhënave të siguruara nga verifikimi në terren në sistemin e bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme nuk duhet të jetë më vonë se 30 ditë kalendarike nga dita e mbajtjes së aktit të verifikimit. Në çdo rast të ndryshimit të të dhënave në sistemin e bazës së të dhënave, qoftë nga verifikimi në terren, qoftë edhe si rezultat i korrektimit apo i vendimit të strukturës vendore të apelimit apo pas një vendimi të formës së prerë të marrë nga Gjykata Administrative, hedhja e të dhënave nuk duhet të jetë më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga marrja e vendimit.

### VERIFIKIMI I NDËRTESAVE

Njësia e vetëqeverisjes vendore gëzon të drejtën të bëjë çdo vit verifikime në terren deri në 20 për qind të territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Në këtë rast, procesi i verifikimit shërben për verifikimin e ndryshimeve të mundshme në ndërtesat/njësitë pronësore ekzistuese, të cilat ndikojnë në ndryshimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme dhe për rrjedhojë, edhe të shumës së taksës për t'u paguar. Të tilla ndryshime lidhen me zgjerim të sipërfaqes së ndërtesës/njësisë pronësore, shtesat në kate, përmirësime strukturore, tjetërsim të pronësisë, ndryshim të përdorimit dhe që kërkon ndryshimin e shkallës së taksës, përjashtimin nga taksa apo të humbjes të së drejtës së përjashtimit nga taksa etj. Gjithashtu, ky proces shërben dhe për identifikimin e ndërtesave/njësive pronësore të reja, të pahedhura në sistem. Në rast të verifikimit të ndërtesave/njësive pronësore që nuk rezultojnë në sistemin qendror të të dhënave, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të realizojë regjistrimin e plotë të tyre, duke plotësuar të gjitha elementet e informacionit të kërkuar nga sistemi. Në të gjitha rastet e mësipërme, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të bëjë me dije subjektin taksapagues për detyrimin e lindur. Verifikimi i të dhënave bëhet nga ana e nëpunësit përgjegjës në bashki për taksën e pasurisë së paluajtshme (ndërtesë). Nëpunësi përgjegjës, për taksën mbi ndërtesën në njësinë e vetëqeverisjes vendore ka të drejtën dhe detyrimin të bëjë rishikimin dhe verifikimin e të gjithë dokumentacionit të mbledhur gjatë procesit të verifikimit në terren, të aktit të verifikimit të mbajtur, si dhe të konfirmojë saktësinë e tyre. Në rast se dokumentacioni përmban gabime, mangësi apo pasaktësi, ai u kërkon punonjësve që kanë plotësuar dokumentacionin rishikimin e tij, si dhe nëse është e nevojshme, përsëritjen e procedurës së verifikimit.

**TE DHENAT**

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas procedurave të përcaktuara në këtë metodologji, në çdo rast, pasi bëjnë vlerësimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme, hedhin të dhënat në regjistrin e bazës së të dhënave, për efekt të përcaktimit të bazës së taksës dhe llogaritjes së shumës së taksës për t'u paguar nga taksapaguesi.

**ÇMIMET MESATARE REFERUESE TË SHITBLERJES SË NDËRTESAVE**

| Qarku | Nr. | Qyteti | Lekë/m2 sipërfaqe Shfrytëzimi |
|---|---|---|---|
| Tiranë | 1 | Vorë | 51 500,00 Lekë |
| | 2 | Kamëz | 52 000,00 Lekë |
| | 3 | Kavajë | 51 000,00 Lekë |
| | 4 | Rrogozhinë | 41 000,00 Lekë |
| Durrës | 6 | Durrës | 67 500,00 Lekë |
| | 7 | Krujë | 48 500,00 Lekë |
| | 8 | Shijak | 41 000,00 Lekë |
| | 9 | Fushë-Krujë | 51 000,00 Lekë |
| Shkodër | 10 | Shkodër | 58 000,00 Lekë |
| | 11 | Pukë | 22 000,00 Lekë |
| | 12 | Vau i Dejës | 24 300,00 Lekë |
| | 13 | Koplik | 40 500,00 Lekë |
| | 14 | Fushë - Arrës | 7 500,00 Lekë |
| Vlore | 15 | Vlorë | 61 800,00 Lekë |
| | 16 | Orikum | 60 000,00 Lekë |
| | 17 | Selenicë | 25 000,00 Lekë |
| | 18 | Himarë | 58 000,00 Lekë |
| | 19 | Sarandë | 56 000,00 Lekë |
| | 20 | Delvinë | 26 750,00 Lekë |
| | 21 | Konispol | 28 000,00 Lekë |
| Korçë | 22 | Korçë | 45 800,00 Lekë |
| | 23 | Pogradec | 49 900,00 Lekë |
| | 24 | Bilisht | 35 000,00 Lekë |
| | 25 | Ersekë | 23 000,00 Lekë |
| | 26 | Maliq | 27 800,00 Lekë |
| | 27 | Leskovik | 21 000,00 Lekë |
| Fier | 28 | Fier | 53 100,00 Lekë |
| | 29 | Lushnjë | 40 100,00 Lekë |
| | 30 | Ballsh | 30 000,00 Lekë |
| | 31 | Patos | 28 000,00 Lekë |
| | 32 | Divjakë | 49 500,00 Lekë |
| | 33 | Roskovec | 30 000,00 Lekë |
| Berat | 34 | Berat | 41 400,00 Lekë |
| | 35 | Kuçovë | 36 000,00 Lekë |
| | 36 | Poliçan | 26 000,00 Lekë |
| | 37 | Çorovodë | 25 000,00 Lekë |
| | 38 | Ura - Vajgurore | 37 000,00 Lekë |
| Elbasan | 39 | Elbasan | 50 300,00 Lekë |
| | 40 | Librazhd | 44 000,00 Lekë |
| | 41 | Cërrik | 38 300,00 Lekë |
| | 42 | Gramsh | 43 000,00 Lekë |
| | 43 | Peqin | 39 000,00 Lekë |
| | 44 | Përrenjas | 41 780,00 Lekë |
| | 45 | Belsh | 35 000,00 Lekë |
| Gjirokastër | 46 | Gjirokastër | 47 400,00 Lekë |
| | 47 | Përmet | 37 000,00 Lekë |
| | 48 | Tepelenë | 32 500,00 Lekë |
| | 49 | Memaliaj | 15 000,00 Lekë |
| | 50 | Këlcyrë | 24 600,00 Lekë |
| | 51 | Libohovë | 27 000,00 Lekë |
| Lezhë | 52 | Lezhë | 56 000,00 Lekë |
| | 53 | Mamurras | 42 500,00 Lekë |
| | 54 | Rrëshen | 42 000,00 Lekë |
| | 55 | Rubik | 29 500,00 Lekë |
| Kukës | 56 | Kukës | 54 000,00 Lekë |
| | 57 | Bajram Curri | 27 900,00 Lekë |
| | 58 | Krumë | 24 500,00 Lekë |
| Dibër | 59 | Peshkopi | 49 000,00 Lekë |
| | 60 | Burrel | 44 300,00 Lekë |
| | 61 | Bulqizë | 41 800,00 Lekë |
| | 62 | Klos | 32 000,00 Lekë |
| Njësi Administrative | 63 | Shëngjin | 56 000,00 Lekë |
| | 64 | Milot | 34 000,00 Lekë |


EPSA enforcement private service

**SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:**

1. **Are** me nr.33/26, e ndodhur ne Karpen, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099,vol.11, fq.202, me sip.2,000 m2, cmimi që do të shitet është **3.942.960** lekë.
2. **Are** dhe truall me **nr.1/88**, e ndodhur ne Qerret, Kavaje, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.9, fq.34, me sip.1,770 m2 cmimi që do të shitet është **9.770.655** lekë.
3. **Are** me nr.33/27, e ndodhur ne Karpen. Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099, vol.1, fq.203, me sip.4,050 m2 cmimi që do të shitet është **7.984.494** lekë.
4. **Are** me nr.70/9, e ndodhur ne Qerret, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.2, fq.106, me sip.6,460 m2 cmimi që do të shitet është **5.094.305** lekë.
5. **Njësi** me nr.15/22+1-N1 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 14/69, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.116 m2 vlerësohet me vlerën e **10.062.434** lekë.
6. **Njësi** me nr.15/22+1-N2 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 14/70, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.91 m2 vlerësohet me vlerën e **7.893.806** lekë.
7. **Njësi** me nr.15/22+1-N3 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551,nr.rregjistri hipotekor 15/71, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.95 m2 vlerësohet me vlerën e **8.240.786**lekë.
8. **Njësi** me nr.15/22+1-N4 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551,nr.rregjistri hipotekor 15/72, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.211 m2 vlerësohet me vlerën e **18.303.221** lekë.
9. **Bodrum** me nr.15/22+1-B e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 130/176, vl.2005-2007, datë 24.09.2007 me sip.609 m2 vlerësohet me vlerën e **14.734.842** lekë.

Te gjitha pasurite e sipërcituara jane hipotekuar në favor te **Banka Raiffeisen sha.** Ankandi zhvillohet ne **datë 09.04.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane. Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al



**Shoqëria Përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme:**

*Pasurisë me Nr. 7/34, e llojit "Apartament ", me sip. 50.2 m², dhe sip.trualli 19 m², ndodhur në Q. Memaliaj, Tepelenë ZK.2646,*në pronësitë **Skënder Feta Muka.** Çmimi fillestar në ankandin e parë është 537,124.64 Lekë.

Ankandi zhvillohet në datë **19.03.2018, ditën e Hënë ora 15.30** në ambjentet e **Shoqërisë Përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë. Për më shumë info.** Tel:044503458 **ose E-mali** shoqeriapermbarimoreafa2010@gmail.com

Legalizimet, përfituesit të paraqiten në Hipotekë për të marrë certifikatën e pronësisë

# ALUZINI: 412 personat që kanë gati tapitë e shtëpive

## *Lista me pronarët në qarkun e Elbasanit*

Ornela Manjani

ALUIZNI publikon listën me 412 persona që kanë ndërtuar pa leje dhe pasi u është miratuar leja e legalizimit duhet të paraqiten në Hipotekë për të marrë certifikatën e pronësisë. Përfituesit janë në qarkun e Elbasanit. Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga AULIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të aplikojnë për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesin të legalizimit, por gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat, për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin, nëpërmjet një kërkese me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

| NR | EMER MBIEMER |
|---|---|
| 1 | ROBERT SINA |
| 2 | TOMORR ALI ALLKJA |
| 3 | SERVET FERO |
| 4 | DHURIM DERVISHI |
| 5 | PELLUMB ABDYL DERVISHI |
| 6 | ASTRIT IBRAHIM BRAHJA |
| 7 | NDERIM SELMAN BAJRAMI |
| 8 | DHURIM MEHDI DERVISHI |
| 9 | FISNIK XHAVIT RAMA |
| 10 | GEZIM MUSTAFAJ |
| 11 | ALBERT HARUN TASHI |
| 12 | GEZIM KADRI SHIMA |
| 13 | YZEIR SHERIF KUMURIJA |
| 14 | SELIM HAKI SADE |
| 15 | ARDIT XHAVIT RAMA |
| 16 | BEHAR SULEJMAN BALLIU |
| 17 | JONUZ REFIK BUDANI |
| 18 | EDUARD HALIL KOLONJARI |
| 19 | RIZA IBRAHIM PEPA |
| 20 | MUSTAFA DAUT LULI |
| 21 | NAIFI MUSTAFABALLA |
| 22 | SHKELQIM KADRI BAXHAKU |
| 23 | ILIR MEHMET STAFA |
| 24 | IRAKLI RISTO TOCI |
| 25 | MUSTAFA ADEM DERVISHI |
| 26 | LUAN BAJRAM SINA |
| 27 | PERPARIM PELLUMB ZDRAVA |
| 28 | OSMAN MEHMET SINA |
| 29 | BAKI OSMAN TAFANI |
| 30 | DEMIR FAIK TAFANI |
| 31 | DYLAVER ARIF BAHJA |
| 32 | FASLLI XHEVIT MEHALLA |
| 33 | NAZMI RAPUSH KOCI |
| 34 | MIKEL FATMIR TAFANI |
| 35 | ALEKS HALIT SINA |
| 36 | ANEST SELMAN KLLOGJERI |
| 37 | YLLI SHYQERI DERVISHI |
| 38 | AGRON JAKUP BALLA |
| 39 | DURIM ISLAM BALLA |
| 40 | AGIM QAZIM PROI |
| 41 | FLERIT SAFET BUDANI |
| 42 | BASHKIM BEQIR DERVISHI |
| 43 | ARJAN HALIT SINA |
| 44 | AGIM RRAHMAN KASO |
| 45 | LINDITA MISTOKLI VERUSHI |
| 46 | GUXIMTAR ISUF MUSTAFA |
| 47 | HYQMET RESHIT DYBELI |
| 48 | FLAMUR MUHARREM IBRUSHI |
| 49 | AGIM SABRI BUZANI |
| 50 | ADILE ALI DYRMYSHI |
| 51 | PERPARIM NAZMI CELA |
| 52 | FEJZULLA GANI MUZHAQI |
| 53 | SHKELQIM HASAN LUKANI |
| 54 | LUAN QANI KERKAPI |
| 55 | HASAN ADEM COGA |
| 56 | TEBA SHPK |
| 57 | SHPETIM RIZA QOSJA |
| 58 | HALIT HASAN GJINI |
| 59 | LIGOR DHIMITER SINANI |
| 60 | ENVER REFIK RRESHKA |
| 61 | AISHE AHMET BICA |
| 62 | VASIF NAZMI BALASHI |
| 63 | ALI LATIF PEPA |
| 64 | MUSA MUSTAFA HAZIZI |
| 65 | DALIP HYSNI HASANI |
| 66 | LUAN QERIM HAMATI |
| 67 | HYQMET LIMON BRAGJECI |
| 68 | BEXHET TEFIK KAPLLANI |
| 69 | ALTIN RAMAZAN BICAKU |
| 70 | FESTIM OSMAN BASHA |
| 71 | PERPARIM SHEFQET FERHATI |
| 72 | AGIM XHAFERR MURATI |
| 73 | BAJRAM HYSEN URUCI |
| 74 | BESIM DERVISH ZYLI |
| 75 | XHEVIT SHYQYRI BULLARI |
| 76 | SKENDER KADRI NIPOLLI |
| 77 | SALI SHAHIN NIPOLLI |
| 78 | ERJON BESIM TAFANI |
| 79 | YMER HYQMET BAHA |
| 80 | ARBEN PELLUMB TAFANI |
| 81 | GENTIAN JAHO TAFANI |
| 82 | HYSEN QAZIM BOZHIQI |
| 83 | PERPARIM ALI BEZATI |
| 84 | DRITAN MEHMET ASLLANI |
| 85 | SHEFKI MEHMET ASLLANI |
| 86 | NEXHMEDIN XHELAL BAHA |
| 87 | VASIL VANI BARGJO |
| 88 | ENVER SHYQYRI HIMCI |
| 89 | YLLKA BEQIR HIMCI |
| 90 | BEDRI TELHA RADOVICKA |
| 91 | GAZMEND VATH HIDA |
| 92 | ALI ADEM HOXHA |
| 93 | SHPETIM YMER BEDELI |
| 94 | TOMORI FADIL SALLA |
| 95 | IMER MEHMET POCI |
| 96 | SHEFQET QAMIL PISHA |
| 97 | ISUF RAMAZAN META |
| 98 | ISUF SINAN SINANI |
| 99 | AGIM XHEMAL ZELLI |
| 100 | DITURI ISUF FEKOLLI |
| 101 | KRISTAQ ZOTO MOSKO |
| 102 | IBRAHIM ADURRAHMAN PERLEPI |
| 103 | BARDHYL IBRAHIM METANI |
| 104 | MUHARREM HAMIT TROKOLICI |
| 105 | LUAN QAZIM KOCI |
| 106 | HEKURAN XHEMAL BITRA |
| 107 | HABIBE BAJRAM DACI |
| 108 | ERALDA SABRI DACI |
| 109 | JONUZ LIMON SINA |
| 110 | FAIK XHEMAL GJYLA |
| 111 | FAIK XHEMAL GJYLA |
| 112 | GRAMOZ SEFEDIN FERHATI |
| 113 | QEMAL RIZA URUCI |
| 114 | FATOS SALI HAKUSHI |
| 115 | NDRICIM SALI GERDUQI |
| 116 | OLSI ELMAZ SHEHI |
| 117 | BEHAR ASLLAN KUQJA |
| 118 | VASIL ASLLAN SHKIRA |
| 119 | JAKUP ADEM CANI |
| 120 | DRITAN MEHMET STAFA |
| 121 | EDUARD HAMDI SKORA |
| 122 | RAMAZAN SALI HAKUSHI |
| 123 | MUSA IBRAHIM COGA |
| 124 | DRITAN YMER TASHI |
| 125 | BASHKIM XHEMAL POCI |
| 126 | ZYBER MUSTAFA CARKU |
| 127 | LEFTERIE MUSA TANUSHI |
| 128 | FATMIR ISMAIL LAZI |
| 129 | ARDJAN ISLAM GJOLENA |
| 130 | RRAPUSH LIMAN BUZANI |
| 131 | FATMIR ABAZ GJINI |
| 132 | RRAPUSH HYSEN KOCI |
| 133 | NIKOLL KOSTANDIN KARAJ |
| 134 | MEHMET JASIM BAJRAMI |
| 135 | ERMIR RESMI DERVISHI |
| 136 | ASQERI SHEFQET PAJA |
| 137 | VAJTHI SULEJMAN |
| 138 | LUMTURI FAIK FERHATI |
| 139 | ETLEVA HASAN LUMSHI |
| 140 | FLORENC DHYLQIT PEPA |
| 141 | REDIN SHKELQIM LUMARAKU |
| 142 | ARDIAN XHEVIT PECI |
| 143 | SHABAN SHAQIR MOLLOSMANI |
| 144 | ERMAND VERI HYSA |
| 145 | FERIM BAJRAM KULLOLLI |
| 146 | ANDREA BESHIR SHTYLLA |
| 147 | DITJON MYZAFER PEPA |
| 148 | NEXHMIJE KARAFIL JUPA |
| 149 | SERVET BESHIR SHTYLLA |
| 150 | BEDRI VEIZ MALJA |
| 151 | FATOS BEDRI PEPA |
| 152 | MEHMET SALI META |
| 153 | HYQMET ALI META |
| 154 | HASAN REFAT LLESHI |
| 155 | HAXHI OSMAN MUCA |
| 156 | GENTJAN NAZMI BICA |
| 157 | ORIAN YMER XHINA |
| 158 | ARDIAN JONUZ BICA |
| 159 | YMER ISLAM ALLUSHI |
| 160 | FETAH SELIM RUSTA |
| 161 | NAIM AHMET TUFA |
| 162 | ARBEN RIZA CANI |
| 163 | FATMIR IBRAHIM BURRAJ |
| 164 | SHERIF MUSA BURRAJ |
| 165 | GJON ZEF DOKU |
| 166 | VANGJEL SELMAN BALLIU |
| 167 | PETRIT KOVACI |
| 168 | ALEKSANDER STAVER QOSJA |
| 169 | MUSA IDRIZ LICI |
| 170 | SKENDER REFAT URUCI |
| 171 | HARUN AQIF GJOSHI |
| 172 | RAMADAN QAZIM DYRMYSHI |
| 173 | FERDINAND RIZA QEFA |
| 174 | BLERIM AGIM DEBROVA |
| 175 | ROBERT REFAT SAMURRI |
| 176 | KRISTO FEIM BIBA |
| 177 | SOKRAT MAHMUT ZHABINA |
| 178 | BAJRAM AHMET SHEHI |
| 179 | ABAS FETAH SHKAMBI |
| 180 | EDUART BEDRI PEPA |
| 181 | SULEJMAN SABRI BALLIU |
| 182 | AGIM XHEVIT POCI |
| 183 | ALBERT GANI KULLAFI |
| 184 | TAHSIM ISMAIL CERRIKU |
| 185 | NERITAN DHIMITER MALO |
| 186 | ILMI HAJDAR MIRAKA |
| 187 | XHEVAHIR QEMAL SULA |
| 188 | ALTIN HARUN ASLLANI |
| 189 | VULLNET NAZMI CERRIKU |
| 190 | QERIM KUJTIM DYRMA |
| 191 | ALTIN XHEVIT PECI |
| 192 | TAJAR MURAT CELA |
| 193 | HATIXHE DERVISH KAMOLLI |
| 194 | MYSLIM BEQIR QOSJA |
| 195 | PERPARIM JOSIF CAKALLI |
| 196 | ASTRIT SELIM PAESHTI |
| 197 | REFAT VEIS SALLJA |
| 198 | NESHAT QEMAL TAFANI |
| 199 | FATOS QAMIL MUCA |
| 200 | ORGEST RYZHDI HAKA |
| 201 | EQEREM RUSHIT DRIZAJ |
| 202 | VIKTOR PREN MUCA |
| 203 | DHIMITER JANI HYKA |
| 204 | FATMIR KADRI MUCA |
| 205 | RIZA REFAT IDRIZI |
| 206 | DRITAN VELI HAKA |
| 207 | MUSTAFA IDRIZ BEQIRI |
| 208 | FATBARDH SHABAN FEZULLAHU |
| 209 | KUJTIM JANI DEDJA |
| 210 | MEHMET QAMIL KALASHI |
| 211 | PERPARIM XHEVAHIR CADRI |
| 212 | GEZIMEND RAMAZAN NIPOLLI |
| 213 | THOMA GAQO VISHNJA |
| 214 | FATMIR MIN DEDJA |
| 215 | HYSNI PASHO MURATI |
| 216 | LUAN ISMAIL SOLLAKU |
| 217 | BEHAR REXHEP MUCA |
| 218 | SKENDER SHABAN MIRAKA |
| 219 | KISHA ORTHODHOKSE |
| 220 | ADRIATIK FAIK DRAGOTI |
| 221 | DALLANDYSHE MEHMET PRECI |
| 222 | XHEZMI BEDRI DUNGA |
| 223 | MIKELJAN KUJTIM TOLA |
| 224 | XHANE XHELO KAPLLANAJ |
| 225 | ARDJAN ANASTAS BINJAKU |
| 226 | NAZMI XHAFERR MOLLOSMANI |
| 227 | AGRON BEQIR SINA |
| 228 | AVNI HALIT SINA |
| 229 | PETRIT SOKRAT GEGA |
| 230 | GENTIAN PETREF IDRIZI |
| 231 | PETREF BAJRAM IDRIZI |
| 232 | KOZMA ANDREA VERUSHI |
| 233 | FLAMUR MUHARREM IBRUSHI |
| 234 | NEXHMEDIN KADRI TABAKU |
| 235 | SEIT ISMAIL XHAKERRI |
| 236 | PRENI JOSIF OGA |
| 237 | HAJRULLA HASAN MERXHANI |
| 238 | HALIT DEMIR CANI |
| 239 | DIENIS SHYQYRI MEMA |
| 240 | LUMTURIM HAXHI MUCA |
| 241 | FESTIM MISIR IDRIZI |
| 222 | PUCE PUCE HAZIZOLLI |
| 243 | KOSTANDIN ZAK SINANI |
| 244 | RYZHDI BAJRAM QOSJA |
| 245 | HYQMET TAFANI |
| 246 | ANJOL DERVISHI |
| 247 | PELLUMB ALLANI |
| 248 | BLERIM MUCA |
| 249 | ARJAN FILJA |
| 250 | KLAJDI HYSA |
| 251 | KUJTIM GJONI |
| 252 | FATOS DERVISHI |
| 253 | XHEMALI FILJA |
| 254 | EMINE CERRIKU |
| 255 | BEXHET ZDRAVA |
| 256 | DILAVER MANCO |
| 257 | JEMIN VELI |
| 258 | ILMI TABAKU |
| 259 | KRISTO TABAKU |
| 260 | BESIM DEBROVA |
| 261 | VIKTOR HALILI |
| 262 | ILMI CEREKJA |
| 263 | STAVRI RANXHA |
| 264 | FATMIR SKENDERI |
| 265 | BANUSH BALLA |
| 266 | LATIF LULI |
| 267 | KUJTIM TAFA LAVDIE TAFA |
| 268 | FANIJE KUQI |
| 269 | DHIMITER BICA |
| 270 | AGRON HAKA |
| 271 | HYSNI KYCYKU |
| 272 | SAMI DERVISHI |
| 273 | RUSHAN RAMA |
| 274 | MARK BERDUFI |
| 275 | GANI HAKA |
| 276 | FATMIR HAKA |
| 277 | FERDINANT KULLOLLI |
| 278 | SADIK SENJA |
| 279 | SHKRESA BASHKISE |
| 280 | ZYRA VRAPI |
| 281 | SELIM KARAJ |
| 282 | AGRON MIRAKA |
| 283 | GANI KURTI |
| 284 | MIRHAN BIBA |
| 285 | BEHAR LLESHI |
| 286 | FIZE CEKOJA |
| 287 | ARBEN LLUPA |
| 288 | VASIL TOLLUMI |
| 289 | KLEMEND NICA |
| 290 | XHEVAIR CELA |
| 291 | HEKURAN ALLA |
| 292 | AFERDITA GJOLENA |
| 293 | MEHMET CILI |
| 294 | AQIF TAFANI |
| 295 | AGIM ALLANI |
| 296 | ZINI TUSHA |
| 297 | KADRI TANUSHI |
| 298 | BEKTASH KOLA |
| 299 | SHEFIT GJOLENA |
| 300 | DULE KORRA |
| 301 | MUSTAFA NERGJONI |
| 302 | YMER CARKU |
| 303 | RAMAZAN SHALLA |
| 304 | GEZIM BRAHJA |
| 305 | GEZIM BRAHJA |
| 306 | ZIKE BANUSHI |
| 307 | RAMAZAN TORJA |
| 308 | ALBERT VLLAHI |
| 309 | JONUZ BUZANI |
| 310 | PETRIT KRECA |
| 311 | MUSTAFA METHASA |
| 312 | SHERIF RUCI |
| 313 | SHEFQET RAMA |
| 314 | NAZIF TOSKA |
| 315 | LUTFI AGOLLI |
| 316 | ABAZ PISHA |
| 317 | LEONARD XHERRI |
| 318 | ARDIAN LEKA |
| 319 | ZEQO QEFO LEGALIZIM S'KA NR TEL |
| 320 | MUSTAFA KACULI LEGALIZIM S' KA NR TEL |
| 321 | BEHAR VLLAHI |
| 322 | LULZIM RRESHKA |
| 323 | PETRIT PISHA |
| 324 | BUJAR RUCI |
| 325 | QEMAL BLLOSHMI |
| 326 | RIZA GORANI |
| 327 | DILAVER DISHANI |
| 328 | DERVISH HAZIZOLLI |
| 329 | SALI KOLECI |
| 330 | RAMAZAN QEFA |
| 331 | QAZIM BALLA |
| 332 | TEFIK SPAHIU |
| 333 | LAVDIMIR KURANI |
| 334 | SALI KOLECI |
| 335 | SHERIF TANUSHI |
| 336 | ALFRED BLLOSHMI |
| 337 | DHIMITRI SHALCAJ |
| 338 | HAJDAR MIMINI |
| 339 | SOTIR PRIFTI |
| 340 | AGIM BAKIU |
| 341 | NAZMI PRECI |
| 342 | NAZMI SIBJA |
| 343 | ZIKE BANUSHI |
| 344 | SKENDER HIDA |
| 345 | GEZIM BRAHJA |
| 346 | FAIK MYRTA |
| 347 | MARGARITA MYRTA |
| 348 | LULJETA MYRTA |
| 349 | KUJTIM HIDA |
| 350 | BEGIJE MUSTAFI |
| 351 | MARK BICA |
| 352 | NASHIFER TOSKA |
| 353 | ASTRIT XHELILI |
| 354 | ANILA KAMAMI |
| 355 | ETLEVA KAMAMI |
| 356 | RUZHDI KAMAMI |
| 357 | EDLIRA LICI |
| 369 | ARTAN KAMAMI |
| 370 | SHPETIM MATRAXHIU |
| 371 | BEQIR DYBELI |
| 372 | HAXHI CELA |
| 373 | MEHMET KALEMI |
| 374 | NDRICIM NANUSHI |
| 375 | HAZBI HAKA |
| 376 | NDRICIM CEKREZI |
| 377 | SHEFKI MUCA |
| 378 | PRANVERA ESHJA |
| 379 | BEJAZE LUTA |
| 380 | PREN DEMIRI |
| 381 | QERIM XHIKA |
| 382 | FAIK KYCYKU |
| 383 | FATMIR LLAPUSHI |
| 384 | MARK BERDUFI |
| 385 | KOSTANDIN QOSJA |
| 386 | HAZIS REKA |
| 387 | XHEVIT GJYLA |
| 388 | FATMIR XHIKA |
| 389 | ARBEN XHYRA |
| 390 | KADRIJE PLAKA |
| 391 | KIMET KUKUVI |
| 392 | RIZA BRUSHLI |
| 393 | ZELIKO BROSHKA |
| 394 | ISMAIL DUZHA |
| 395 | SHEFQET KRYEMADHI |
| 396 | PANAJOT BARDHI |
| 397 | THEODHOR FARA |
| 398 | SHAHIN KOVACI |
| 399 | ENGJELLUSHE AVDYLI |
| 400 | AGIM BROSHKA |
| 401 | LLAZAR KOKONESHI |
| 402 | TOMORR RUSTA |
| 403 | RRAHMAN BEZATI |
| 404 | LULZIM IDRIZI |
| 405 | NAIM IDRIZI |
| 406 | ISMAIL IDRIZI |
| 407 | HAMIDE IDRIZI |
| 408 | DHURATA TAFANI |
| 409 | FATBARDHA GJINI |
| 410 | PELLUMB IDRIZI |
| 411 | SHPETIME KUQJA |
| 412 | BAJRAM TOSKA |

# DROGA NË ITALI
## ARRESTIMET

Operacioni "Shefi", mediat e huaja: Nën hetim prej 2 vitesh, trafikonin kanabis, heroinë dhe kokainë

# Trafikuan 2.3 tonë drogë me skafe nga Shqipëria në Itali, bien në pranga 43 persona

## *Shkatërrohen 2 grupe kriminale, mes të arrestuarve 21 shqiptarë*

Ina Allkanjari

Dy grupe kriminale të trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike, janë shkatërruar mëngjesin e djeshëm, në një operacion të përbashkët mes policisë italiane dhe asaj shqiptare. Në kuadër të këtij operacioni antidrogë të koduar "Shefi" kanë rënë në pranga 43 persona, mes të cilëve 21 shtetas shqiptarë. Bëhet me dije se katër prej tyre janë prangosur në Shqipëri për llogari të policisë italiane, ndërkohë dy shqiptarë të tjerë janë shpallur në kërkim. Ndërsa të prangosurit e tjerë, anëtarë të grupeve të trafikut të drogës janë italianë dhe rumunë. Mësohet se urdhër arrestet ndaj këtyre personave të cilët akuzohen për trafik kanabis, heroine dhe kokaine, janë ekzekutuar nga rreth 200 forca policie. Sipas mediave italiane, droga trafikohej me skafe nga Shqipëria drejt rajonit të Puglia-s. 'La Repubblica' shkruan se hetimet për këto dy grupe të strukturuar kriminale kanë nisur në vitin 2016, nga antimafia italiane e qytetit të Barit. Në kuadër të operacionit 'Shefi' hetimet e të cilës u shtrin në një periudhë 2-vjeccari janë sekuestruar rreth 2300 kg lëndë narkotike të llojit kanabis, heroinë dhe kokainë, me vlerë tregu 15 mln euro.

**OPERACIONI 'SHEFI'**

Departamenti i Antimafies italiane, DIA, shkatërroi një rrjet italo-shqiptar të trafikut të drogës nga Shqipëria me skafe drejt Italisë, në bregdetin e Barit. Në prangat e policisë kanë rënë 45 persona, konkretisht 20 italianë, 21 shqiptarë dhe 2 rumunë. Mësohet se katër nga anëtarët e dy organizatave kriminale janë arrestuar në territorin shqiptar, ndërsa pjesa tjetër në Itali, në qytetet e Barit, Brindisit, Bolonjës dhe rrethinat e tyre. Shqiptarët e arrestuar në këtë operacion antidrogë janë: Dritan Naci, 32 vjeç; Mariglen Shusha, 32 vjeç; Marlin Aliaj, 33 vjeç; Andi Peshku, 25 vjeç; Vullnet Daci, 31 vjeç; Gëzim Bircaj , 54 vjeç; Malton Lleshi, 35 vjeç; Fiqiret Seferi, 54 vjeç; Ernest Peza, 27 vjeç; Lenoidha Sejdiaj, 52 vjeç; Elton Ismaili, 39 vjeç; Samuel Muça, 31 vjeç; Ferhat Ajdini, 45 vjeç; Vullnet Cila, 39 vjeç; Shpëtim Shehi, 39 vjeç; Donial Drolli, 29 vjeç; Ibrahim Xhihani, 26 vjeç; Ergent Seferi, 28 vjeç; Arian Kertusha, 48 vjeç; Senat Hallunaj, 23 vjeç; Hamid Seferi, 24 vjeç. Operacioni i koduar 'Shefi', i ka nisur hetimet nga viti 2016. Dy grupet kriminale të akuzohen se trafikonin drejt Italisë droga të forta, si: kokainë dhe heroinë. Hetimet intensive kanë zbuluar se shqiptarët e arrestuar janë organizatorë, korrierë dhe magazinierë të kanabisit dhe kokainës. Ndërsa shqiptarët e arrestuar në Tiranë siguronin kanabisin dhe më pas e nisnin në Itali ku merreshin të tjerë shqiptarë dhe të huaj për ta hedhur në tregun europian. Nga hetimet rezulton se këtyre grupeve në kohë dhe vende të ndryshme u janë sekuestruar mbi 2.3 tonë lëndë narkotike, kanabis, heroinë dhe kokainë me një vlerë që shkon deri në 15 milionë euro. Autoritetet italiane kanë bërë të ditur se në këtë aksion janë angazhuar mbi 200 punonjës të departamentit të Antimafias, DIA, Guardia di Finanza, karabinierisë si dhe policisë shqiptare. Por Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Tiranë, tregohet mjaft e rezervuar për këtë operacion.



Droga e sekuestruar

**SHQIPTARET E ARRESTUAR:**

1. Dritan Naci, 32 vjeç
2. Mariglen Shusha, 32 vjeç
3. Marlin Aliaj, 33 vjeç
4. Andi Peshku, 25 vjeç
5. Vullnet Daci, 31 vjeç
6. Gëzim Bircaj , 54 vjeç
7. Malton Lleshi, 35 vjeç
8. Fiqiret Seferi, 54 vjeç
9. Ernest Peza, 27 vjeç
10. Lenoidha Sejdiaj, 52 vjeç
11. Elton Ismaili, 39 vjeç
12. Samuel Muça, 31 vjeç
13. Ferhat Ajdini, 45 vjeç
14. Vullnet Cila, 39 vjeç
15. Shpëtim Shehi, 39 vjeç
16. Donial Drolli, 29 vjeç
17. Ibrahim Xhihani, 26 vjeç
18. Ergent Seferi, 28 vjeç
19. Arian Kertusha, 48 vjeç
20. Senat Hallunaj, 23 vjeç
21. Hamid Seferi, 24 vjeç

**2.3 TONË**

Operacioni i koduar 'Shefi', i ka nisur hetimet nga viti 2016. Nga hetimet rezulton se këtyre grupeve kriminale në kohë dhe vende të ndryshme u janë sekuestruar mbi 2.3 tonë lëndë narkotike, kanabis, heroinë dhe kokainë me një vlerë që shkon deri në 15 milionë euro. Autoritetet italiane kanë bërë të ditur se në këtë aksion janë angazhuar mbi 200 punonjës të departamentit të Antimafias, DIA, Guardia di Finanza, karabinierisë si dhe policisë shqiptare.

**Të rinjtë shpërndanin kokainë e bastisnin karburante e banesa**

## Shkatërrohet banda e "skifterëve" në Milano, bien në pranga 7 shqiptarë

**ITALI** - Një bandë shqiptare është shkatërruar nga policia italiane pasi akuzohen për bashkëpunim në vjedhje me dhunë dhe shpërndarje droge. Karabinierët e Cassano d'Adda,Milano, kanë arrestuar shtatë persona të gjithë shqiptarë mes moshës 20 dhe 26 vjeç. Të rinjtë grabisnin karburante e banesa. Gjithashtu, dyshohet se shpërndanin lëndë narkotike të llojit kokainë. Mediat italiane kanë siguruar dhe publikuar një nga grabitjet e radhës, falë kamerave të sigurisë së një pike karburanti. Sipas mediave italiane dy shqiptarë shfaqen me leva në duar, në përpjekje për të realizuar grabitjen. Policia ka bërë me dije se hetimet për grupin e shqiptarëve kanë nisur që në janarin e vitit të kaluar. Banda vepronte ne provincën e Milanos dhe, gjithashtu, ishte aktive në krahinat e Brescias, Monzas, Brianzas e Bergamos, Lodi dhe Varese. Të rinjtë akuzohen për së paku 15 vjedhje në pikat e karburantit dhe dy grabitje banesash. Sakaq identiteti i të arrestuar ende nuk është bërë i ditur.



**SEKUESTRIMI**



### I kapin 686 kg kanabis në banesë, shpallet në kërkim 45-vjeçari

**KORCE** - Policia e Korçës ka sekuestruar ditën e djeshme një sasi të madhe droge në fshatin Bulgarec. Uniformat blu bëjnë me dije se pas një denoncimi të bërë në portalin komisariati dixhital, është bërë kontrolli në banesën e K.G. në periferi të fshatit. Gjatë kontrollit në banesë u gjetën dhe u sekuestruan 686 lëndë narkotike e llojit kanabis. Policia nuk ka mundur të arrestojë 45-vjeçarin K.G., pasi dyshohet se është sinjalizuar nga banorët e fshatit dhe është larguar në drejtim të paditur. Blutë e Korçës kanë shpallur në kërkim 45-vjeçarin dhe janë duke kryer hetimet në lidhje me këtë rast.

### Oltian Lami: Marjana mendonte që mamaja ime ishte magjistare, thoshte shpesh 'do ta vras'

# Helmoi vjehrrën me fostoksinë, flet xhaxhai i nuses: Gjithë historia është sajesë

## "Mbesa ime është e pafajshme, duan të hedhin baltë mbi të"

Ina Allkanjari


Xhaxhai i 21-vjeçares


Viktima, Lirie Laml


Nusja, Marjana Çmeta

Liria ka tentuar edhe një herë të vetëhelmohet vite më parë, mbesa ime është e pafajshme". Kështu është shprehur ditën e djeshme xhaxhai i Marjana Çmetës, vajzës, e cila është arrestuar pasi akuzohet se helmoi me fostoksinë vjehrrën. Ai ka hedhur poshtë akuzat që rendojnë mbi mbesën e tij, duke theksuar se familja Lami ka dashur të hedhë baltë mbi 21-vjeçaren. "Familja Lami ka dashur të hedhë baltë mbi vajzën tonë. Fillimisht i vunë për dashnor të gjithë meshkujt e fisit e më pas, pasi nuk doli kjo, shpikën këtë histori. Liria ka tentuar edhe një herë të vetëhelmohet vite më parë. Marjana ka shkuar te hoxha me vjehrrin dhe të vëllain. Ka thënë vetëm kaq: Vjehrrës Zoti ja faltë mëkatet. Jo gjë tjetër. Marjana është një vajzë besimtare ka mbaruar Medresenë dhe preket shpejt nuk mund ta ketë bërë këtë veprim" ka thënë xhaxhai i 21-vjeçares, Selim Çmeta . Më tej ai shton se Olti Lami dhe mbesa e tij ishin ndarë pak pas vdekjes së vjehrrës Lirie dhe Marjana jetonte te familja e saj. Pas vdekjes së Liries, që sipas hetimeve është helmuar me fostoksinë në lëng portokalli nga nusja, kjo e fundit në ditën e pestë kur në shtëpinë e të shoqit vajtohej vjehrra, u kthye tek prindërit. 21-vjaçaria në kohën kur është kryer krimi, ka qenë shtatzënë më Oltianin. Ajo ka një vajzë 5 muajsh me ish-bashkëshortin. Oltiani, djali i të ndjerës nuk e ka takuar ende vajzën që lindi nga martesa. Pasi varrosi të ëmën u vu në kërkim të së vërtetës. "Në fillim është sjellë shumë mirë. Dukeshin sikur duheshin shumë dhe dukej që e kishin sinqerisht. Më pas ndodhi Mariana nuk e donte më. Edhe kur iku mamaja në fshat nuk e merrte më në telefon. I thosha unë që pse nuk e merr në telefon dhe nuk më kthente përgjigje. Kjo (Mariana) dyshonte se mos mami im i bën keq asaj. Ka pas thënë shumë herë që 'magjistarja duhet dënuar'. Mendonte që mamaja ime ishte magjistare dhe e thoshte shpesh që "do ta vras magjistaren", tregon Oltiani.

### Rrëfimi i nuses që helmoi vjehrrën: I hodha helm në lëngun e portokallit dhe e mbyta me duart e mia

Krimi tronditës i ndodhur në prill të vitit 2017, ku humbi jetën 47-vjeçarja, Lirie Lami, u zbulua pas një hetimi 10 mujor të prokurorisë për Krime të Rënda. 21-vjeçarja Marjana Çmeta përfundoi në pranga dy ditë më parë, pasi dyshohet se vrau vjehrrën Lirie Lami paraditen e 30 prillit në shtëpinë e saj, në zonën e ish-frutikulturës në Kamëz. Dy muaj pas krimit makabër, e reja, e cila ishte shtatzënë, vendos të shkojë tek hoxha i zonës Hysen Shehu dhe të rrëfehet. Herën e parë ajo dështon të tregojë historinë, por një javë më vonë, Hoxha e thërret për ta dëgjuar dhe vendos të regjistrojë me kamera. "Mendoja se vjehrra donte të më ndante me Oltionin. Debatet mes nesh ishin të forta, derisa ajo bashkë me vjehrrin ikën nga shtëpia dhe u vendosën në shtëpinë e vjetër. Atë ditë e takova Lirien, pasi kishte shpërndarë qumështin dhe po blinte disa fidanë për t'i mbjellë. E ftova në shtëpi, pasi nuk hynte asnjëherë brenda. I thashë "dua pajtim" të kalojmë mirë. Sa hyri i nxora një gotë lëng ku kisha hedhur fostoksinën. Pak minuta më vonë filloi të bërtiste me të madhe. Kisha frikë se mos zbulohej. Hyra në dhomë dhe e gjeta duke tentuar të hapë dritaren. Perdja ra përdhe. Ajo s'po jepte shpirt, mora një shall dhe tentova ta mbysja me të. Pastaj e shtrëngova me duar derisa ndërroi jetë", ka rrëfyer Marjana. Më tej nusja i ka kërkuar hoxhës ta ndihmojë të gjejë qetësi shpirtërore. "Që kur e vrava nuk gjej me qetësi. Më kanë pushtuar xhindet. Më ndihmo të dal nga kjo gjendje, të më falen mëkatet mua dhe asaj",-është shprehur e reja.

**DJALI VIKTIMËS**

Në fillim është sjellë shumë mirë. Dukeshin sikur duheshin shumë dhe dukej që e kishin sinqerisht. Kur iku mamaja në fshat nuk e merrte më në telefon. I thosha unë që pse nuk e merr në telefon dhe nuk më kthente përgjigje. Kjo (Mariana) dyshonte se mos mami im i bën keq asaj. Ka pas thënë shumë herë që 'magjistarja duhet dënuar'. Mendonte që mamaja ime ishte magjistare dhe e thoshte shpesh që "do ta vras magjistaren",- tregon Oltiani Lami, ish-bashkëshorti i 21-vjeçares.

**HETIMI**

Ka qenë dëshmia e Olti Lamit, djalit të viktimës, para prokurorëve, ajo çka ndihmoi hetimet për zbardhjen e krimit. Olti ka rrëfyer se kishte marrë vesh ekzistencën e një videoje, të filmuar nga hoxha Hysen Shehu. Pas dëshmisë së dhënë, u bë i mundur përgjimi i telefonatave të djalit të Lirijes me hoxhën. Pas përgjimit të bisedave telefonike, u sigurua një vendim gjykate dhe oficerët bënë të mundur sekuestrimin e videos në zyrën e Hysen Shehut, e cila është një ndër provat që rëndon mbi 21-vjeçaren Marjana Çmeta, të dyshuar si autore të vrasjes së vjehrrës Lirije Lami. Mësohet se pas sigurimit të provave, prokurori Besnik Muçi, kërkoi nga gjykata të miratohen urdhër-arrestet për 21-vjeçaren Marjana Çmeta, e cila akuzohet për veprën penale "vrasje për shkak të rrethanave familjare". Hoxha Hysen Shehu ka lajmëruar për ngjarjen e ndodhur bashkëshortin e viktimës Agim Lamin. Gjithashtu, në dijeni ka qenë dhe kushëriri i Lamit, Arben Saliu. Nën akuzë për "moskallëzim krimi", janë vënë në pranga edhe vjehrri i 21-vjeçares, kushëriri dhe hoxha.

### Policia: Goditi të riun me qytën e automatikut

## Të shtëna me armë zjarri në Mirditë, arrestohet 29-vjeçari



Gjatë ditës së djeshme policia e Mirditës ka ndërhyrë duke parandaluar përshkallëzimin e një konflikti me armë zjarri mes dy personave në Rrëshen. Policia bën të ditur se arrestimi është realizuar në kohë rekord. Konkretisht ka rënë në pranga autori i ngjarjes Gjovalin Ndoji, 29 vjeç, banues në Simon, Kaçinar - Mirditë. Shtetasi Gj.Ndoji për motive banale është konfliktuar me shtetasin A.Ç, 38 vjeç, gjithashtu banues në Simon, Kaçinar-Mirditë duke e goditur me qytën e automatikut në kokë dhe më pas dyshohet se ka qëlluar me armë në ajër për ta kërcënuar. Shtetasi A.Ç ka pësuar dëmtime të lehta i cili po merr ndihmën e specializuar në Spitalin Rajonal të Rrëshenit pa probleme për jetën. Grupi hetimor në vendngjarje ka gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale, 2 gëzhoja. Ndërkohë grupi hetimor vijon hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes. Materialet procedurale në ngarkim të këtij shtetasi, do t'i referohen Prokurorisë, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, për veprat penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit", "Plagosje e lehtë me dashje" dhe "Kanosja".

### Ergys Metanit i sekuestrohet lëndë narkotike në banesë

## Plagosi me thikë të riun, bie në pranga 25 vjeçari

Policia e Tiranës ka arrestuar një 25 vjeçar gjatë ditës së djeshme, pasi plagosi një dite më parë me thikë një person për motive të dobëta. Ne pranga të policisë ka rënë shtetasi Ergys Metani ,25 vjeç, banues në Tiranë. "Nga specialistët e Seksionit të Krimeve Kundër Jetës, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë nr 4 Tiranë, është bërë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit: Ergys Metani, 25 vjeç, banues në Tiranë", thuhet në njoftimin e policisë. Gjithashtu shtetasit Ergys Metani, gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij iu gjetën një "thikë" si dhe një sasi lëndë narkotike e dyshuar "Cannabis Sattiva" të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprat penale të parashikuara nga nenet 76-22, 279 e 283 të Kodit Penal"- bën me dije policia. Arrestimi i shtetasit të mësipërm u bë pasi, më datë 13.03.2018, në vendin e quajtur rruga "Niko Avrami" pranë një kompleksi, gjatë një konflikti për motive të dobëta me shtetasin E.Z, 21 vjeç, banues në Tiranë, e ka goditur me mjet prerës "thikë". 21 vjeçari i plagosur ndodhet në spital nën kujdesin e mjekëve.



**VENDIMI/ Kategoritë që nuk i nënshtrohen procedurës së vlerësimit**

# Ja ndryshimet në kritere dhe dokumentacion për të marrë pension invaliditeti

Të gjithë personat me aftësi të kufizuar, tashmë mund të njihen me ndryshimet në kritere, dokumentacion e procedura për të përfituar masën e pagesës. Këshilli i Ministrave vendosi mes të tjerash që pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar të indeksohet sa herë indeksohet pensioni social. "Shërbimi i ndihmësit personal ofrohet nga individë, të cilët kanë vendbanimin në Shqipëri, brenda së njëjtës bashki me personin me aftësi të kufizuara, kanë aftësi mendore dhe fizike për të ofruar këto shërbime dhe nuk janë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë."-theksohet në vendim. Sipas këtij të fundit, nuk do i nënshtrohen procedurës së vlerësimit përfituesit ekzistues, të cilët janë të verbër, invalidë pune, si edhe të verbrit të cilëve u ka lindur e drejta për t'u trajtuar me pension pleqërie/social. Gjithashtu, edhe aplikuesit për herë të parë të moshës 0 deri në 2 vjeç; aplikuesit për herë të parë që kërkojnë të vlerësohen sipas vendimit nr.277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave; si dhe përfituesit ekzistues sipas pikave 1 e 2, të vendimit nr.618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave të cilëve u ka lindur e drejta për t'u trajtuar me pension pleqërie/social, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"; nuk do i nënshtrohen procedurës së vlerësimit. "Nuk i nënshtrohen procedurës së vlerësimit në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi edhe përfituesit ekzistues sipas pikës 1, të vendimit nr.31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik e tetraplegjik", të ndryshuar.".",-nënvizohet në vendim.

**KESHILLI I MINISTRAVE**
"Shërbimi i ndihmësit personal ofrohet nga individë, të cilët kanë vendbanimin në Shqipëri, brenda së njëjtës bashki me personin me aftësi të kufizuara, kanë aftësi mendore dhe fizike për të ofruar këto shërbime dhe nuk janë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë."


Foto ilustruese

Shefja e INAS CSL: Kriza ekonomike dhe kosto, shkaqet primare të shtyrjes së firmosjes


Voltiza Duro

# Pensionet e emigrantëve, pasojat e mungesës së marrëveshjes bilaterale me Italinë e Greqinë

## *Aliaj: Nuk munden të bashkohen periudhat e kontributeve*

Italia dhe Greqia janë dy vendet me numrin më të lartë të emigrantëve shqiptarë, të cilët kanë punuar e vazhdojnë të punojnë në këto shtete fqinje. Por, mungesa e një marrëveshjeje bilaterale Shqipëri- Greqi apo Shqipëri- Itali, sjell pamundësinë për të bashkuar periudhat kontributive, pra mosnjohje reciproke e viteve të punës me sigurime në Shqipëri dhe në Itali apo Greqi. Dy ditë më parë, ministri i Punëve të Jashtme, Ditmir Bushati deklaroi se kjo çështje shumë shpejt do të marrë një zgjidhje, pasi të tre shtetet janë duke punuar për arritjen e një marrëveshjeje. Ndërkaq, e pyetur nga "Gazeta Shqiptare", Beskida Aliaj, specialiste në fushën e pensioneve, njëkohësisht përfaqësuese e Patronatit INAS CSL në Shqipëri, tregon shkaqet e mungesës së kësaj marrëveshjeje bilaterale. "Së pari, nuk ka një reciprocitet, ndërkohë që emigracioni shqiptar në Itali është në numër shumë të madh, punonjësit italianë që janë këtu në Shqipëri dhe që trajtohen sipas ligjit shqiptar janë në numër shumë të vogël. Së dyti, Italia dhe Greqia po kalojnë periudha të vështira ekonomike, ne ndjekim hap pas hapi zhvillimet ekonomike në Itali dhe rezulton se kohët e fundit ekonomia italiane ka qenë në recension dhe vazhdon të jetë e tillë. Po në këto kushte është edhe Greqia. Mund të themi që si rezultat i krizës ekonomike është rritur shumë edhe papunësia, që influencon direkt te emigrantët tanë",-thekson Aliaj për "GSH". Më tej kjo e fundit bën me dije se kriza ekonomike, dhe kosto që kanë këto vende për të përballuar pensionet e emigrantëve duket se janë ndër shkaqet primare që e kanë shtyrë firmosjen e këtyre marrëveshjeve. Kështu, shqiptarët që kanë punuar në Itali, të cilët nuk kanë 20 vite kontribute nuk përfitojnë pension pa u riatdhesuar në Shqipëri. Në rastin kur një emigrant shqiptar që ka punuar në Itali 19 vjet dhe në Shqipëri 14 vjet; nuk përfiton pension nga Italia se nuk ka plotësuar 20 vjet për t'u futur në kushte pensioni; e po ashtu edhe në Shqipëri nuk përfiton, sepse ka 14 vjet dhe nuk ka plotësuar 15 vite për të marrë të paktën pension të pjesshëm. Pra 33 vite pune me kontribute të emigrantit shqiptar, nuk reflektohen në të ardhurat që mund të ketë. Kështu që në rast të bashkimit të periudhave kontributive; në rast të një marrëveshje bilaterale krijohet tërësisht mundësia për të marrë përfitime nga të dy shtetet. Ekspertja e pensioneve Aliaj, shton se nëse kjo marrëveshje do të arrihej do të kishte përfitime të shumta për emigrantët që kanë derdhur mundin e tyre duke punuar në shtetet fqinje. "Qeveria shqiptare ka mbyllur një sërë marrëveshjesh të tilla me vende si Belgjika, Turqia, Rumania apo Luksemburgu ndërsa është në negociata edhe me Italinë dhe Greqinë, finalizimi i të cilave do të ishte zgjidhja e "jetës" për shumë familje shqiptare, të cilat do mund të merrnin pension për vitet që kanë punuar si në Shqipëri dhe në Greqi apo Itali, pa qenë e nevojshme që të riatdhesohen",-nënvizon Aliaj. Gjithashtu, ajo tregon se deri më tani plot 11 shtete e kanë firmosur këtë marrëveshje me Shqipërinë si Belgjika, Luksemburgu, Turqia, Gjermania, Çekia, Rumania, Hungaria, Austria, Kanadaja, Hungaria dhe Maqedonia. Më tej ekspertja e pensioneve shpjegon konkretisht sesi mund të përfitohet pensioni në rastin e nënshkrimit të marrëveshjes bilaterale.

"Një person që ka punuar 10 vite në Shqipëri; që nuk përfiton aktualisht nga ligji shqiptar; dhe 10 vite në Itali që aktualisht nuk përfiton nga ligji italian, po t'i bashkohen këto vite, atëherë ky plotëson vjetërsinë kontributive; pra 10 vite në Itali, plotëson edhe 10 vite në Shqipëri dhe i bashkohen këto dy periudha. Këtë ka qëllim dhe marrëveshja bilaterale, për njohjen dhe bashkimin e dy periudhave kontributive, dhe pastaj në marrëveshje çdo shtet; secili shtet do të japë kontributin e vet. Nuk diskutohet! Pra, Shqipëria do të japë kontributin për 10 vitet që qytetari ka punuar në Shqipëri, dhe Italia do japë kontributin e saj, gjithashtu, për të njëjtin individ që ka punuar edhe në këtë shtet",-thekson Aliaj.


Beskida Aliaj, specialiste në fushën e pensioneve



**FAKTORËT NDIKUES**
"Italia dhe Greqia po kalojnë periudha të vështira ekonomike, ne ndjekim hap pas hapi zhvillimet ekonomike në Itali dhe rezulton se kohët e fundit ekonomia italiane ka qenë në recension dhe vazhdon të jetë e tillë. Po në këto kushte është edhe Greqia. Mund të themi që si rezultat i krizës ekonomike është rritur shumë edhe papunësia, që influencon direkt te emigrantët tanë",-thekson ekspertja. Në qoftë se bashkohen vitet e punës, një person del në pension pa qenë nevoja të mbushe moshën për pension, por mjaft te ketë 42 vite pune

**MOSNJOHJA E KONTRIBUTEVE**
"Në rastin kur një emigrant shqiptar ka punuar në Itali 19 vjet dhe në Shqipëri 14 vjet; nuk përfiton pension nga Italia se nuk ka plotësuar 20 vjet për t'u futur në kushte pensioni; e po ashtu edhe në Shqipëri nuk përfiton, sepse ka 14 vjet dhe nuk ka plotësuar 15 vite për marrë të paktën pension të pjesshëm",-thekson Aliaj.

MJEKU POPULLOR

Mjeku popullor: Si të dalloni nga cila formë e dhimbjes jeni prekur, sipmtomat kryesore

# Ylli Merja: Si të kuroni dhimbjet e kokës me bimë mjekësore

## "Konsumoni shafranin e frutat me ngjyrë të zezë"

Voltiza Duro

Dhimbja e kokës shkaktohet nga faktorë të ndryshëm. Në rastet kur kjo dhimbje lind në pjesën e pasme të kokës, shkaku i saj mund të jetë cervikalja, pra vertebrat mund të shtypin çiftet e nervave; një majtas e një djathtas ose shtypin arteriet që ushqejnë sistemin nervor me gjak që vështirësojnë qarkullimin e gjakut. Por dhimbje të kokës shkakton edhe përdorimi i pijeve alkoolike ose i verës së porsa hapur pa pritur që kjo e fundit të çlirojë gazin sulfuror. Një tjetër faktor që ndikon në shfaqjen e dhimbjeve në kokë është edhe qëndrimi pranë ekranit të televizorit dhe sidomos në rastet kur ky është mbi 37 polsh. Gjithashtu, personat që lexojnë shtrirë, dhe nuk kanë ndriçimin e duhur gjatë këtij procesi, mund të jenë të predispozuar për t'u prekur nga dhimbjet në pjesën e kokës.

**LLOJET E DHIMBJEVE**

Dhimbjet e kokës i klasifikojmë në grupime të ndryshme, në varësi të zonës që prekin. Kështu në kategorinë e parë bëjnë pjesë dhimbjet primare, të cilat janë tepër të forta, ndahen në intervale e zgjasin nga një deri në disa orë, por mund të ndodhë që të prekin të sëmurin gjatë gjithë ditës. Një prej dhimbjeve primare është e ashtuquajtura dhimbje tensioni që jep ndjesi pulsuese në kokë, ngushtim në qafë, e muskuj, e cila shkaktohet më shumë nga ngushtimi i arterieve në sistemin e qarkullimit të gjakut, stresi, lodhja e tepërt etj. Çdokush mund të preket nga kjo lloj sëmundjeje. Një tjetër formë e dhimbjes primare është ajo që përhapet vetëm në një zonë të kokës, pra vetëm në një anë të saj, vetëm në ballë, apo vetëm rrotull njërit sy. Kjo dhimbje shkakton djegie, por mund të shfaqen edhe sekrecione të hundës, lotim të syve etj. Shkaktari i kësaj lloj sëmundjeje mund të jetë sinoziti. Njerëzit mund të preken edhe nga dhimbjet e shkaktuara nga migrena, qoftë kjo dhimbje nga migrena orar apo ajo klasike, që shkaktojnë dhimbje të kokës me pulsime në brendësi dhe pastaj vazhdon e rritet. Disa nga simptomat që shfaqen kur i sëmuri preket nga kjo dhimbje janë: marrje mendsh, të vjella, apo ndjeshmëri ndaj dritës. Kjo ndodh më shumë te femrat, sidomos para ciklit menstrual, por mund të jetë edhe e trashëguar. Këto ishin disa nga sëmundjet e llojit primar. Ndërkohë në grupin tjetër bëjnë pjesë dhimbjet sekondare e këtu përfshihen alergjia, dhe sinusi që shkaktojnë dhimbje koke në pjesën e përparme të kokës. Dhimbjet shtohen në periudhën e pranverës kur polenet në ajër dhe grimcat përhapen në maksimum. Ndërkaq, edhe ndryshimet e nivelit të hormoneve mund të shkaktojnë dhimbje koke. Disa prej faktorëve janë cikli menstrual; tabletat për ndalim shtatzënie gjatë të cilit rritet estrogjeni dhe jep dhimbje koke; përdorimi i tepërt i kafes pasi dehidraton qelizat e trupit dhe shkakton ngjeshjen e neuroneve pa lëngje midis tyre. Por edhe aktiviteti intensiv fizik mund të shkaktojë dhimbje koke pasi shpesh ndodh edhe rritja e presionit të gjakut çka sjell dhimbje sumbuese të saj. Por kjo lloj dhimbjeje nuk zgjat shumë e largohet pak kohë pas qëndrimit në qetësi të trupit. Sipas studimeve edhe tensioni i lartë shkakton dhimbje koke, e cila përhapet në të dyja anët e kokës dhe është pulsuese, madje sjell ndryshim të shikimit, ngushtim të frymëmarrjes, e dhimbje në kraharor. Në këto raste, i sëmuri duhet të marrë ilaçe për uljen e tensionit menjëherë. Një formë tjetër e dhimbjeve të kokës janë edhe ato post traumatike që vijnë pas aksidenteve ose dëmtimeve në tru, dhimbje, të cilat largohen pas 2-3 ditësh.



Mjeku popullor YLLI Merja

**TRAJTIMI ME BIMË MJEKËSORE**

Për të parandaluar dhimbjet e kokës duhet të konsumoni shumë ujë gjatë ditës. Në momentin e parë që ndjeni dhimbje pini 2 gota ujë njëra pas tjetrës. Tregoni një kujdes të veçantë për dietën e ushqehuni mirë në të tria vaktet, qoftë edhe nga pak e mundohuni që ushqimi të konsumohet në të njëjtin orar. Më tej kontrolloni herë pas here tensionin e ulët ose të lartë si dhe konsumoni antioksidantë. Ndër antioksidantët më të fuqishëm janë ato produkte që rriten në natyrë, veçanërisht frutat që kanë ngjyrë të zezë. Këshillojmë që të konsumoni një lugë gjelle në ditë me boronice pasi kjo pastron gjakun, e hollon atë dhe ushqen sistemin nervor. Rekomandohet edhe marrja e 1-2 lugë gjelle me manaferra pasi ushqen sistemin nervor, ashtu si dhe rrushi i zi apo çokollata e zezë. Po kështu trurin e ushqejnë të gjitha ato fruta, të cilat përmbajnë magnez e vitamina B1, B2, B3, B6 siç janë arra, bajamja, lajthia, farat e kungullit etj. Konsumimi gjatë ditës i 10 fijeve shafrani, bën që jo vetëm të qetësohen dhimbjet e kokës, por të frenohet edhe plakja e parakohshme. Përveç kësaj, lëndët aktive të shafranit si pikokrocina dhe krocinina shmangin fryrjet apo ënjtjet e zgjatimeve nervore. Iu rekomandojmë që të konsumoni çajra që forcojnë enët e qarkullimit të gjakut në kokë dhe që kanë efekt hidratues. Sistemi nervor ka rreth 100 bilion qeliza dhe këto qeliza kanë zgjatimet e tyre që shkojnë deri në ekstremitete dhe njëkohësisht kanë pikat e takimit me njeri-tjetrin. Pikërisht këto çajra bëjnë që zgjatimet e neuroneve (aksonet) të mos mbingarkohen. Në këtë grup çajrash futen bimët si bari i bletës mendra e butë, livandoja, borziloku, rozmarina etj. Ndërsa në rastet kur kemi të bëjmë me dhimbje nga sinoziti, bëjmë mirë që ti qetësojmë këto duke përdorur një çaj për sionozitin nga gjethet e ekualipsit të mentes apo rigonit. Nëse ju gjeni me të vërtetë shkakun nga lind dhimbja e kokës, e keni shumë herë më të lehtë për të shmangur dhimbjet e saj. Po kështu nëse dhimbja është nga pjesa cervikale mjafton të shkriférohen muskujt në pjesën e pasme të saj duke i lyer me disa vajra bimore siç mund të jetë livandoja, dafina, apo helikrisium.









### Kryetari i Partisë Progresive Serbe: Duhen plotësuar disa kushte

# Deputeti i Listës Serbe: S'kemi ndryshuar qëndrim, nuk e votojmë demarkacionin

Lista Serbe edhe njëherë ka konfirmuar se deputetët e saj nuk do ta votojnë projektligjin për demarkacionin me Malin e Zi dhe se kjo parti nuk e ka ndryshuar qëndrimin për këtë çështje. Deputeti i Listës Serbe, Igor Simiç, i ngarkuar për komunikim me mediat në emër të këtij subjekti politik, i ka thënë agjencisë "SRNA" se Lista Serbe e ka bërë publik qëndrimin e saj javën e kaluar lidhur me demarkacionin me Malin e Zi dhe se ky qëndrim nuk ka ndryshuar. Ditë më parë Lista Serbe përmes një kumtese kishte thënë se do të vazhdojë të luftojë për interesat e popullit serb në Kosovë e jo për interesa të disa qendrave vendore dhe të huaja të pushtetit, transmeton "Telegrafi". Simiç ka përsëritur se, "Lista Serbe nuk do ta votojë demarkacionin me Malin e Zi, pavarësisht deklaratave të rreme dhe tendencioze në mediat në gjuhën shqipe, e të cilat janë cituar edhe nga mediat serbe". Deklarata e Simiçit vjen pas raportimeve në media se Lista Serbe do ta votojë Marrëveshjen për Demarkacionin, por që për këtë ky subjekt ka parashtruar disa kushte. Kryetari i Partisë Progresive Serbe, Nenad Rashiç, ka thënë se deputetët e Listës Serbe në Kuvendin e Kosovës kanë disa kushte për të votuar pro ratifikimit të demarkacionit mes Kosovës dhe Malit të Zi. Sipas tij, këto do të jenë kushte financiare dhe personale. Gjatë ditës së djeshme, Lidhja Demokratike e Kosovës ka kërkuar transparencë për bisedimet që po bëhen ndërmjet qeverisë dhe Listës Serbe, për sigurimin e votave të mjaftueshme për ratifikimin e Demarkacionit në Kuvend. Ndërsa deputeti i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka thënë se Lista Serbe po e kushtëzon qeverinë "Haradinaj" në këmbim të votës për demarkacionin. Për miratimin e Ligjit për Demarkacionin e vijës kufitare me Malin e Zi kërkohen të paktën 80 vota të deputetëve në Kuvend, ndërsa po flitet se koalicioni qeverisës deri tani ka siguruar 78 vota.

**IGOR SIMIÇ:**
"Lista Serbe nuk do ta votojë Demarkacionin me Malin e Zi, pavarësisht deklaratave të rreme dhe tendencioze në mediat në gjuhën shqipe, të cilat janë cituar edhe nga mediat serbe", tha deputeti i Listës Serbe, Igor Simiç.


Igor Simiç

## Miratohet ligji, Gruevski i hedh gotën me ujë kryetarit të Kuvendit

# Gjuha shqipe miratohet me 64 vota në Maqedoni

## *Xhaferri: S'marr masa ndaj ish-kryeministrit*

Ditën e djeshme, në një atmosferë të tensionuar, Kuvendi i Maqedonisë me 64 vota për e ka miratuar ligjin për përdorimin e gjuhëve, i cili zyrtarizon përdorimin e gjuhës shqipe në nivelin lokal dhe qendror të pushtetit. Miratimi i këtij ligji është bërë pa përfillur 35 mijë amendamente të propozuara nga partia opozitare, VMRO-DPMNE. Për këtë arsye deputeti dhe ish-kryeministri i Maqedonisë, Nikolla Gruevski, ka tentuar ta pengojë votimin, duke thënë se po votohet në mënyrë jo ligjore. Por, kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi nuk pranoi që të ndërpritet seanca. Aty te foltorja, ka dalë deputeti Gruevski duke provuar që ta pengojë votimin. Ai ka ndërhyrë edhe tek vendi ku rrinte ulur kryetari Xhaferi, të cilin e ka lagur edhe me një gotë ujë, çka e ka detyruar sigurimin të ndërhyjë për të mos u përshkallëzuar situata. Sidoqoftë, ligji është votuar dhe miratuar. Pas seancës, gjatë një konference për media, kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi tha se ligji për përdorimin e gjuhëve është miratuar në përputhje me rregulloren e punës së parlamentit dhe në asnjë mënyrë nuk janë shkelur proceduarat. Xhaferi tha se ai nuk do të marrë masa kundër sjelljes së Nikolla Gruevskit megjithëse është shprehur se sjelljen e tij do ta dënojnë qytetarët. "Unë si kryetar i parlamentit nuk kam nevojë dhe arsye që të ndërmarr masa ndaj Nikolla Gruevskit. Mendoj se vetë sjellja e tij flet mjaft. Njëherësh besoj se qytetarët e Maqedonisë ashtu siç morën masa ndaj veprimeve të këtilla në zgjedhjet e fundit lokale do t'i tregojnë të njëjtit se ku e ka vendin edhe në zgjedhjet e tjera",-tha Xhaferi. Po lidhur me zhvillimet në Kuvendin e Maqedonisë ka reaguar edhe Lidhja Social-demokrate e Maqedonisë, e kryeministrit Zoran Zaev, duke e quajtur VMRO DPMNE-në, parti që synon të bllokojë punën e Kuvendit. "Njëkohësisht kjo vërteton se Hristian Mickoski si lider i kësaj partie është marionetë e të dyshuarit Gruevski dhe se nuk posedon kapacitete që të reformojë VMRO-në. I dyshuari Gruevski, i cili 11 vite nëpërmjet politikave të krimit, dhunës, urrejtjes dhe ndarjeve ka shkatërruar Maqedoninë, vazhdon të punojë në kundërshtim me interesat e qytetarëve dhe shtetit",-theksohet në reagimin me shkrim të socialdemkratëve. Krahas kundërshtimeve të opozitës në seancë, edhe një grup i qytetarëve ishte grumbulluar para ndërtesës së Kuvendit për të protestuar dhe kërkuar që ligji të mos miratohej. Ata kanë brohoritur "tradhtarë", "kombi nuk është në shitje" dhe "shitës të shtetit". Megjithëse protesta vazhdonte e qetë dhe pa ndonjë incident para godinës së institucionit ligjdhënës kishte një prani të theksuar edhe të forcave policore. Në përgjithësi, seanca kaloi nën tensione. Në fillim të seancës kryetari i Grupit Parlamentar të partisë opozitare, VMRO-DPMNE, Ilia Dimovski tha se kësaj partie politike me ose pa të drejtë po i mohohet e drejta për dorëzimin e amendamenteve gjatë leximit të tretë të ligjit. VMRO-DPMNE kishte proceduar rreth 35 mijë amendamenteve për plotësim-ndryshimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, veprim ky që nga partitë shqiptare në Maqedoni ishte cilësuar si përpjekje për bllokimin e tërësishëm të ligjit. Lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim, të partisë shqiptare në pushtet, Ali Ahmeti, ndërsa po hynte në Kuvend tha se "debati për ligjin për gjuhët është shterur dhe i njëjti më nuk ka nevojë për shqyrtim". Ndërkaq Kryetari i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela para fillimit të seancës parlamentare tha se, pavarësisht që ai dhe partia e tij nuk janë më pjesë e qeverisë, do të votojnë për miratimin e ligjit, sipas marrëveshjes kur kishte qenë pjesë e koalicionit qeverisës. "Unë kam ardhur të votoj ligjin e gjuhëve bazuar në marrëveshjen e formimit të qeverisë",-tha Sela. Ndryshe leximi i tretë i ligjit që rregullon përdorimin e gjuhëve vjen pasi presidenti i shtetit nuk e dekretoi të njëjtin. Ky ligj ishte miratuar në Kuvend në muajin janar, me 69 vota.

**ZIADIN SELA:**
Unë dhe partia e ime nuk jemi më pjesë e qeverisë. Do të votojmë për miratimin e ligjit, sipas marrëveshjes kur kishte qenë pjesë e koalicionit qeverisës. Unë kam ardhur të votoj ligjin e gjuhëve bazuar në marrëveshjen e formimit të qeverisë", - tha Sela.


Talat Xhaferi dhe Nikolla Gruevski

**TALAT XHAFERI:**
"Unë si kryetar i parlamentit nuk kam nevojë dhe arsye që të ndërmarr masa ndaj Nikolla Gruevskit. Mendoj se vetë sjellja e tij flet mjaft. Njëherësh besoj se qytetarët e Maqedonisë, ashtu siç morën masa ndaj veprimeve të këtilla në zgjedhjet e fundit lokale do t'i tregojnë të njëjtit se ku e ka vendin edhe në zgjedhjet e tjera", - tha Xhaferi

**LIDHJA SOCIAL-DEMOKRATE E MAQEDONISË:**
"Njëkohësisht kjo vërteton se Hristian Mickoski, si lider i kësaj partie është marionetë e të dyshuarit Gruevski dhe se nuk posedon kapacitete që të reformojë VMRO-në. I dyshuari Gruevski, i cili 11 vite nëpërmjet politikave të krimit, dhunës, urrejtjes dhe ndarjeve ka shkatërruar Maqedoninë, vazhdon të punojë në kundërshtim me interesat e qytetarëve dhe shtetit",-tha në një reagim Lidhja Social-demokrate e Maqedonisë.

## SHKURT

### Stephen Hawking ndërron jetë në moshën 76-vjeçare

Shkencëtari më i famshëm më botë profesor Stephen Hawking ka ndërruar dje në moshën 76-vjeçare. Fizikanti i shquar ndërroi jetë paqësisht në shtëpinë e tij në Kembrixh mëngjesin e 14 marsit, pas një beteje të gjatë me sëmundjen e rrallë të qelizave nervore. Sipas asaj që shkruan "Daily Mail", Hawking u diagnostikua në vitin 1963, kur ai ishte 21 vjeç dhe sfidoi ekspertët mjekësorë të cilët i thanë që kishte vetëm dy vite jetë. Në 55 vitet që pasuan ai u bë shkencëtari më i famshëm në botë që prej Albert Einstein për punën e tij në eksplorimin e mistereve të hapësirës, kohës dhe vrimave të zeza. Ai ka shkruar gjithsej 15 libra në disa prej të cilëve ka qenë bashkautor. Hawking lindi më 8 janar 1942 në Oksford të Anglisë.

### Angela Merkel fiton mandatin e katërt si kancelare

Angela Merkel është zgjedhur ditën e djeshme nga ligjvënësit gjermanë për një mandat të katërt si kancelare dhe pritet të betohet të mërkurën. Votimi në parlament të mërkurën në mëngjes u jep fund trazirave që zgjatën pothuajse gjashtë muaj, pas zgjedhjeve federale, ku miliona votues braktisën dy partitë kryesore, CDU të Merkelit dhe Partinë Social Demokratike. Në një votim të fshehtë, 364 anëtarë nga 709 të Bundestagut votuan për Merkelin, nëntë më shumë se 50% të kërkuara. Fitorja e Merkelit shënon gurin përfundimtar në rrugën drejt qeverisë së re të Gjermanisë.

### Helmimi i ish-spiunit rus, Theresa May "ndëshkon" Putin

Kryeministrja Theresa May deklaroi dje në parlament se Britania do të dëbojë 23 diplomatë rusë, pasi Moska refuzoi të shpjegonte se si agjenti nervor i prodhuar në Rusi u përdor në sulmin kundër ish- spiunit rus në Salisbury. Theresa May tha se diplomatët, të cilët kanë një javë kohë për t'u larguar nga Britania, u identifikuan si "oficerë të inteligjencës të padeklaruar". Kryeministrja May gjithashtu ka pezulluar të gjitha takimet e nivelit të lartë të planifikuara mes Mbretërisë së Bashkuar dhe Rusisë si dhe ka anuluar vizitën e planifikuar të ministrit të Jashtëm të Rusisë, Sergei Lavrov në Britani. Rusia ka mohuar përfshirjen në tentativën e vrasjes së ish-kolonelit të inteligjencës ruse, Sergei Skripal dhe refuzoi afatin e vendosur nga Londra për të bashkëpunuar mbi rastin e tij. Kreu i qeverisë britanike tha se Moska nuk kishte dhënë asnjë shpjegim se përse agjenti nervor ishte përdorur në sulmin ndaj ish-spiunit rus.

EKSPOZITA







# Imazhet e rralla të Tiranës pa kulla dhe shkresat e Qazim Mulletit

Fatmira Nikolli

*1939, kur Mbretnija Shqiptare zmadhonte tregun e sistemonte sheshin "Avni Rustemi"*











Janë imazhet e një Tiranë pa kulla. Me ndërtesa trekatëshe, të rregullta, të unifikuara, megjithëse bëhet fjalë për pazar. Imazhet tregojnë Tiranën në praglufte, në kohë mbretërie, që me gjithë varfërinë e kohës, ç'kish bërë, e kish bërë mirë.

Janë dhjetëra e dhjetëra punëtorë që marrin pjesë në punime, ka zonja të veshura allafrënga e burra e gra me veshje popullore, ka biçikleta, kuaj me karroca, ka mjete për ndërtimin e sheshit, ka edhe gomerë. Ka kazma, lopata, rërë e karroca dore. E ka mes shumë të tjera, rregull përtej baltës. Diku larg, naltojnë mbi të gjitha minarja dhe kambanorja.

Qyteti ka përmasa të ndryshme: është ai për të cilin kemi dëgjuar apo jemi informuar në mënyrë të disiplinuar, është ai që mbajmë mend dhe ai që jetojmë sot. Të tria këto përmasa përmblidhen në ekspozitën fotografike me titull "Pazari i Ri dhe sheshi 'Avni Rustemi', 1939-1940" që çelet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Në verën e vitit 1939 Ministria e Punëve Botore lidh kontratë me shoqërinë "Pellegrini-Keçi & Co" për sistemimin e sheshit "Avni Rustemi" dhe Pazarit të Ri. Punimet përfunduan një vit më vonë, më 1940. Gjatë kohës së punimeve dhe me përfundimin e tyre, misioni i Institutit Kombëtar LUCE në Tiranë shkrepi dhe stampoi fotografitë që paraqiten në këtë ekspozitë. Fotografitë janë trashëguar nga Arkivi Qendror Shtetëror - Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe sot janë pjesë e fondit të fototekës së këtij arkivi. Disa prej tyre u prezantuan për herë të parë për publikun e gjerë dje te Pazari i ri në Tiranë në orën 10:00.

**EKSPOZITA**

Ka një vendim të Këshillit të Shtetit në mbledhjen e përgjithshme të mabjtun më datë 17/XI/XVIII, ditën e premte pas dreke, nën kryesin e z.Kristo Floqi dhe në ndodhte t'antarve Z.Ajet Libohova, Dr.Demir Villa, Benedikt Blinishti, Javer Hurshidi, Ali Asllani dhe Elmas Kokona.

MBRETNIJA SHQYPTARE
MINISTRIJA E PUNVET BOTORE
KONTRATË

Me sipërmarrjen "Pellgrini-Keçi e Co" mbi zbatimin e punimeve sistemimi dhe zmadhimi të Tregut të tanishëm të Tiranës, punim për t'u zbatue me fondin e veçantë të Ministris së Punvet Botore.

Ministria e P.Botore përfaqësue prej Zot.Dr.Ing Gamberini Gr.Uff. Luigi, këshilltar Permanent i Ministrisë autorizue nga Zot. Shefqet Verlaci kryeminister dhe xav.Minister i P. Botore me shkresën....

Afati i vlefshëm për zbatimin e punimeve objekt'i ksaj kontrate asht prej 120 (njiqindenjizet) ditësh të natyrshëm vazhduese tue fillue nga data e verbalit të dorzimit të punimeve.

*

Për çdo ditë vonesë të pranueme ose nga zgjatime rregullisht t'akordueme, sipërmarrjes ka me i u aplikue nji gjobë prej 30 (tridhjetë) fr.shq.- Shuma e gjobave ka me i u zbritun direkt nga stacioni apaltues nga kreditet e saj.

*

Pagesat e veprave ta batueme kan me u ba si mbas normavet në kiste mujore dhe në bazë të situacjoneve provizore të punimeve që duhen parashtrue muej për muej nga Sipërmarrja e Drejtimit të Punimeve për kontrollim dhe nënshkrim. Mbi çdo pagesë do të bahet ndalimi i 10% që ka me ju kthy Sipërmarrjes mbasi të bëhet dorëzimi provizuer. Ndër situacjone ka me u llogarit edhe materjali i raditun për përdorim që ndollet i depozituem në vendin e punimit në sasinë prej 50% të përbamjes së tij.

*

Marrja në dorëzim definitiv e veprës ka me u ba për mbas kërkeset të Sipërmarrjes, s'paku gjashtë muej mbas datës së dorëzimit provizuer.

*

Të gjitha punimet dhe furniturat të cilat ndonse nuk janë të përfshime në përshkrim dhe në listën e bashkangjitun, por që rezultojnë të nevojishme për zbatimin e plotë dhe rajonal të veprës, duhen zbatue si mbas kërkeset të Drejtimit të Punimeve. Çmimet përkatëse kan me u ujdisë ndërmjet palëve n'analogjië me çmimet e tjera të kontratës.

***



# Tre shqiptarët e Panairit të Laipcigut

*Letërsia shqipe prezantohet me thënien e Kadaresë "Letërsia më fali lirinë dhe jo anasjelltas"*











Letërsia shqipe është pjesë e Panairit të Laipcigut që mbahet në datat 15-18 mars. Në këtë panair, letërsia shqipe prezantohet në stendë dhe në katalog përmes thënies së shkrimtarit tonë Ismail Kadare "Letërsia më fali lirinë dhe jo anasjelltas", me prurjen më të mirë të letrave shqipe në vitet e fundit, me shkrimtarët bashkëkohorë më të vlerësuar me çmime kombëtare dhe ndërkombëtare në tri vitet e fundit, si: Bashkim Shehu, Çmimi "Balkanika 2015", Çmimi "Autori i Vitit" 2016; Rudi Erebara, çmimi Europian i Letërsisë, 2016; Idlir Azizaj çmimi "Autori i Vitit" 2017, çmimi "Autori i Vitit" 2015; Agron Tufa "Autori i Vitit i Panairit të Librit" 2016; Parid Teferici "Autori i Vitit i Panairit të Librit" 2015; Virion Graci çmimi "Autori i Vitit" 2015; Besnik Mustafaj, çmimi "Libri më i mirë i vitit 2017" në Panairin e Prishtinës; Luljeta Lleshanaku, nominuar për çmimin "Balkanika" dhe çmime kombëtare e ndërkombëtare; Romeo Çollaku çmimin e BE dhe çmime kombëtare, Ardian Kyçyku, i nominuar për çmimin e autorit të vitit për 2017 si dhe për çmime të tjera kombëtare. Një nderim i veçantë "IN MEMORIAM" për shkrimtarin Kasëm Trebeshina, si një nga emrat më të diskutuar, herë të vlerësuar dhe herë të anatemuar të letrave shqipe.

Stenda e Shqipërisë ku gërshetohet tradita me modernen është ideuar si një vend promovimi dhe bashkëbisedimi mbi krijimtarinë shqiptare bashkëkohore të fokusuar në trajtimin e temës së kujtesës, përballjes me të shkuarën diktatoriale, përshtatjen me ndryshimet rrënjësore historike, emigrimin, bashkëjetesën dhe integrimin, etj. Një nga ngjarjet më të rëndësishme të këtij panairi është festimi i 10-vjetorit të TRADUKI-t, rrjetit më të njohur të përkthimit që bashkon letërsinë dhe kulturën e vendeve të ndryshme të Evropës Qendrore dhe Juglindore si Shqipëria, Bullgaria, Gjermania, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Lihtenshtajni, Maqedonia, Mali i Zi, Austria, Rumania, Serbia, Sllovenia. Një përshëndetje e veçantë në këtë takim të rëndësishëm të përfaqësuesve më të lartë të këtij rrjeti prej ministrit të Shtetit, Michael Roth, si vendi më verior i TRADUKI-t dhe ministres së Kulturës së Shqipërisë, Mirela Kumbaro Furxhi, si vendi më jugor, si dhe shkrimtarit Christoph Ransmayr.

Të ftuar në stendën shqiptare janë tre autorë, përzgjedhja e të cilëve për të përfaqësuar Shqipërinë në Laipcig nuk dihet si është bërë.

Gazmend Kapllani, një shkrimtar shqiptar që ka jetuar prej njëzet vitesh në Greqi e që përmes krijimtarisë së tij zbulon se si totalitarizmi, emigracioni, kufijtë dhe historia ballkanike kanë formuar jetën private dhe narracionin e tij personal.

Thanas Medi, i vlerësuar nga kritika si një penë virtuoze dhe mjeshtër i kompozicionit, i cili në një pjesë të mirë të krijimtarisë vizaton me ngjyra emocionale tablo të jetës së një pakice kombëtare në Shqipëri, si vllehët, si dhe historinë e një brezi që përjetoi ndryshimet e mëdha të viteve nëntëdhjetë.

Manjola Nasi, përkthyese dhe poete që sjell lirikën urbane dhe imazhiste të brezit më të ri të letërsisë shqipe.

**LETËRSI E RE NGA TRADUKISTANI**

Tri zëra të letrarë - Tradukistan është një njësi gjeografike e pazakontë. Atje bëjnë pjesë të gjitha ato vende, të cilat pranojnë vullnetarisht sipërmarrjen e guximshme kulturore-politike, pranojnë të intensifikojnë dialogun letrar dhe ndërkulturor midis vendeve të Evropës Juglindore dhe vendeve gjermanishtfolëse. Me zëra të rinj letrarë nga Shqipëria, Lihtenshtejni dhe Rumania, TRADUKI e çel edhe këtë vit programin e tij në Panairin e Lajpcigut. A janë poetët një pakicë në Shqipëri? A i përkasin shtetasit e Lihtenshtejnit një pakice, megjithëse ata janë pjesë e familjes së madhe të gjuhës gjermane? Dhe si ka mundësi që të varfrit e kësaj bote, edhe pse janë shumicë, trajtohen si pakicë? Këtyre dhe pyetjeve të tjera do t'u japin përgjigje Manjola Nasi, Anton Beck dhe Bogdan Cosa dhe do të lexojnë nga veprat e tyre.

**LETËRSIA SHQIPE ME DHE PA KUFI**

Me autorët Manjola Nasi, Gazmend Kapllani, Thanas Medi dhe me praninë e ministres së Kulturës së Shqipërisë Mirela Kumbaro, takimi i parë është për kufijtë e letërsisë më 16 mars. Thënia e shkrimtarit tonë të njohur Ismail Kadare "Letërsia më fali lirinë dhe jo anasjelltas" është dhe slogani i stendës së Shqipërisë. Tre shkrimtarë, tri histori të ndryshme, tri përvoja të pazakonta përballen për të na shpjeguar nëse ka ndikuar liria në krijimtarinë e tyre. A është përkthyer në letërsi përmbysja e diktaturës komuniste? Hapja e kufijve ka sjellë një letërsi mendjehapur apo letërsia e ka lirinë e shprehjes edhe në qeli? Letërsia shqipe brenda kufijve dhe jashtë saj, letërsia shqipe është vetëm ajo që shkruhet në gjuhën shqipe? Po letërsia e emigrantëve që shkruajnë për tematikën shqiptare në gjuhë të tjera? Për të gjitha këto do të diskutohet me shkrimtarin Gazmend Kapllani, autor shqiptar që shkruan në gjuhën greke dhe është përkthyer në shumë gjuhë të botës; Thanas Medi, emigrant me origjinë arumune rrëfen për përvojën e shkrimit në gjuhën shqipe duke jetuar në një vend të huaj; shkrimtarja më e re Manjola Nasi, që jeton në Shqipëri rrëfen për librin e saj më të ri me poezi.

**MBI PAKICAT E HARRUARA**

Për pamjet nga afër të Evropës Juglindore do të flasin autorët më 17 mars Cyrill Stieger e Thanas Medi (Shqipëri) në stendën e TRADUKI-t, në një takim organizuar nga MK.

Zvicerani Cyrill Stieger ka udhëtuar në jugperëndim të Maqedonisë për të vizituar torbeshët myslimanë, në Bullgari tek arumunët e krishterë dhe ka njohur goranët në jug të Kosovës. Në librin e tij më të ri 'Ne nuk dimë më se kush jemi' (Zsolnay 2018), ai shpalos tablonë e një bote të njohur shumë pak, e cila kërcënohet nga zhdukja, vizaton një hartë të Ballkanit si të një rajoni, në të cilin ndodhen pakicat më të shumta etnike, fetare dhe gjuhësore në Evropë. Arumunëve, vllehve, njërit prej popujve më të vjetër të Evropës, i përket Thanas Medi. Lindur në Shqipëri, ai jeton sot në Greqi, por vazhdon të shkruajë në gjuhën shqipe. Në romanin e tij aktual, të vlerësuar me disa çmime, ai tregon për një pakicë evropiane, për të cilën shumë pak e dinë që ka një gjuhë të vetën, por nuk njeh asnjë formë shkrimi të saj.

**17 MARS, LETËRSIA E KUFIRIT**

Autorët Igor Štiks, Gazmend Kapllani (Shqipëri) në takimin e organizuar nga TRADUKI, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë do të flasin për sindromën e kufirit.

Igor Štiks është një autor midis kufijsh. Ai çapitet mes letërsisë artistike dhe shkencës, ndërsa gjeografikisht ndodhet midis Bosnjës, Kroacisë, Skocisë, SHBA-ve dhe Serbisë. Fenomeni i një identiteti kompleks si edhe aspektet e tij administrative, ai i njeh shumë mirë dhe janë burimi i shkrimeve të tij.

Sindroma Border është një metaforë e autorit shqiptar që jeton në Greqi, Gazmend Kapllani. Ditar i shkurtër kufijsh, që është përkthyer në disa gjuhë, tregon veç të tjerash si ai u largua me këmbë nga Shqipëria e Enver Hoxhës dhe kaloi kufirin për në Greqi. Një bashkëbisedim mbi kufijtë, prishjen dhe ndërtimin e mureve dhe gjerdheve si një ndër të vërtetat evropiane.

**VAJZA TË MBARA. GRATË NË LETËRSI**

Me autoret Manjola Nasi (Shqipëri), Lejla Kalamujiæ, Lidija Dimkovska të stenda e TRADUKI-t flitet për femrat në letërsi.

Koha e vajzave të mira në letërsi ka kaluar. Femrat e forta guxojnë të vështrojnë thellë në jetën e tyre shpirtërore dhe janë autore me vetëbesim të plotë. Poetja Manjola Nasi ndan në poezitë e saj ndjesi intime, autorja e tregimeve të shkurtra, Lejla Kalamujiæ shkruan në librin e saj më të fundit "Emri im qenka Esteban" me vetëdije të admirueshme mbi homoseksualitetin e saj dhe sëmundjen e saj psiqike. Shkrimtarja maqedonase Lidija Dimkovska lufton me kokën lart për veprat e autoreve femra, të cilat shkruajnë në një gjuhë të re, në një gjuhë të huaj. Vetë ajo jeton prej shumë vitesh në Slloveni, por vazhdon të shkruajë në maqedonisht.

**KORRESPONDENCË PËR NJË NEVOJTORE**

Mes ekspozitës është edhe një korrespondencë mes Bashkisë së Tiranës dhe Ministrisë së Punëve Botore për kolaudimin e WC-së publike në sheshin "Avni Rustemi".

Mbretnija Shqiptare
Bahskija e Kryeqytetit
Tiranë
Seksioni 1
Nr.449

Tiranë, më 27.7.1939
Ministrisë P.Botore

Kemi nderin me Ju njoftue se punimet për ndërtimin e nevojtores publike në sheshin "Avni Rustemi", treg i ri murë fund.

Lutemi me urdhënue nji inginer t'asaj P.T. Ministrije për me ba kalaudimin e nevojtores në fjalë.

Kryetar'i Bashkis Kryeqytetit
(Qazim Mulleti)
Vula dhe firma

Raport
Sot më datë 21 gusht 1939.

Unë i nënshkruari Ingjin. Dhimitër Reffa, në bazë të urdhënit të P.T. Ministrisë P.Botore nr.1131 datë 5/VIII/939 së bashku me z.Ingjin Sadi Pashallari Kryetar'i i Zyrës Teknike të Bashkis së Kryeqytetit shkuen në sheshin "Avni Rustemi" për të kolaudue nevojtoren Publike q'asht ndërtue në vendin e sipërm dhe në kontrollimin që u ba u konstatue se punimet janë krye që të gjitha si mbas kontratës, të lidhun me Bashkin e Kryeqytetit dhe nuk u pa as nji mungesë.

Dy firma dhe dy vula

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 4900 përfituesit

# ATP: Dosjet e vitit 1996, pronarët që kompensohen

## *Ish-pronarët, aplikimet e ezauruara*

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 4900 pronarë, të cilëve u është njohur e drejta për kompensim. Dosjet i përkasin vitit 1996. Lista me vlerësimin përfundimtar për subjekte është botuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Trajtimit të Pronave. Lista përmban të dhëna lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuara, sipërfaqja e njohur për kompensim, mangësitë në dokumentacion apo vlerësimin përkatës jepen të detajuara në regjistrin që shoqëron këtë njoftim. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit si dhe vlerësimin financiar për çdo dosje.

**KOMPENSIMI FINANCIAR**

Bazuar në skemën që po ndjek qeveria në zbatim të ligjit të ri për pronat, prioritet do të ketë prona truall, përkundër tokave bujqësore, që do të jepen për kompensim fizik. Pas shqyrtimit të kërkesave, kompensimi financiar bëhet vetëm për ato subjekte, vendimi i të cilëve është përfundimtar, i ekzekutueshëm ose për kërkesat që nuk janë trajtuar asnjëherë për kompensim. Të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall, do të përfitojnë kompensim financiar nga fondi i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë. Ndërkohë, pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar do të kompensohet fizikisht nga fondi i tokës. Në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar për tokën truall rezulton se pjesa e mbetur është deri në 5 për qind më



e madhe se vlera 50 milionë lekë, atëherë subjekti kompensohet për të gjithë vlerën, në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar rezulton se pjesa e mbetur është më e madhe se 5 për qind mbi vlerën 50 milionë lekë, atëherë subjekti për diferencën mbi 50 milionë lekë, kompensohet fizikisht, nga fondi i tokës.

**KOMPENSIMI FIZIK**

Agjencia e Pronës ka në zotërim 23 mijë hektarë tokë bujqësore, për të cilat ka përfunduar më herët edhe vlerësimi ekonomik, të cilat do të përdoren për skemën e kompensimit fizik. Për ndarjen e kësaj sipërfaqeje, dy do të jenë kriteret bazë. Kriteri i parë është rendi kronologjik i vendimeve, që do të thotë se, sikurse kompensimi financiar, edhe ky kompensim do të fillojë me vendimet më të vjetra në kohë. Kriteri i dytë lidhet me vendndodhjen e pronës që do të përfitojnë si kompensim fizik. Pra, pronari do të kompensohet me një pronë nga fondi fizik, e cila gjeografikisht është më afër me pronën që i është njohur për kompensim. Në lidhje me dokumentet që duhet të depozitohen, ato nuk ndryshojnë, por mbeten të njëjta, si në rastin e kompensimit financiar. Ndryshon vetëm formulari i aplikimit, i cili është specifik për secilin rast. Në total janë 26 mijë vendime të formës së prerë, të cilat presin të kompensohen. Bazuar në ligjin e ri, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka nisur një proces të ri rivlerësimi, ku një metër katror tokë do të llogaritet me çmimet e tregut, por zëri kadastral nuk do të jetë ky i sotmi, por ai që ka pasur prona në çastin e shpronësimit.

| Qarku | Emri (*Subjekti Kerkues)* | Atesia | Mbiemri (*Subjekti Kerkues)* | VLERESIMI |
|---|---|---|---|---|
| Gjirokastër | Hasan Rama | | | 1,392,868 |
| Korçë | Sami Bajraktari | | | - |
| Shkodër | Rrok Gila | | | EZAURUAR |
| Tiranë | DHIMITER PAPA | | | 6,027,210 |
| Durrës | Kosta Kutulla | | | |
| Elbasan | ILIRJAN IREXHAI | | | 3,006,520 |
| Elbasan | HYSEN HYSKJA | | | EZAURUAR |
| Elbasan | SEFER DELIU | | | 2,355,180 |
| Elbasan | MEHMET SHENGJINI | | | 1,633,792 |
| Elbasan | NAZMI QORRI | | | 562,104 |
| Elbasan | MUSTAFA IBRAHIM GJERGJI | | | EZAURUAR |
| Korçë | | | | 471,092 |
| Korçë | | | | 383,890 |
| Korçë | | | | 74,910 |
| Korçë | Mitat Cane, Nadire Cane | | | EZAURUAR |
| Korçë | Dylber Muçllari | | | EZAURUAR |
| Shkodër | Ahmet Bekteshi | | | 15,229,858 |
| Shkodër | Ahmet Bekteshi | | | |
| Tiranë | LAVDI KUQI | | | 3,377,160 |
| Korçë | Artemis Vako | | | 144,320 |
| Korçë | Zeqir Ferro | | | 451,976 |
| Gjirokastër | Bashkim Bejleri | | | |
| Gjirokastër | Athina Krisiko | | | |
| Gjirokastër | Reuf Shehu | | | |
| Gjirokastër | Niaz Rustemi | | | EZAURUAR |
| Korçë | Zarif Spaho | | | |
| Korçë | Myrvete Spaho | | | |
| Korçë | Vllazëria Çollaku | | | |
| Korçë | Ymer Berberi | | | EZAURUAR |
| Korçë | Kristaq Martini | | | EZAURUAR |
| Korçë | Genci Kolonja | | | EZAURUAR |
| Tiranë | ALIU | | | 4,480,000 |
| Tiranë | | | | 176,563,769 |
| Tiranë | | | | 23,281,773 |
| Korçë | | | | EZAURUAR |
| Lezhë | | | | |
| Korçë | Xhako Hasani | | | EZAURUAR |

| Qarku | Emri (*Subjekti Kerkues)* | Atesia | Mbiemri (*Subjekti Kerkues)* | VLERESIMI |
|---|---|---|---|---|
| Elbasan | REFIK HOXHA | | | 2,310,132 |
| Elbasan | SABRIE EDUARD BANJA | | | 3,114,416 |
| Korçë | Ylli Kape | | | 154,800 |
| Korçë | Ilia Jakova | | | 240,000 |
| Korçë | | | | 300,000 |
| Korçë | Gezim Isaku | | | |
| Korçë | | | | 2,723,303 |
| Korçë | Ilia Emanuel | | | 1,533,917 |
| Korçë | | | | 722,700 |
| Korçë | Violeta Zhuri | | | |
| Shkodër | Kol Pema | | | 19,067,880 |
| Tiranë | XHEMAL STAFA | | | 44,534,385 |
| Tiranë | XHEMAL STAFA | | | 19,889,793 |
| Tiranë | MUHARREM OSMANI | | | EZAURUAR |
| Korçë | Marike Mike | | | |
| Korçë | Petrit Dvorani | | | EZAURUAR |
| Korçë | Arsinoi Joti | | | |
| Korçë | Myfit Muçi | | | 231,320 |
| Tiranë | ISMAIL VESHI | | | |
| Tiranë | ISLAM META | | | 2,230,560 |
| Tiranë | MEREME DELIALLISI | | | 10,447,164 |
| Korçë | | | | |
| Korçë | | | | 269,244 |
| Tiranë | ALI SEFERI | | | |
| Vlorë | Arjan Puto | | | EZAURUAR |
| Vlorë | Nurije Gota | | | EZAURUAR |
| Vlorë | Nurije Gota | | | |
| Vlorë | | | | |
| Korçë | GANI BYLYKU | | | |
| Vlorë | trashëgimtarët | | | 2,155,400 |
| Vlorë | Esat Telhaj | | | 2,694,250 |
| Korçë | Muharem Shkembi | | | |
| Shkodër | Jonuz Teli | | | EZAURUAR |
| Shkodër | Agim Miloti | | | EZAURUAR |
| Shkodër | Skender ZAganjori | | | |
| Shkodër | Skender ZAganjori | | | |

| Qarku | Emri (*Subjekti Kerkues)* | Atesia | Mbiemri (*Subjekti Kerkues)* | VLERESIMI |
|---|---|---|---|---|
| Shkodër | Ndoc Kurbini | | | |
| Berat | Asllan Domi | | | |
| Berat | Kapllan Meçe | | | 223,119 |
| Berat | Fetah Karemani | | | |
| Korçë | Zhaneta Pojani | | | |
| Korçë | Kaliopi Xega | | | 782,925 |
| Korçë | Donika Qani Këndezi, Nevruz Qani Këndezi | | | |
| Korçë | KRISTAQ GJERGO | | | 482,800 |
| Korçë | Barjam Saliu | | | 53,250 |
| Korçë | Gaqo Cingo | | | |
| Korçë | Pandi Buleçi | | | 1,335,187 |
| Korçë | Mimoza Leco | | | |
| Korçë | Petrika Nasa | | | |
| Korçë | Eqerem Sade | | | |
| Korçë | Eva Papa | | | 213,425 |
| Korçë | Anastas Dodbiba | | | 990,000 |
| Korçë | Sulejman Malaj | | | |
| Korçë | Dhimiter Peco | | | |
| Korçë | Fatos Zhurka | | | 4,936,179 |
| Korçë | Lumturi Pupa | | | |
| Korçë | Dhosi Koki | | | |
| Korçë | Dhosi Koki | | | |
| Korçë | Statha Sofi | | | |
| Korçë | | | | 300,000 |
| Vlorë | Sleam Beqi | | | EZAURUAR |
| Vlorë | Enver Husi | | | EZAURUAR |
| Vlorë | Mynyr Shabani | | | 6,002,130 |
| Vlorë | Shefki Mezini | | | |
| Vlorë | Eftimi Pozio | | | |
| Vlorë | Tefik Hoxha | | | 2,616,720 |
| Vlorë | Nasho Qirko, Telemak Qirko | | | |
| Korçë | Petrika Nase | | | |
| Vlorë | Nikodhim Lula | | | 6,640,000 |
| Vlorë | Naxhire Tafili | | | EZAURUAR |
| Korçë | Irfan Çurka | | | 981,200 |
| Korçë | | | | |
| Korçë | | | | 846,000 |

| | | |
|---|---|---|
| Korçë | Xhelal Veseli | 60,000 |
| Korçë | Ali Zhabollari | 160,000 |
| Korçë | Jetnor Haxhi Myrto | |
| Korçë | Merjeme Cenolli | |
| Korçë | Gjike Sumbulla | |
| Korçë | Liri Kadillari | |
| Korçë | Tefik Doko | |
| Korçë | Demirali Rika | 296,208 |
| Korçë | Adem Kolami | 621,520 |
| Korçë | | |
| Korçë | Remzi Hoxhalli | 220,132 |
| Tiranë | LILJANA DUDUSHI | 15,402,870 |
| Tiranë | NAZIRE ZGJANI | 10,447,164 |
| Tiranë | OSMAN MEHMET MUÇA | 9,934,484 |
| Vlorë | Masar Ballaci | |
| Vlorë | Sanije Baxho | |
| Vlorë | Nedina Shena | |
| Vlorë | Lefter Qerama | |
| Vlorë | Sihat Bajo | |
| Vlorë | Hysen Shameti | |
| Korçë | Ramadan Lilolli | |
| Vlorë | Afron Braculla, Firdezi Braculla, Flamur Braculla, Hasim Braculla | |
| Korçë | | |
| Durrës | Vaide Hoxha | |
| Durrës | Bexhet Çela | 3,883,500 |
| Durrës | | |
| Durrës | | |
| Durrës | | |
| Durrës | | |
| Durrës | Eleni Peti | |
| Korçë | Rubije Lipe | |
| Korçë | Muharrem Musa | |
| Berat | Nebi Polovina | |
| Gjirokastër | Tete dhe trashegimtaret Shehu | EZAURUAR |
| Gjirokastër | Suat Haxhi | 1,477,500 |
| Gjirokastër | Abaz Muco | 769,248 |
| Korçë | Fatma Cane | 172,000 |
| Korçë | Hajrije Zerja | |
| Korçë | Sotiraq Vangjeli | 137,280 |
| Korçë | Sabri Shuaipi, Shaqe Shuaipi | 151,200 |
| Korçë | Xhafer Mehmeti | |
| Korçë | Nedine Shupe | |
| Korçë | Veiz Prodani | |
| Korçë | Ligor Canellari | 192,768 |
| Korçë | Feride Balla | 114,816 |
| Korçë | Njazi Pepi | 115,776 |
| Korçë | Vladimir Liço | 88,680 |
| Korçë | Dashnor Memishi | 147,360 |
| Korçë | Muhamer Manellari | EZAURUAR |
| Korçë | Kristaq Shuke | 157,365 |
| Korçë | Hida Koli Kodra | 251,784 |
| Tiranë | AGIM BAKIU | 15,065,172 |
| Korçë | Nevruz Mehmeti | 15,624 |
| Elbasan | ASIL MITRUSHI | |
| Elbasan | LUMNIJE GRACENI | 409,980 |
| Elbasan | AQIF ROÇI, ROCI | EZAURUAR |
| Korçë | Aleko Afezolli | |
| Korçë | STAVRI AFEZOLLI | |
| Korçë | Mitre Aleksi, Ollga Lika | 15,126 |
| Lezhë | Roza Ljarja | |
| Lezhë | Njazi Zyberi | |
| Lezhë | Leopald Shkreli | |
| Tiranë | GENC KRYEZIU | |
| Tiranë | EFTIMI ROSHI | 10,346,711 |
| Berat | Refije Hoxha | |
| Durrës | Shkelqim Kulla | |
| Korçë | Theodhora Plaku | |
| Korçë | Dhimo Krali | |
| Korçë | Theodhora Plaku | |
| Korçë | Dhimitraq Terpini | 23,085 |
| Korçë | Sali Shkembi | EZAURUAR |
| Korçë | Ali Etem | 253,184 |
| Shkodër | Tonin Pogu | 1,491,206 |

| | | |
|---|---|---|
| Shkodër | Xhemal Bushati | 6,281,118 |
| Shkodër | Alfons Muzhani | |
| Tiranë | BUKURIE , AISHE MURATI, PICIRI | 2,574,168 |
| Tiranë | NJAZI VARVARICA | 4,751,865 |
| Tiranë | RESHAT RESNJA | 4,486,923 |
| Tiranë | ANASTAS DODBIBA | 4,286,016 |
| Tiranë | RUSTEM HOXHA | 16,407,405 |
| Tiranë | TONIN GURAKUQI | 37,665,900 |
| Tiranë | JANAQ KOKERI | 1,125,720 |
| Tiranë | REXHEP KASMI | 5,502,495 |
| Tiranë | Nurije Mati | |
| Tiranë | JONUZ KRUJA | EZAURUAR |
| Tiranë | JAKOV HOBDARI | 14,733,180 |
| Tiranë | FATIME , LUTFIJE BEJO, MAZREKU | 17,679,816 |
| Tiranë | HARETINA GJIKA | 6,457,708 |
| Tiranë | HYSEN SHEHU | |
| Elbasan | BEXHET URUCI | |
| Korçë | Ridvan Nallbati | EZAURUAR |
| Korçë | Muhamer Topalli | |
| Korçë | Kozma Gjata | 27,900 |
| Korçë | AGIM SHKEMBI | |
| Korçë | Skender Shkaba | |
| Korçë | Mehmet Çuçka | 240,456 |
| Korçë | Myzejen Meçe, Rajmonda Tato | 183,936 |
| Korçë | Nurie Prodani | - |
| Tiranë | MYSLIM FAGU | 12,429,446 |
| Tiranë | PASHKO BRAHIMAJ | EZAURUAR |
| Durrës | Xhevdet Balla | |
| Dibër | Ibrahim Lika | |
| Durrës | Nexhmin Sako | |
| Durrës | Tofik Kokomani | |
| Elbasan | HYSEN KASEM HALA | 2,735,104 |
| Elbasan | MUSA SULCE | 1,559,864 |
| Fier | Naun Golloshi | EZAURUAR |
| Fier | Xhemal Hyseni | 1,402,275 |
| Korçë | Fitret Sarxha | |
| Korçë | Albert Zhgaba | |
| Korçë | Arvit Dervishi | 20,000 |
| Korçë | Pavllo Ropi | |
| Korçë | Mynever Orhani | EZAURUAR |
| Korçë | Ferit Faik Dishnica | 12,207,910 |
| Korçë | Niko Mangoleci | EZAURUAR |
| Korçë | Dhimitri Ndili | 869,280 |
| Korçë | Meri Suljoti (Karenxhi) | |
| Korçë | Xhorxheta Shandro | 3,551,392 |
| Korçë | | |
| Korçë | Anesti Lako | |
| Korçë | Zhaneta Poçi | |
| Korçë | Koco Mano | |
| Korçë | | 1,801,945 |
| Korçë | Nevruz Ahmet (Selenica) | EZAURUAR |
| Korçë | Vasilika Jani | |
| Korçë | Vasil Cici | 524,550 |
| Korçë | Dylber Gjyladin Dikellariu | 183,936 |
| Shkodër | Ndue Kol Kola | |
| Tiranë | | 604,110 |
| Tiranë | RAMAZAN TABAKU | |
| Tiranë | NURE ÇEREKU | 17,458,704 |
| Tiranë | DRITA HOXHA | 35,225,694 |
| Korçë | Viktor Kaçiroti | |
| Korçë | Nazmi Dikellari | 188,160 |
| Korçë | Vasil Jorgji | |
| Korçë | Mirdash Fero | |
| Durrës | Ahmet Dakoli | |
| Durrës | Zenun Alizoti | 4,985,700 |
| Durrës | Ilir Shedulla | |
| Tiranë | QERIME VISHKULLI | 2,451,050 |
| Tiranë | TRASHEGIMATRET E SUBJEKTEVE TRA | 142,777,908 |
| Vlorë | Sanije Baxho | |
| Gjirokastër | Viktori dhe trashegimtaret e tjere Como | EZAURUAR |
| Gjirokastër | Atdhe Bejleri | |
| Korçë | Bujar Shehu | |
| Korçë | | 305,472 |

| | | |
|---|---|---|
| Shkodër | Kol Pema | EZAURUAR |
| Tiranë | FADIL ALVORA | 1,344,000 |
| Tiranë | OSMAN TEQJA (DURISHTI) | EZAURUAR |
| Tiranë | HAZIZ MARA | EZAURUAR |
| Tiranë | KADRI HOXHA | EZAURUAR |
| Tiranë | TAFIK MATA | 9,777,474 |
| Tiranë | Sali Egro | |
| Tiranë | VANGJEL KOJA | 1,741,194 |
| Tiranë | RASIM DEMIRI | 1,138,473 |
| Gjirokastër | Skender Ruka | 748,600 |
| Gjirokastër | Nedime Kumbare | EZAURUAR |
| Korçë | SELAM SHEHU | |
| Lezhë | Llesh Ndue pergega | |
| Tiranë | VERA ZHEJI | |
| Tiranë | | |
| Tiranë | AGIM PETRELA | |
| Tiranë | GENC DELIALLISI | EZAURUAR |
| Tiranë | GENC LEKA | - |
| Tiranë | MEHMET ZAJMI | 9,488,838 |
| Tiranë | BENIAMIN CETA | 26,318,125 |
| Tiranë | MUSTAFA MUMAJESI | 11,639,212 |
| Durrës | Rifat Mecja | |
| Durrës | Nexhip Xheneti | 6,819,138 |
| Korçë | Nafi Gracka | EZAURUAR |
| Durrës | Jovan Prifti | |
| Gjirokastër | Naime Ismailati | |
| Gjirokastër | Nevruz Bejleri | EZAURUAR |
| Gjirokastër | Sazan Hamiti | |
| Korçë | Mazllem Domazeti | 33,368 |
| Korçë | Salo Zyfer | 143,792 |
| Lezhë | Simon Kalaj | 4,092,170 |
| Lezhë | Mark Geg Gjeta | 945,200 |
| Shkodër | Lam Bajram Kaçupaj | |
| Shkodër | Dan Dervishi Hasanaj | |
| Shkodër | Zef Gjek Lulati | |
| Shkodër | Zef Curra | |
| Shkodër | Lulzim Utsaj | |
| Shkodër | Liza Jubani | |
| Shkodër | Rasim Shiroka | 919,188 |
| Shkodër | Vahid Halluni | |
| Shkodër | Jup Troshani | - |
| Tiranë | GALIP LERA | 492,786 |
| Tiranë | HAXHIRE HOXHA | 35,158,725 |
| Tiranë | FIQIRI, QAZIM ASLLANI | |
| Tiranë | Arlena Xega | 53,575,200 |
| Tiranë | KASEM BANJA (BENJA) | 1,607,256 |
| Korçë | Tasim Karaxhuku | EZAURUAR |
| Korçë | Makbule Gjiriti | |
| Gjirokastër | Mirins Kumbaro | EZAURUAR |
| Korçë | Petraq Tanellari | 1,395 |
| Korçë | Qamil Hasani | |
| Korçë | Jakup Iljaz Isaj | 356,640 |
| Korçë | Hatixhe Bejko | |
| Korçë | Sotir Dhroso, Thomaidha Dhroso | 23,082 |
| Korçë | Kosta Milo | |
| Korçë | Afroviti Prifti | |
| Korçë | Tasi Qirjo | |
| Tiranë | AHMET SULSTAROVA | 4,707,921 |
| Tiranë | SADIK ZEQIRI | |
| Tiranë | RESHAT LLESHI | 5,705,759 |
| Vlorë | Silvana Naçi | |
| Vlorë | Marjana Kume | |
| Vlorë | Hyrije Seferaj | 6,541,800 |
| Vlorë | Fatime Bubeqi | |
| Vlorë | Faik Isufi | EZAURUAR |
| Vlorë | Albert Hoxha | 3,270,900 |
| Vlorë | Agim Spahiu | |
| Vlorë | Vllasi Thomai | |
| Vlorë | Gëzim Osmani | |
| Vlorë | Enerieta Bejkosala | 20,697,000 |
| Vlorë | Trashgimtaret Bataj | |
| Vlorë | Jaho Jahja | |
| Vlorë | Minella Mone | |

| | | |
|---|---|---|
| Vlorë | Hilmi Paracaj | 6,116,583 |
| Vlorë | Fixhe Kullai | 66,440 |
| Korçë | Ramadan Zyfi | |
| Korçë | | 100,800 |
| Korçë | Vasil Demiri | 23,085 |
| Korçë | MESEN HYSENI | |
| Korçë | Engjell Molla | 642,600 |
| Korçë | Njazi Molla | 3,141,600 |
| Korçë | Bajram Kodrasi | |
| Korçë | Engjell Vila | 956,890 |
| Korçë | Rita Engjell Kuçana | 414,200 |
| Korçë | Avdyl Malo | 1,717,000 |
| Korçë | Agim Bujari | 1,069,400 |
| Korçë | Selim Cenolli | 126,831 |
| Korçë | Viktor Kaçiroti | |
| Korçë | | |
| Korçë | Verter Mara | |
| Korçë | Zhaneta Nako | 263,725 |
| Korçë | Petrike Konomi | |
| Korçë | Viktori Dhima | |
| Tiranë | PRANVERA SADIKAJ | 3,067,020 |
| Tiranë | TRASHEGIMTARET E ADEM KARRIKU | 2,184,090 |
| Tiranë | | 1,847,183 |
| Tiranë | Naim Gjeçi | |
| Tiranë | Galip Gjeçi | 15,490,000 |
| Tiranë | HAMDI CIKU | EZAURUAR |
| Tiranë | SHAQIR MANSAKU | 688,794 |
| Tiranë | OSMAN YMER TAKU | |
| Tiranë | | |
| Tiranë | SANIE ALLA | |
| Tiranë | MUSTAFA MAÇI | EZAURUAR |
| Tiranë | XHEMAL MUÇA | |
| Korçë | Ferit Gupe | 230,364 |
| Korçë | Androni Mele | 21,248 |
| Korçë | Nuri Mancelli | 252,000 |
| Durrës | Lutfi Veseli | |
| Durrës | Myftar Kupi | |
| Durrës | Muharrem Shani | |
| Durrës | Haxhi Shani | |
| Fier | Pellumb Belishova | EZAURUAR |
| Korçë | Agron Minarolli | |
| Shkodër | Simon Lufi | 1,276,650 |
| Shkodër | Domenika Vjerdha | 1,719,222 |
| Tiranë | | |
| Tiranë | RITA HYSEN PEQINI | 492,786 |
| Tiranë | ERFAN DAUTI | 7,701,435 |
| Tiranë | | |
| Tiranë | PREZA | 78,018,885 |
| Vlorë | Meto Metaj | 46,080 |
| Vlorë | Premtim Shehu | EZAURUAR |
| Vlorë | Polimer Çeçi | EZAURUAR |
| Vlorë | Nasho Fundi | EZAURUAR |
| Vlorë | Shaban Mino | |
| Vlorë | Felatun Dajlani | 1,128,000 |
| Vlorë | Dhimiter Çavo | EZAURUAR |
| Fier | Gjergji Gjini | |
| Fier | Thoma Dhamo | |
| Fier | Adem Kurti | |
| Fier | Arife Qosja | |
| Fier | Asqeri Bali | 7,691,952 |
| Fier | Tomorr Zdrava | 8,195,901 |
| Fier | Gliqiri Konomi ( Gjini ) | 177,632 |
| Fier | Ferit Guri | 5,568,968 |
| Fier | Minushe Shazivari | |
| Fier | Ristan Stasa | |
| Fier | Asqeri Senka | |
| Fier | Matilda Dovana | |
| Fier | Grigora Robo | |
| Fier | Petrit Tosku | 6,431,760 |
| Fier | Muharrem Fishta | |
| Fier | Faik Sula | 2,564,160 |
| Korçë | | |
| Korçë | Hytbije Setke | 121,500 |

| | | |
|---|---|---|
| Korçë | Ali Mydin | |
| Korçë | Alltene Perona | 51,600 |
| Korçë | | |
| Korçë | Farie Balliu | 1,298,880 |
| Korçë | Guradem Isallari | |
| Kukës | Myftar Imer Elez Hasan Trashe Imeraj I | 7,265,120 |
| Tiranë | QEMAL E VELLEZER HAVERIKU | |
| Tiranë | | 1,337,200 |
| Tiranë | Ejup Veizi, Fatime Veizi, Naxhije Veizi | |
| Tiranë | | |
| Tiranë | SKENDER VEIZI | |
| Tiranë | | EZAURUAR |
| Tiranë | URAN ASLLANI | |
| Tiranë | Harun Veizi | 166,803 |
| Fier | Hakik Xhumari | |
| Fier | Mina Mitrushi | 9,641,242 |
| Elbasan | KOLE ASIL GIGNASI | EZAURUAR |
| Korçë | Shahin Piringu | EZAURUAR |
| Korçë | Nexhmi Gracka | EZAURUAR |
| Korçë | Seit Latif | |
| Korçë | ISLAM MYRTE | 121,500 |
| Korçë | Ylvije Diko | |
| Durrës | Baftjar Vrijoni | |
| Shkodër | Gani Tahiraga | 11,438,784 |
| Shkodër | Anida Isuf Veselaga | 5,889,612 |
| Shkodër | Trash.Sakaj | 7,847,142 |
| Elbasan | Mahmut Qamil Peni | 6,382,000 |
| Korçë | Petro Jani | |
| Elbasan | BASHKIM ÇELIKU | |
| Korçë | Donika Qani Këndezi, Nevruz Qani Këndezi | |
| Korçë | Donika Qani Këndezi, Nevruz Qani Këndezi | |
| Korçë | Donika Qani Këndezi, Nevruz Qani Këndezi | |
| Korçë | Kostanca Prodani | - |
| Korçë | Kostanca Prodani | 239,625 |
| Korçë | Ismail Maluka | EZAURUAR |
| Tiranë | ZENEPE EMIRI (KRIPA) | |
| Tiranë | SYRJA KURTI | |
| Korçë | Gani Bega | |
| Korçë | Nafije Spaho | 585,000 |
| Korçë | Gani Dede | |
| Korçë | | 52,488 |
| Korçë | Muhamet Prespa | |
| Korçë | Vladimir Dume | EZAURUAR |
| Korçë | Kostaq Gode | |
| Korçë | Llambi Kotoko | |
| Korçë | | 1,552,027 |
| Korçë | Ilmi Calo | |
| Korçë | Jani Mosko | 2,355,580 |
| Korçë | | 2,406,580 |
| Korçë | | 900,000 |
| Korçë | Shefqet Qelibari | EZAURUAR |
| Shkodër | Trashegimtaret Pistulli | 21,023,560 |
| Shkodër | Jonuz Gani Kullolli | 4,522,510 |
| Shkodër | Marash Ndreka | EZAURUAR |
| Shkodër | Mark Luli | 2,425,635 |
| Shkodër | Lezina Kiri | |
| Tiranë | TRASHGIMTARET TRASHGIMTARET | |
| Tiranë | Dylbere Thartari, Engjellushe thartari, Gazı | 3,220,088 |
| Tiranë | QAMILE DAIU | EZAURUAR |
| Tiranë | FATMIR KOBURI | 3,549,357 |
| Tiranë | | 4,687,830 |
| Tiranë | KUBURI | 10,132,410 |
| Tiranë | KADRI KOBURI | 4,727,752 |
| Tiranë | NEBI SEFA | |
| Vlorë | Garifo Vangjel Papa | EZAURUAR |
| Vlorë | Laze Mehmeti | 36,060 |
| Tiranë | Sulltane Tafa | 5,103,955 |
| Vlorë | Meto Xhafa | 39,440 |
| Korçë | | EZAURUAR |
| Tiranë | PRANVERA ZENELI | EZAURUAR |
| Tiranë | MEHMET MACI | |
| Tiranë | JUSUF LEZHJA | 11,384,730 |
| Tiranë | ZAMIRA KAZAZI | 4,018,140 |
| Tiranë | ZAMIRA KAZAZI | - |

| | | |
|---|---|---|
| Elbasan | Agim Hakani | |
| Elbasan | TRASHGIMTARET KOKUNJA | - |
| Elbasan | MYZEJEN FATOS CEREKJA | |
| Durrës | Masar Shaba | |
| Durrës | Alush Meta | |
| Durrës | Aleksandër Piqoni | |
| Tiranë | TRASHEGIMTARET PINARI | EZAURUAR |
| Tiranë | HASAN BAHUSHI | |
| Tiranë | PETRIT DELIU | |
| Durrës | Gezim Taga | 1,725,870 |
| Berat | Hekuran Çela | 605,778 |
| Berat | Bardhyl Ylli | 774,662 |
| Berat | | 143,279 |
| Korçë | Petrit Kutrolli | |
| Korçë | Bajram Mersuli | 148,500 |
| Korçë | Njazi Mersuli | 166,200 |
| Korçë | Elmaz Shaban | 124,500 |
| Korçë | Myrteza Emin | 189,750 |
| Korçë | Reshat Beqir | |
| Tiranë | Spiro Avrami | 6,402,864 |
| Tiranë | Spiro Avrami | |
| Tiranë | | EZAURUAR |
| Tiranë | | |
| Tiranë | HAXHI MALOKU | 12,389,265 |
| Tiranë | DRITA PENGILI | 14,478,531 |
| Vlorë | Angjeliqi Baguca | |
| Vlorë | Ardia Lezo | |
| Vlorë | Polikseni Ceko | |
| Vlorë | Myftar Cuci | |
| Vlorë | Spiro Konduri | 238,050 |
| Vlorë | Jani Maksokuli | 126,960 |
| Vlorë | Spiro Qirjaqi | |
| Elbasan | ABEDIN DERVISHI | - |
| Elbasan | MENSUR FLUTURAKE TAHIRAJ | - |
| Elbasan | ZEQIR SARJA | - |
| Elbasan | AVNI SULA | 100,823 |
| Elbasan | Sulo Lila | |
| Elbasan | MELEQ LILA | 574,691 |
| Elbasan | Nuri Dermyshi | 835,991 |
| Elbasan | AMET DERMYSHI | 1,629,972 |
| Elbasan | REFAT LILA | 1,088,889 |
| Elbasan | | 109,225 |
| Elbasan | RESMI GODOLE | 835,151 |
| Elbasan | Dituri Xhangolli | |
| Elbasan | BARDHYL TAPIA | 1,512,346 |
| Elbasan | SEFER MUKA | 1,764,403 |
| Elbasan | Medi Koçia | 1,313,220 |
| Elbasan | Qani Koçia | 408,333 |
| Elbasan | Izet Hoxha | 954,458 |
| Elbasan | Pellumb Hoxha | 386,488 |
| Elbasan | METE KOCIA | 756,173 |
| Elbasan | ASLLAN MYFTARAJ | 5,437,723 |
| Elbasan | QERIM IBRA | 525,120 |
| Elbasan | NEIM IBRUSHI | 2,507,973 |
| Elbasan | ADEM BREGASI | 6,974,014 |
| Elbasan | BEHAR CONIKU | |
| Elbasan | MAHMUT CELA | 1,082,167 |
| Elbasan | SANIJE KOCI | 764,575 |
| Elbasan | SANIJE KOCI | 2,229,870 |
| Elbasan | SHYQO TOCILA | |
| Elbasan | ZEQO MIRAKA | 1,016,632 |
| Elbasan | XHAFERR FEIMI | 453,704 |
| Elbasan | XHEVAIR LILA | 347,839 |
| Gjirokastër | Ilirjan Kokalari | |
| Korçë | Dylber Gjyladin Dikellariu | EZAURUAR |
| Tiranë | SOTIRAQ KENO | 7,699,980 |
| Tiranë | FADIL BEGA | |
| Tiranë | HAXHI HYKA | 1,741,194 |
| Tiranë | ZYBER ALIMEHMETI | 9,576,567 |
| Tiranë | BREGASI | 21,160,472 |
| Tiranë | NESTOR KOTE | 60,406,038 |
| Tiranë | BAJRAM PREZA | 30,470,895 |
| Tiranë | MUHAMET FISHKU | |

| | | |
|---|---|---|
| Tiranë | MYSLYM KURDARI | 2,209,977 |
| Tiranë | MYSLYM KURDARI | 2,209,977 |
| Tiranë | MYSLYM KURDARI | 629,509 |
| Tiranë | BLLACA | 11,518,668 |
| Tiranë | RIFAT ÇETA | 20,094,048 |
| Elbasan | Avram Vangjel Biqiku | |
| Elbasan | Shehin Dervishi | 11,175,562 |
| Korçë | ZYDI TOPI | |
| Korçë | | EZAURUAR |
| Korçë | | |
| Vlorë | Novruz Bega | 470,000 |
| Vlorë | trashëgimtarët | |
| Vlorë | Dhimo Sotiri | 3,771,950 |
| Vlorë | Minella Bala | |
| Korçë | Myslym Sejdo | EZAURUAR |
| Vlorë | Kristo Qirko | 512,000 |
| Korçë | ZYMBYLE AGOLLI | |
| Korçë | Qamil Yzeir | 55,040 |
| Korçë | Kostandina Gjika | 18,393 |
| Korçë | Engjellush Kodrasi | 460,588 |
| Korçë | Lefter Tili | |
| Korçë | Qirjako Kolaci | |
| Korçë | Samedin Kulla | |
| Korçë | Bardhyl Mullalli | 83,828 |
| Korçë | Ali Mullalli | 98,500 |
| Korçë | Shyqyri Terolli | |
| Korçë | Enver Sherolli | |
| Korçë | Nikolla Naço | |
| Lezhë | Tef Ndreka | |
| Tiranë | ROMEO TUNDO | 5,223,582 |
| Vlorë | Pano Çetri | 306,240 |
| Vlorë | Thimio Mehilli | 26,400 |
| Vlorë | Qendro vogli | 62,920 |
| Korçë | Naim Baki | EZAURUAR |
| Tiranë | KADRI HOXHA | |
| Gjirokastër | Thoma Selo | 605,360 |
| Tiranë | BASHKIM VORPSI | |
| Tiranë | SADIJE RADHESHI | 8,353,560 |
| Fier | Bilbil Serjani | |
| Fier | Muharrem Hodaj | |
| Korçë | Rapo Hoxhalli | |
| Korçë | Hysen Berberi | |
| Korçë | Mitat Hoxha | EZAURUAR |
| Korçë | Rustem Rusi | 283,800 |
| Tiranë | OSMAN SHTISHI | EZAURUAR |
| Tiranë | NEXHIBE TARAKU | |
| Tiranë | SULEJMAN MADHI | 8,033,627 |
| Tiranë | HASAN TABAKU | 30,872,709 |
| Tiranë | GENC DRINI | 40,794,836 |
| Tiranë | | 8,572,032 |
| Tiranë | GEJSU BASHA | 42,592,284 |
| Tiranë | NDREKO QIRKOLLARI | 6,696,900 |
| Tiranë | NAKO HOBDARI | 4,934,000 |
| Tiranë | ABDULLA ZAJMI | 53,642,169 |
| Tiranë | BEQIR KAMBERI | 5,524,943 |
| Fier | Haredin Hamitaj | |
| Korçë | Petro Popllo | |
| Kukës | Halim Nobolli | |
| Tiranë | Shyqyrie Gjoci | 6,041,100 |
| Tiranë | DASHAMIR PETJA | - |
| Tiranë | | 57,795,144 |
| Durrës | Marigo Leonidha Jani , Vangjel Leonidha l | 1,225,920 |
| Vlorë | Emlo Alushi | 952,200 |
| Durrës | Lefteri Shkurti | 536,940 |
| Durrës | Aleksandër Tirana | |
| Vlorë | Andrea Gjika | 101,100 |
| Durrës | Agim Beshiri | |
| Durrës | Agim Beshiri | |
| Durrës | Liman Sheqerja | |
| Lezhë | Pjeter Llesh Haci | |
| Durrës | Thoma Nisi | |
| Durrës | Mustafa Kalavrezi | |
| Durrës | Mustafa Kalavrezi | |
| Durrës | Anina Strati | 1,288,656 |

| | | |
|---|---|---|
| Durrës | Kisha Katolike Durrës Kisha Katolike Durrës | |
| Durrës | Isa Shuaipi | |
| Elbasan | QANI DERMYSHI | 504,115 |
| Elbasan | SOSE LATIFI | 925,892 |
| Elbasan | QAZIM LATIFI | 584,774 |
| Elbasan | Livan Murati | |
| Elbasan | HURMA LATIFI | 1,688,786 |
| Elbasan | SERVET MURATI | 1,484,619 |
| Elbasan | PETREF KOCI | 1,971,299 |
| Elbasan | MESUT KOLLCAKU | 991,427 |
| Elbasan | SHAHET IBRUSHI | 1,344,307 |
| Elbasan | Ferik Cela | |
| Elbasan | MURAT LUMSHI | 1,840,861 |
| Elbasan | ZADE KOKOMECI | 1,535,031 |
| Elbasan | Zymbyle Latifi | 322,634 |
| Fier | Ymerli Troka | 2,730,624 |
| Fier | Petref Hoxha | 3,948,902 |
| Fier | Ali Hoxha | 4,368,998 |
| Fier | Pëllumb Veizaj | |
| Fier | Llazar Bare | |
| Fier | Kasëm Çukaj | 6,251,500 |
| Fier | | 6,049,382 |
| Fier | Llaq Kola | |
| Fier | Ramadan Troka | |
| Fier | Alush Siqeca | 9,242,112 |
| Fier | Isuf Bregu | - |
| Fier | Jemin Milova | |
| Fier | Zoi Sota | |
| Fier | Rushan Rushani | |
| Fier | Hamdi Xhelili | 8,569,958 |
| Fier | Bektash Kokona | 2,772,634 |
| Fier | Fatbardha Gega | 2,772,634 |
| Fier | Irfan Karamani | 9,359,739 |
| Fier | Viqe Samargjiu | |
| Korçë | Lutfie Lula | 202,500 |
| Korçë | VIKA LAKRORI | |
| Tiranë | AHMET MESITI | |
| Durrës | Haki Doraci, Hysni Doraci | |
| Vlorë | Kristina Kaliopi, Lipi Prifti | |
| Vlorë | Vasillaq Semanjaku | 954,500 |
| Vlorë | Koçi Risilia | 4,470,230 |
| Vlorë | Falie Çika, Pavllo Çika | |
| Vlorë | Nuri Drasa | 4,306,685 |
| Vlorë | Meto Bajrami | 1,308,360 |
| Vlorë | Skënder Spaho | |
| Vlorë | Xhevrie Bardhi | 652,800 |
| Vlorë | Avdurraman Zilja | 4,829,300 |
| Vlorë | Dhimitër Leka | |
| Vlorë | Avdul Sheremeti | 327,090 |
| Vlorë | Tare Likaj | |
| Vlorë | Miti Nushi | |
| Vlorë | Neim Jaupi | |
| Vlorë | Mehmet Zaimi | 3,270,900 |
| Vlorë | Perlat Lushaj | |
| Vlorë | Alqivadh Babe | |
| Vlorë | Spiro Naqo | EZAURUAR |
| Durrës | Haxhi Vogli | |
| Gjirokastër | Jorgo Cuklla | EZAURUAR |
| Gjirokastër | Kristo Papu | EZAURUAR |
| Gjirokastër | Gege Shuli | 40,836 |
| Gjirokastër | Magdalena Kadushi (Doni) | 104,550 |
| Gjirokastër | Mexhit Katavo | 1,672 |
| Dibër | Fitie Deda | |
| Dibër | ZELIE KOLA | 313,035 |
| Dibër | XHAFER SELIM GJOKA | |
| Korçë | Llazi Lamo | EZAURUAR |
| Lezhë | Pren Gega | - |
| Lezhë | Gjin Preng Leka | |
| Lezhë | Dilaver Shafloqi | |
| Lezhë | Pashk Trokthi | |
| Tiranë | Osman Sinella, Servete Sinella | 220,733 |
| Tiranë | GRIGOR JANI GJIRJA | |
| Tiranë | | 371,760 |

| | | |
|---|---|---|
| Tiranë | LUMTURI BALLA | |
| Tiranë | FIQIRI SINELLA | 3,563,070 |
| Lezhë | Karolina Gjoshja | |
| Korçë | Robert Madhi | |
| Korçë | Ismail Venxha | 100,000 |
| Korçë | Viktor Skendi | |
| Korçë | Zarife Plumbi | 100,000 |
| Korçë | Osman Thellimi | |
| Tiranë | BEQIR DERHEMI | |
| Tiranë | BEQIR DERHEMI | |
| Tiranë | ASLLAN SHIMA | 1,373,120 |
| Tiranë | REXHEP KASTRATI | 6,828,606 |
| Tiranë | FATMIRA KONI | |
| Tiranë | ADEM FAGU | - |
| Tiranë | ADEM FAGU | - |
| Tiranë | ADEM FAGU | 11,384,730 |
| Tiranë | ADEM FAGU | 8,170,218 |
| Tiranë | ADEM FAGU | 3,107,362 |
| Tiranë | BUJAR ÇELO | 41,855,625 |
| Tiranë | MYSLIM FAGU | 10,463,906 |
| Tiranë | QAMILE DEMIRAJ | 13,634,888 |
| Tiranë | REXHEP HOXHA | 9,040,815 |
| Vlorë | Vaso roshi | 793,600 |
| Korçë | Rea Zguri | 800,000 |
| Korçë | Kozma Tane | |
| Lezhë | Zef Mark Reci | |
| Durrës | Fadil Bagoi | 9,769,050 |
| Durrës | Namik Mane | |
| Durrës | Sadush Hidri | |
| Durrës | Pavllo Rrutja | EZAURUAR |
| Durrës | Kandila Bozo | |
| Fier | Vangjel Papa | 7,561,728 |
| Vlorë | | 777,600 |
| Gjirokastër | Margarita Jani | 453,704 |
| Gjirokastër | Sotir Dodde | 724,457 |
| Dibër | Ramadan Keta | 575,200 |
| Dibër | Ramadan Keta | 147,600 |
| Gjirokastër | Llazar Drasa | - |
| Gjirokastër | Bujar Fezga | |
| Dibër | Mustafa Mira | 171,100 |
| Dibër | Mustafa Mira | - |
| Gjirokastër | Ermion Caci | |
| Dibër | Qamil Bala | |
| Dibër | Qamil Bala | |
| Korçë | Mynyr Spaho | EZAURUAR |
| Gjirokastër | Bardhyl Memishaj | |
| Tiranë | SPASE MIRÇE | 30,035,597 |
| Tiranë | MYLAZIM BEHARI | 30,872,709 |
| Tiranë | QERIME SHABANAGA | |
| Vlorë | Neim Jaupi | |
| Dibër | Isuf Llorja | |
| Gjirokastër | Qako Konini | |
| Durrës | | |
| Tiranë | RIFAT DELISINA (DELISINA) | 34,204,417 |
| Elbasan | SABRI BRAHIMI | 8,233,882 |
| Elbasan | NEIM HYSA | 8,413,263 |
| Elbasan | SADIK KALA | |
| Elbasan | RESHITE SENKO | 2,041,667 |
| Elbasan | SHERIF JANCA | 1,369,513 |
| Elbasan | Halit Jança | |
| Elbasan | AFEZ KUME | 861,197 |
| Elbasan | RUSHIT KRYEMADHI | 772,977 |
| Elbasan | ZACE KRYEMADHI | 599,897 |
| Berat | Petref Qama | 542,902 |
| Korçë | HYSEN SINO | |
| Korçë | Xhevdet Gegolli | 222,172 |
| Kukës | Sadik Adem Maçi | |
| Shkodër | Feride Rukaj | |
| Tiranë | SKENDER BASHA | 374,080 |
| Tiranë | ALI KEÇI | - |
| Tiranë | ZARE NASUFI | 9,010,944 |

*(Vijon nesër)*

Opinioni i Ditës

# Perëndimi, pas gjyqësorit në Shqipëri, vëmendje e shtuar ndaj sektorit mediatik

Nga Monika Stafa

*(vijon nga faqja 1)*

...Mosbesueshmëria e medias i mbledhur kapicë, skepticizmi për etikën e gazetarëve dhe mëria ndaj pushtetit të medias janë bërë thuajse karakteristika të përhershme të skenës mediatike bashkëkohore. Teksa nuk mund të thuhet se përgjegjësja e vetme për këtë gjendje është media vetë, gazetarët dhe ata që drejtojnë media janë tejet të vonuar në përpjekjet për të shprehur qartë parimet e lojës së tyre, të paktën aq qartë sa të jenë të dukshme publikisht, të mbrojtshme etikisht dhe të mbështetura në atë traditë filozofike që vazhdon të justifikojë të qenurit, një shtyp i lirë. T'i mbrosh këto parime për këdo që ka rritur veten profesionalisht duke i besuar ato, është më e vështirë.

Kjo sepse do duhet të ndeshesh me cinizmin e thellë, se një sipërmarrje e tillë idealiste përfundon gjithmonë me llomotitje të përgjithshme, ose me ndonjë sulm keqdashës, i cili në rastin më të mirë nuk do të zgjaste më shumë se tri ditë në 'skenën' tonë mediatike. Po çfarë ka ndodhur realisht në një medium të tillë këto vitet e fundit? Përse ra miti i një media pluraliste në Shqipëri dhe përse gazetaria me përkushtim nuk nxitet aq sa duhet nga bordet drejtuese, së pari profesionalisht dhe së dyti për të shkuar drejt standardeve europiane që kërkohen? Përse vërehet një ndryshim i rëndësishëm në statusin e etikës së gazetarisë së sotme? Dhe përse ajo sot konsiderohet si një temë ornamentale, e përshtatshme të studiohet më vete vetëm në universitete? Përse studimi më i fundit për median shqiptare flet për një terren aspak vlerash në etikë, por edhe në besueshmëri, si dy pika kyçe të saj në rolin që duhet të lozë në një vend si Shqipëria e që aspiron të hyjë në BE?

Një gjë është krejt e sigurt: pas studimit më të fundit të BIRN publikuar vetëm dy ditë më parë, më së shumti në mediat 'online', Shqipëria do të vazhdojë të humbasë për një vit e më shumë vende në renditjen e përgjithshme të shteteve sa i përket lirisë së medias. Rasti i këtij studimi dhe i peizazhit mediatik shtrirë në ekranet tona do të jetë tashmë e tutje një refren i pashmangshëm në konferenca ndërkombëtare kushtuar lirisë së medias në Shqipëri, një ilustrim i preferuar i oratorëve të gjithfarshëm për ligjëratat e tyre. Do të duhet shumë mund e kohë që ky rast të dalë prej relacioneve të raporterëve europianë e ndërkombëtarë, të cilët marrin shënim çdo ditë e orë duke ndjekur me shqetësim se si rrjedhin raportet media – politikë e media - qytetar në Shqipëri.



Shqipëria, vendi që vetëm dy dekada më parë pati hartuar ligjin më të shkurtër në botë për shtypin, me një nen të vetëm, "shtypi është i lirë", e shpërfaqi gjendjen e lirisë dhe parimeve themelore të Kodit të Etikës në formën më skandaloze dhe njëherësh më anekdotike të mundshme. Dhe nëse ligjet janë ato të cilat presupozohen se janë 'cenuar' me dashje, kompromentimin afatgjatë të situatës në median shqiptare do ta vuajë emri i Shqipërisë. Kjo është ajo që dihet e nuk dyshohet aspak. Se çfarë është për t'u dyshuar e për të vrarë mendjen, u pa në një formë të dëshpëruar nga mënyra se si vetë gazetarët e diskutuan këtë çështje, apo në ishin të lirë ta publikonin atë para kamerave dhe mikrofonave.

### CILAT JANË STANDARDET E KËRKUARA?

Këshilli i Evropës me qendër në Strasburg, më datën 7 të këtij muaji ka nxjerrë udhëzime për 47 vendet anëtare, me qëllimin t'i ndihmojë ato në nxitjen e pluralizmit dhe të transparencës në pronësinë e medias. Në një rekomandim https://search.coe.int/, miratuar ditë më parë, Komiteti i Ministrave nënvizonte se përparimet në teknologjinë moderne kanë pasur një ndikim të thellë në funksionimin e sektorit të medias dhe në pluralizmin e saj. Po për të përballur këtë sfidë, në rekomandim sugjerohet një kornizë gjithëpërfshirëse e udhëzimeve për krijimin e një mjedisi mediatik pluralist, transparent dhe me një rol kyç pjesëmarrës. Rekomandimi parashtron kushtet e domosdoshme për t'u përmbushur, me qëllim intensifikimin e pluralizmit në media. Aty shtetet inkurajohen të përgatisin strategji për rritjen e qëndrueshmërisë së mediave të ndryshme duke filluar nga transmetuesi publik, ato kombëtare, lokale dhe ndërkufitare. Në rekomandim gjithashtu shtetet inkurajohen të mbështesin gazetarinë cilësore, të pavarur dhe hulumtuese, duke respektuar plotësisht pavarësinë editoriale dhe operacionale të medias. Ndër të tjera, aty jepen udhëzime të cilat ndihmojnë se si mund të arrihet audienca me përmbajtje të ndryshme brenda një numri jo të paktë platformash, që ka filluar në fakt të sjellë pak çoroditje në tregun mediatik shqiptar. Udhëzimet asistojnë bordet drejtuese në media për të shkuar tek një audiencë më e gjerë përmes edukimit në media (Media Literacy). Veç kësaj, rekomandimi inkurajonte shtetet që të zhvillojnë korniza rregullatore për të promovuar me përpikmëri transparencën e pronësisë së medias.

### KU JEMI?

Afro tri dekada pas përmbysjes së sistemit politik dhe vënies së të drejtave të qytetarëve në themelin e jetës së shoqërisë, edhe kur ndodh një ngjarje që skandalizon rajonin e kontinentin, s'ka asgjë për t'u marrë seriozisht. Vetë media është kthyer në një shaka të madhe, në një grotesk të papërshkruar. Kjo nuk ka ndodhur në një ditë. Kjo ndodhi pak nga pak e ditë për ditë, qysh se gazetarët më të zellshëm të shtypit bolshevik u bënë befas themelues të editorë të shtypit kundërshtar dhe gazetaria e "epokës së re" doli prej zejes së gazetarisë komuniste. Liria që aq shumë e kërkuam u mbeti të gjithëve në dorë. Liria e shtypit filloi, por besimi tek shtypi/media u trondit. Mbi të gjitha, shtypi/media humbi aleatin e vet të natyrshëm, qytetarin.

Pak fusha profesionale kanë pjesëmarrës aksionerë aq të shumtë apo aq të zhurmshëm sa gazetaria, për vetë faktin se gabimet e saj etike apo të natyrave të ndryshme janë vazhdimisht, çdo çast të hapura për publikun. Nëse puna e përditshme e gazetarëve ka potencialisht vlerë morale pozitive, atëherë iu takon eticienëve të shqyrtojnë mundësitë se si t'i vendosin dhe ngrenë më lart standardet e përsosmërisë.

> Një gjë është krejt e sigurt: pas studimit më të fundit të BIRN publikuar vetëm dy ditë më parë, më së shumti në mediat 'online', Shqipëria do të vazhdojë të humbasë për një vit e më shumë vende në renditjen e përgjithshme të shteteve sa i përket lirisë së medias. Rasti i këtij studimi dhe i peizazhit mediatik shtrirë në ekranet tona do të jetë tashmë e tutje një refren i pashmangshëm në konferenca ndërkombëtare kushtuar lirisë së medias në Shqipëri, një ilustrim i preferuar i oratorëve të gjithfarshëm për ligjëratat e tyre.

Opinioni i Ditës

# “Ostpolitika” e re koreane

Nga Dr. Jorgji Kote

*(vijon nga faqja 1)*

... dhe stabilitetin në Gadishullin Korean dhe më gjerë po shoqërohen dhe me pohime, reagime, hamendësime dhe dyshimet e rastit.

Kjo me të drejtë, për shkak të kompleksitetit të jashtëzakonshëm të kësaj dosjeje tejet të nxehtë dhe përvojës negative në të kaluarën, kur regjimi koreanoverior i shfrytëzoi politikat tolerante ndaj tij për lehtësimin e gjendjes së mjeruar ekonomike, për propagandë të brendshme dhe për të vijuar shtimin e potencialit/shantazhit bërthamor.

Megjithatë, në vijim të përcaktimit të një strategjie cilësisht të re dhe efektive dhe panënvleftësuar sa më sipër, realpolitika dhe diplomacia në procesin e tanishëm po ndalet dhe në rivlerësimin e aspekteve pozitive të politikave dhe programeve të mëparshme; me synimin që mungesat dhe mangësitë t’i kthejë në mundësi për të ardhmen. Le të jemi më konkretë.

Në prag të shembjes së Murit të Berlinit, ish-presidenti koreanojugor Roh Tae Woo shpalli “Nord Politik” si një version të “Ostpolitik” të famshme gjermane. 10 vjet më vonë, presidenti tjetër koreanojugor Kim - Dae Jung, shkoi më tej duke e riemërtuar atë “Sunshine Policy” ose “Politika Diellore”. Ky term i ri, i huazuar nga fabula e Ezopit “Era e Veriut dhe Dielli” mbështetej në parimin “jepi dhurata armikut që të mos të të bëjë keq”. Ndaj u quajt ndryshe dhe “politika e përqafimit” (Embrace Policy).

Sipas modelit të “Ostpolitik”, gjatë viteve 1988- 2008 qeveria e Koresë së Jugut vuri në zbatim paketa të tëra masash për t’i ardhur në ndihmë ekonomisë dhe popullsisë së fqinjës së Veriut, ku varfëria dhe uria po bënte kërdinë si dhe në drejtim të bashkëpunimit ekonomik e tregtar, kontakteve njerëzore, ribashkimin familjar, etj. Kulmi i kësaj politike ishte në vitin 2000, kur presidenti koreano-jugor u takua me homologun e vet verior.

Gjithsesi, ndryshe nga “Ostpolitik” që pas 20 vitesh i dha frytet e veta me ribashkimin e Berlinit, Gjermanisë dhe Evropës, “dielli koreanojugor” nuk mundi t’i shkrinte akujt e “Luftës së Ftohtë” në Gadishull, madje gjendja u acarua dhe më keq deri në shantazhe bërthamore nga Koreja e Veriut. Ndonëse ashtu si ish-kancelari gjerman Brandt i “Ostpolitik” në vitin 1971, edhe presidenti jug-korean Kim Dae - Jung në vitin 200O u laurua me çmimin “Nobel për Paqe”, kjo e fundit në Gadishullin Korean mbeti vetëm dëshirë e mirë.

Për pasojë, në vitin 2010, Koreja e Jugut hoqi dorë zyrtarisht nga “Politika Diellore” dhe gjatë tetë viteve të fundit, së bashku me SHBA-të, në përgjigje të provokimeve dhe kërcënimeve koreanoveriore përshkallëzuan sanksionet politike, ekonomike dhe manovrat ushtarake.

Mirëpo, siç pohojnë me të drejtë analistët dhe ekspertët, as strategjia e forcës gjatë 10 viteve të fundit nuk dha ndonjë gjë më shumë në drejtim të ndryshimit të statuskuosë, përkundrazi kërcënimi bërthamor u bë iminent deri sa Lojërat Olimpike Dimërore në Pjongçang sollën detantën tashmë të njohur dhe hapat e tjerë të mëdhenj nga palët e interesuara.

Në fakt, shkaku i vërtetë i këtij dështimi, veç sabotimit të këtyre përpjekjeve nga regjimi koreanoverior qëndron dhe te mungesa e kombinimit racional të komponentëve përbërës të “Ostpolitik” koreane. Këtë e dëshmoi qartë përvoja pozitive e tre muajve të fundit kur përshkallëzimi i presionit politik, ekonomik dhe ushtarak nga SHBA-të u shoqëruan efektivisht me dialogun politik, me diplomacinë sportive dhe atë të sharmit etj.

Ndaj, nuk ka pse “Ostpolitik” të mos rikthehet në Gadishullin Korean, natyrisht me një emër, format, përmbajtje dhe objektiva cilësisht të reja mbi bazën e analizës së shkaqeve të dështimit të “Politika Diellore” nxjerrjen e mësimeve përkatëse dhe rinovimin e saj cilësor.

Së pari, edhe mbi të gjitha “Politika Diellore” dështoi sepse ndryshe nga “Ostpolitik” ajo nuk pati mbështetjen e SHBA-ve dhe Japonisë, veç sabotimit të heshtur nga Rusia dhe Kina. Për pasojë, pati mungesë të theksuar bashkërendimi, pasi SHBA-të i mëshonte kryesisht për të mos thënë tërësisht presionit me përdorimin e forcës ushtarake, ndërsa Koreja e Jugut kryesisht “fuqisë së butë”, afrimit dhe bashkëpunimit. Për rrjedhojë, tani ky proces do të fuqizohet ndjeshëm sepse do të ketë mbështetjen e SHBA-ve, Japonisë, por edhe Rusisë e Kinës, me gjithë kufizimet e tyre.

Së dyti, në kuadrin e “Ostpolitik”, “Evropa&SHBA” akorduan ndihma të mëdha financiare dhe materiale në miliarda dollarë për vendet lindore dhe ish-RDGJ-në, por këto ndihma dhe ky bashkëpunim u kushtëzuan qartë me shumë kërkesa dhe zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut etj. Madje, në vitin 1975 u krijua dhe OSBE-ja me tri “shportat” e njohura- demokracia, të drejtat e njeriut dhe bashkëpunimi ekonomik e tregtar, ku anëtarë të saj u bënë dhe regjimet ish-lindore.

E kundërta ndodhi me Korenë e Jugut, e cila akordoi ndihma ekonomike dhe humanitare me tepri, por që u mungoi komponenti kryesor për sukses - kushtëzimi politik. Pikërisht ky komponent jetik do të mbahet mirë parasysh tani në prag të samitit në fjalë, duke filluar me kërkesën paraprake për ndërprerjen nga Koreja e Veriut të provave bërthamore, lëshimit të raketave balistike etj., për të kaluar shkallë- shkallë dhe pa lëshime në kushte/kërkesa të tjera që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e njeriut, hapjen e Koresë së Veriut nëpërmjet intensifikimit të kontakteve njerëzore, kulturore, artistike sportive etj.

Kjo do t’i shërbente dhe krijimit e forcimit të një disidence dhe opozite që mungon në Phenian; sepse “Ostpolitik” u zbatua në kushtet kur sidomos Polonia, Çekosllovakia dhe Hungaria kishin një disidencë dhe opozitë të konsiderueshme politike, letrare dhe fetare.

Gjithashtu, ndryshe nga “Ostpolitik”, “dielli” koreano-jugor nuk arriti të “ngrohte” publikun e gjerë, median, artin dhe kulturën, sidomos në Korenë e Veriut. Ndërsa në pjesën jugore ajo u shoqërua me kritika, skepticizëm dhe oponencë të vazhdueshme që dëmtoi seriozisht efektivitetin e kësaj politike. Ndaj nuk u bë e mundur që Seuli të kthehej në një vitrinë të vërtetë të demokracisë dhe begatisë për Korenë e Veriut, si në rastin e Berlinit Perëndimor.

Veç sa më sipër, ajo çka e detyron “Ostpolitik” koreano-jugore të anojë detyrimisht më shumë në aspektin e forcës ushtarake dhe ekonomike është rrezikshmëria shumë më e madhe e Koresë së Veriut, për shkak të zotërimit të arsenalit bërthamor në një “pellg megafuqish” të vërteta ndërkombëtare. Për më tepër, aleatët e saj, Kina dhe Rusia janë sot shumë më të fuqishme politikisht dhe ushtarakisht se në vitet ‘70-‘80.

Nisur nga sa sipër, duke i shtuar dhe shumë elementë të tjerë, “Ostpolitik” koreane mund të kthehet në një histori suksesi; me kusht që tanimë të mos zbatohen më veç e veç, por të ndërthurura organikisht “fuqia e butë” dhe ajo e “ashpër” ose siç i themi në shqip “kulaçi dhe kërbaçi”. Këtë po bën me mençuri politika aktuale amerikane në bashkëpunim të ngushtë me aleatin e saj koreanojugor dhe Japoninë.



## HOROSKOPI

### DASHI

Do jeni shumë aktivë herët në mëngjes, por pastaj do humbisni energjinë. Me kalimin e Hënës në shenjën tuaj, objektivi kryesor do jetë qetësia. Produktiviteti në plan të dytë, në fillim vijnë ligjet pastaj rregullat, më të forta idealet e biznesit.

### DEMI

Është dita e duhur për të blerë një palë këpucë ose diçka tjetër që ju duhet patjetër, sigurisht pa lënë pas dore modën e fundit. Bashkëpunim mes kolegëve, nuk ka fitimtarë, thjesht një grup që punon në harmoni për të njëjtin objektiv.

### BINJAKET

Do jetë e vështirë sot të përcaktoni ndjenjat qartë. Megjithëse do përpiqeni të mos i shprehni emocionet e forta, personat e afërt do e kuptojnë se keni nevojë për mbështetje. Marrëdhëniet në punë duket sikur po përmirësohen, optimizmi nuk ju mungon.

### GAFORJA

Ditë e shkëlqyer e shënuar nga elementi ujor nga Hëna në trekëndësh që rrit ndjeshmërinë tuaj, duke siguruar harmoni në marrëdhëniet që krijoni. Intiutivë por edhe shumë ambiciozë në punë, do arrini ta kontrolloni situatën duke gjetur një kompromis të shkëlqyer.

### LUANI

Do përfshiheni nga rutina dhe angazhimet e zakonshme, duke investuar një pjesë të madhe të energjive tuaja në gjërat e përditshme. Duhet të gjeni edhe kohën për t’u çlodhur. Marrëdhëniet me të tjerët, në shtëpi dhe jashtë, do jenë të qeta dhe në harmoni.

### VIRGJERESHA

Në dashuri është e kotë të shpenzoni energji duke u përpjekur të racionalizoni. Edhe nëse bëhet fjalë për një raport të komplikuar, ia vlen të shijoni deri në fund. Një shëtitje e gjatë në kohën e lirë. Kontakti me natyrën do ketë një efekt të mirë në humorin tuaj.

### PESHORJA

Jeni të përqendruar tek puna. Keni shumë projekte ambicioze që ia vlen t’i çoni deri në fund, duke krijuar aleanca dhe kontakte favorizuese. Shmangni konkurrencën midis kolegëve, duhet të keni kujdes vetëm nga konkurrenca që vjen nga jashtë.

### AKREPI

Rinovimi i entuziazmit dhe shprehja e emocioneve që ndjeni do mbështetet nga kalimi i Hënës tek Peshqit, një kurë e vërtetë për gjendjen tuaj shpirtërore. Do përkushtoheni të zgjidhni disa çështje praktike dhe pastaj do keni gjithë kohën e duhur për gjërat që ju interesojnë.

### SHIGJETARI

Ditë shumë e ngarkuar, por nuk keni asnjë dëshirë për të punuar, duhet të angazhoheni shumë për të sistemuar gjithçka në punë dhe në shtëpi. Ndoshta është mirë të shmangni debatet me të afërmit, sot nuk është dita e duhur për grindje të kota.

### BRICJAPI

Vazhdoni të ndiqni angazhimet profesionale. Keni mundësi të mira për t’u njohur edhe jashtë ambientit të zakonshëm. Nëse nuk e keni gjetur akoma shpirtin binjak, ndoshta ka ardhur koha të zgjeroni rrethin tuaj të miqësisë.

### UJORI

Kur ndjeheni të pamotivuar sepse zëri juaj nuk dëgjohet mjaftueshëm, zakonisht mbylleni në vetvete me një krenari të dyshimtë. Nëse nuk duan t’ju japin të drejtë, mos u shqetësoni shumë, problemet e të tjerëve nuk duhet të jenë pjesë e ditës suaj.

### PESHQIT

Ditë në shoqëri të këndshme me Hënën në shenjën tuaj. Është koha ideale për të realizuar dëshira të vogla dhe të mëdha. Jeni pak të pasigurt mes miqësisë dhe dashurisë, por ka ardhur momenti të merrni një vendim.

## PËRCAKTOHET KALENDARI



### Java e 26-të do të luhet të dielën dhe të hënën

Java e 26 e Kategorisë Superiore do të luhet në dy ditë, e ndarë mes të dielës dhe të hënës, sipas kalendarit të planifikuar nga Sektori i Garave në FSHF. Gjithçka fillon me takimet Lushnja-Teuta dhe Laçi-Kamza në orën 14:00 të së dielës, ndeshje që vënë përballë në njërin duel dy skuadrat që mbajnë dy vendet e fundit të klasifikimit dhe në tjetrin dy ekipe që kanë synime të qarta për Europën. Supersfida e të dielës është ajo që luhet në orën 17:00 në Korçë, ku Skënderbeu pret Luftëtarin, ekipin që po spikat në këto javë të Superiores dhe po argëton me lojën e tij. Sa i përket të hënës, ndeshja e drekës është "derbi i veriut" mes Kukësit dhe Vllaznisë, që luhet në orën 14:00. Kurse java e 26 mbyllet me një duel të ndezur në "Selman Stërmasi", ku Partizani pret një rival direkt për Europën si Flamurtari.

**SUPERLIGA**

**TË DIELËN**

| | |
|---|---|
| Lushnja-Teuta | 14:00 |
| Laçi-Kamza | 14:00 |
| Skënderbeu-Luftëtari | 17:00 |

**TË HËNËN**

| | |
|---|---|
| Kukësi-Vllaznia | 14:00 |
| Partizani-Flamurtari | 17:00 |

Vllaznia e Partizani nuk shkojnë më larg sesa barazimi i bardhë 0-0, të kuqtë shpërdorojnë

# Laçi e Luftëtari "europian", në Vlorë e kanë me arbitrin

## *Teuta arrin t'i shkëpusë barazimin Skënderbeut*

Flamurtari e Kamza e mbyllën në një barazim me gola, 2-2, sfidën e javës së 25-të në Kategorinë Superiore. Një sfidë spektakolare në Vlorë, që në fund pa të dyja ekipet të marrin vetëm një pikë. Ekipi i Duros u duk më kërkues, por ishin miqtë ata që zhbllokuan me Raçiç në të 28-tën, pas një penalltie të kontestuar. Në të dytën më pas, ishte Sidibe që barazoi shifrat, por Plaku kaloi të tijtë përsëri në avantazh, pas pak minutash. Vlen të përmendet që në atë moment, vlonjatët ishin me 10 lojtarë, pasi Bicaj u ndëshkua dy herë me karton të verdhë. Teksa Kamza po shkonte drejt fitores, Flamurtari mori një penallti, dhe ishte Zhufo ai që barazoi sërish. Deri në fund, rezultati nuk pati më ndryshime, dhe të dyja skuadrat ndanë nga një pikë. Teuta nuk ia ka dalë të bëjë surprizën në takimin e sotëm përballë Skënderbeut. Durrsakët treguan se do të luftojnë deri në fund për mbijetesë, por goli i pësuar në fund i ul moralin atyre. Pjesa e parë ishte e qetë dhe të dyja ekipet kishin rastet e tyre, të cilat nuk mundën t'i shfrytëzonin. Në pjesën e dytë Teuta tregoi një fytyrë tjetër, e ndihmuar edhe nga penalltia që fitoi që në minutën e dytë të pjesës së dytë. Hila e shndërroi në gol, por edhe dhe më vonë ata patën raste të pastra



shënimi. Gjithsesi, goli i Xhejms ishte vrasës për ta, pasi humbën dy pikë shumë të vlefshme vetëm dy minuta nga fundi. Vllaznia dhe Partizani kanë luajtur në stadiumin "Loro Boriçi" një ndeshje shumë delikate, ku të dyja skuadrat kishin nevojë për pikë, që të realizojnë objektivat e tyre, shkodranët mbijetesën dhe të kuqtë Europën.

Trajnerët Gjoka dhe Dalipi kanë bërë përzgjedhjet e tyre për formacionin. Ndryshimi i vetëm te Vllaznia ishte Tafili, i cili zë vendin e Orelesit të skualifikuar. Partizani erdhi në këtë ndeshje pa ndryshime. Pjesa e parë ishte monotone, kur për të parë rastin e parë të rrezikshëm duhet të prisnim 45 minuta. Sukaj dhe Çinari i afrohen golit të avantazhit, ndërsa ndeshja është shoqëruar edhe me momente tensioni. Pjesa e dytë ka folur më tepër për ekipin e Partizanit, që ishte pranë golit me dy raste të pastra. Bardhi ka dalë i vetëm përballë Sherrit, duke humbur rastin më të mirë të takimit. Nga ana tjetër, edhe Trashi ka humbur një mundësi të artë në minutën e 84-të, duke e mbyllur këtë takim në një barazim pa gola. Pas kësaj ndeshje Vllaznia shkëputet me 5 pikë larg Teutës, ndërsa miqtë ia vështirësojnë punën vetes për objektivin e Europës. Në Gjirokastër ka përfunduar ndeshja mes Luftëtarit dhe Kukësit, e fituar me përmbysje nga vendësit, me rezultatin 2-1. Guri kaloi Kukësin në avantazh, por më pas Abazaj në limitin e pjesës së parë dhe Liçaj në pjesën e dytë shënuan golat, që i dhanë fitoren Luftëtarit. Gjirokastritët i afrohen më shumë Europës. Myrto Uzuni ka udhëhequr Laçin drejt një suksesi të rëndësishëm 3-1 në fushën e Lushnjës që afron skuadrën kurbinase me Europën. Dy gola të sulmuesit të talentuar, protagonist edhe në aksionin e golit të tretë të skuadrës së tij, i siguruan tri pikët kurbinasve të drejtuar nga Mezani, të cilët shohin Europën gjithnjë e më afër.

## TRAJNERI

### Inzaghi sulmon VAR-in: I lumtur që nuk aplikohet në Europë

Kemi punuar shumë për të arritur deri këtu ku jemi në Europa League. Duam të kalojmë në çdo kusht në çerekfinale. Kemi bërë një sezon pozitiv, duke nisur që me fitimin e Superkupës në gusht. Formacioni? Kam lojtarë të etur për të fituar. Dikush prej tyre mbeti në Romë, sepse nuk ishte në formë. Të 19-të lojtarët që kemi grumbulluar janë në superformë", kështu është shprehur trajneri i Lazios, Simone Inzaghi përpara takimit kundër Dinamos së Kievit që do të luhet nesër në Ukrainë. Ndeshja e parë e luajtur në Romë përfundoi 2-2. Inzaghi ironizoi edhe me sistemin "VAR" që ka nisur të aplikohet në Serinë A këtë sezon, duke u shprehur: "'VAR'? Jam i lumtur që nuk aplikohet në Europë. E patë se çfarë ndodhi në Cagliari? Nuk ia vlen të flasësh më për këtë temë. Nuk është Lazio që ankohet për gjykimin, por është gjykimi që shkon kundër Lazios", tha trajneri i bardhekaltërve.

## Trajneri i Flamurtarit

### Duro: Enea Jorgji na mohoi fitoren

Takimi mes Flamurtari dhe Kamzës është mbyllur me rezultatin 2-2, ku nuk kanë munguar episodet e ndryshme dhe tensioni në fushën e lojës, përveç golave të shënuar. Në një intervistë për "Supersport", Shpëtim Duro është shprehur se Flamurtarit i është mohuar fitorja nga ana e Enea Jorgjit. "Duke ju referuar situatës problematike që kemi në shumë aspekte dhe mungesat e shumta, them që atë që tregoi skuadra në fushën e lojës vlen për t'u lavdëruar. Nuk na interesonte barazimi, por



kishte edhe më keq. Nëse Jorgji do ishte më profesionist, do kishim fituar. Skuadra tregoi karakter gjithë ndeshjen. Sigurisht që kemi gabuar shumë dhe në momentin e dytë kishim shumë mundësi për të kthyer ndeshjen. Përveç dy momenteve kemi dhënë maksimumin, por nuk shfrytëzuam mundësitë. Penalltitë janë diçka normale për ne dhe ajo që u dha për ne ishte me shumë vështirësi. Nuk ka asnjë lloj diskutimi, penalltia ishte, por Jorgji nuk na e dha. Ne jemi në situatën më të keqe dhe kam përgëzuar futbollistët për atë që kanë dhënë gjatë gjithë lojës, pasi mund të humbisnim për gabimet tona dhe të arbitrit. Për vendosjen e Zukës në fushën e lojës, ai ka luajtur në atë pozicion. Në pjesën e dytë, unë spostova Danilon dhe Kamaran në qendër të sulmit, duke dërguar në krahë Hoxhaj", është shprehur Shpëtim Duro.

## SERIE A



### Juventusi "thyen" Atalantën dhe arratiset në krye

Ekipi i Juventusit ka marrë një fitore mjaft delikate në ndeshjen e sotme ndaj Atalantës me rezultatin 2-0, në takimin e prapambetur për shkak të dëborës që bëri të pamundur zhvillimin normal të saj. Higuain ka hapur takimin, pasi shënoi në minutën e 29-të të ndeshjes. Atalanta ka ngelur me 10 lojtarë në minutën e 79-të, ndërsa vetëm 2 minuta më vonë, Matuidi dyfishoi rezultatin. Pas kësaj fitore, bardhezinjtë marrin kryesimin e takimit dhe e dërgojnë në +4 pikë diferencën me Napolin.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!

